



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

RAPORT VLERËSUES DHE MONITORUES

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I INTEGRITETIT NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË KOSOVË



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

RAPORT VLERËSUES DHE MONITORUES

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I INTEGRITETIT NË INSTITUCIONET E SIGURISË NË KOSOVË

Prishtinë, Maj 2016

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së dhe KCSF-së.

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Plator Avdiu dhe Skënder Perteshi

Redaktimi i brendshëm: Donika Emini dhe Mentor Vrajolli

Redaktimi i jashtëm: Shpend Kursani

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose tjetër, pa lejen para-prake të botuesit.

SHËNIM HYRËS

Besueshmëria, qeverisja e brendshme, dhe integriteti janë parime kryesore të cilat garantojnë funksionalizim të qëndrueshëm dhe kredibil të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Ky raport monitorues dhe vlerësues i integritetit në kuadër të institucioneve të sigurisë në Kosovë publikohet për herë të parë në Kosovë. Publikimi i këtij raportit bëhet në kuadër të programit të veçantë të QKSS-së të titulluar: **“Monitorimi dhe Vlerësimi i Integritetit në Kuadër të Institucioneve Kosovare të Sigurisë”**. Nëpërmjet këtij programi QKSS synon që në mënyrë sistematike të monitoroj, raportoј dhe avokoj çështjet që kanë të bëjnë me integritetin në institucione të sigurisë si dhe të ofrojë mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të tyre për të arritur standardet e nevojshme në këtë fushë.

Ky raport paraqet gjendjen aktuale të integritetit në Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës duke u bazuar në gjetjet e grumbulluara nga ekipi hulumtues i QKSS. Qëllimi i tij është që të vlerësoј nëse ka patur progres në ngritjen e integritetit në këto institucione si dhe të sjellë rekomandime specifike duke u fokusuar në fushat si në vijim: Prokurimi Publik, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Auditimi i Brendshëm, Integriteti dhe Besueshmëria, Mbikëqyrja Parlamentare dhe Demokratike, Transparenca, dhe Pavarësia në Vendimmarrje.

Rezultatet e Barometrit Kosovar të Sigurisë për pesë vite me rradhë kanë listuar Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës si institucionet më të besueshme nga qytetarët e Kosovës. Megjithatë, ende ka shumë për tu bërë në drejtim të përsosmërisë së këtyre institucioneve.

Megjithë faktin se korniza ligjore për garantimin e integritetit në institucionet e sigursë është solide dhe ende po vazhdon të përmirësohet, gjetjet tregojnë se edhe më tutje kapacitetet administrative dhe mekanizmat për të garantuar implementim të shëndoshë të kësaj kornize dhe funksionim të shëndoshë të integritetit institucional në këtë sektor ende janë nën nivelin e dëshiruar. Në gjë e tillë e afekton performancën e këtyre institucioneve duke rrezikuar rënjen e nivelit të besueshmërisë së qytetarëve të Kosovës ndaj Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë e cila për momentin është mjaftë e lartë.

Ky raport monitorues nuk do të ishte i realizueshëm pa ndihmën e palodhshme të partnerëve të QKSS. Shfrytëzojmë rastin të shprehim falemnderim të veçantë për të gjithë ata që u angazhuan në realizimin e këtij raporti, si në dhënien e informacioneve të shkruara si dhe me gatishmërinë e tyre të treguar për zhvillimin e takimeve të ndryshme, intervista dhe fokus grupe duke ndihmuar në e nxjerrjes së konkludimeve dhe rekomandimeve të këtij raportit. Falemnderojmë po ashtu edhe ekspertët në këtë fushë nga Transparency International – Programi për Mbrojtje dhe Siguri në Londër për mbështetjen në përpilimin e metodologjisë hulumtuese, si dhe Z. Visar Sutaj-n, hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) për mbështetjen e dhënë për ekipin hulumtues të QKSS në punën e tyre drejt finalizimit të këtij raportit.

Për fund, falemnderim i veçantë shkon edhe për projektin për Promovim të Shoqërisë Demokratike (DSP) i cili është i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) ndërsa i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), pasi që ky raport nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e tyre financiar për këtë projekt.

QKSS u është mirënjohës të gjithëve

Ekipi i QKSS

PËRMBAJTJA

SHËNIM HYRËS	5
PËRMBAJTJA.....	6
LISTA E SHKURTESAVE.....	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	12
Menaxhimi i burimeve njerëzore:.....	12
Kontrolli i brendshëm	13
Pavarësia në vendimmarrje e Policisë:	13
Transparenca:.....	14
Prokurimi publik:.....	14
Mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e Policisë:	14
1. HYRJE	15
1.1. Metodologjia	16
2. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE.....	16
2.1. Korniza ligjore	16
2.2. Praktika	17
2.2.1. Buxheti.....	18
2.2.2. Personeli dhe trajnimet e policëve	19
2.2.3. Pensionimi i zyrtarëve policor.....	20
2.2.4. Gradimi	22
2.2.5. Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi jetësor	23
3. KONTROLLI I BRENDSHËM	24
3.1. Dokumentet për promovimin e integritetit dhe luftimin e korrupsionit në PK.....	24
3.2. Kontrolli i brendshëm në Polici.....	26
3.3. Roli i IPK-së në mbikëqyrjen e Policisë	27
4. PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE E POLICISË.....	33
4.1. Suspendimi i zyrtarëve policor në Prizren	33
4.2. Operacioni policor i 28 nëntorit 2015	35
5. TRANSPARENCA	38
5.1. Korniza ligjore	38
5.2. Praktika	39
6. PROKURIMI PUBLIK	42

7. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE DHE DEMOKRATIKE E POLICISË	43
7.1. Mbikëqyrja parlamentare	43
7.2. Mbikëqyrja e Policisë nga institucionet tjera	46
7.2.1. Inspektorati Policor i Kosovës	46
7.2.2. Institucioni i Avokatit të Popullit	48
7.2.3. Agjencia kundër Korrupsionit	49
7.2.4. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	49
REKOMANDIME	51
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	56
Menaxhimi financiar	56
Prokurimi publik	56
Kontrolli i brendshëm	57
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	57
Integriteti dhe besueshmëria	57
1. HYRJE	58
2. PROKURIMI PUBLIK	59
2.1. Korniza ligjore	59
2.2. Kapacitetet Administrative	59
2.3. Implementimi	60
3. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	63
3.1. Korniza ligjore	63
3.2. Kapacitetet administrative	64
3.3. Implementimi	65
4. AUDITIMI I BRENDSHEM NE MFSK	71
4.1. Korniza ligjore	71
4.2. Kapacitetet administrative	72
4.3. Implementimi	73
5. INTEGRITETI DHE BESUESHMËRIA NË MFSK	74
5.1. Besueshmëria publike ndaj FSK-së	75
6. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE DHE DEMOKRATIKE E SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË	77
6.1. Legjislacioni	77
6.2. Kapacitetet administrative	77
6.3. Implementimi	78
6.4. Transparenca në FSK	81
6.5. Pavarësia në vendimmarrje në MFSK	83
7. PËRFUNDIMI	84
8. REKOMANDIMET	85

LISTA E SHKURTESAVE

AI	Amnesty International
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
DBNj	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DRP	Drejtoritë Rajonale të Policisë
DSP	Drejtoria e Standardeve Profesionale
FIT	Njësia Speciale Intervenuese e Policisë së Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
IFSK	Inspektorati i Forcës së Sigurisë së Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KFOR	Forca për Kosovën
KFT	Komanda e Forcave Tokësore
KK	Kuvendi i Kosovës
KPBSMFSK	Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
KPO	Kapacitet e Plota Operacionale
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
KTD	Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
LSHC	Ligji për Shërbyesit Civil
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
PK	Policia e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
QSU	Qendra e Studimeve Universitare
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

INTEGRITETI NË POLICINË E KOSOVËS

Autor: Plator Avdiu

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi dhe vlerësimi i performancës së Policisë së Kosovës përmes matjes së integritetit të zyrtarëve policor si dhe mekanizmave mbikëqyrës. Të dhënat e pasqyruara janë mbledhur nga aktivitetet monitoruese dhe avokuese, intervistave të ndryshme, shqyrtimit të dokumenteve ligjore e raportuese, si dhe burimeve të tjera në dispozicion. Përmes këtij hulumtimi synohet identifikimi i sfidave në rrafshin e integritetit policor dhe, për më tepër, avokimi për përmirësimin, demokratizimin dhe profesionalizimin në mënyrë të vazhdueshme të Policisë së Kosovës.

Raporti përmban gjithsej gjashtë seksione të lidhura kryekëput me integritetin policor, si: transparenca, menaxhimi i burimeve njerëzore, kontrolli i brendshëm, pavarësia në vendimmarrje e Policisë, mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike dhe prokurimi publik. Gjetjet nga ky hulumtim kanë vë në pah nevojën e adresimit të sfidave që hasen në secilin prej këtyre seksioneve nga Policia e Kosovës me qëllim të reformimit të këtij institucioni.

Në vijim do të listojmë edhe gjetjet kryesore të hulumtimit lidhur me integritetin në Policinë e Kosovës për secilin seksion:

Menaxhimi i burimeve njerëzore:

- ⇒ Zhvillimi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe reformat janë sfiduar për shkak të zvogëlimit të buxhetit të Policisë prej afro 4 përqind në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015.
- ⇒ Sfidë e madhe për Policinë është zbatimi i normave juridike sa i përket barazisë gjinore. Prej vitit 2015 kur është miratuar Ligji për Barazi Gjinore, në një mënyrë apo tjetër, është bërë e detyrueshme që përfaqësimi gjinor në institucionet publike të jetë 50 përqind për secilën gjini.
- ⇒ Më shumë se 4,000 policë të Kosovës janë të moshës mbi 40 vjeçare, 2,091 sosh janë mbi moshën 46 vjeçare, ndërsa rreth 1,000 prej tyre i përkasin moshës 55 vjeçare. Kjo tregon se stafi i PK-së është i vjetërsuar dhe shtron nevojën e reformimit të këtij institucioni edhe në aspektin e burimeve njerëzore.
- ⇒ Mungesa e ligjit që rregullon çështjen e pensionimit të policëve, si dhe mungesa e sigurimit shëndetësor e jetësor përbëjnë një ndër sfidat më të mëdha në reformimin e Policisë së Kosovës. Inspektorati Policor i Kosovës ka gjetur parregullsi në procesin e gradimit të zyrtarëve policor në vitin 2015 si rezultat themelimit të komisioneve për gradime pa përfillur procedurat ligjore.

Kontrolli i brendshëm

- ⇒ Policia nuk ka plan për zhvillimin e integritetit institucional që do të shërbente si udhërrëfyes për parandalimin e korrupsionit brenda këtij institucioni.
- ⇒ Strategjia kundër korrupsionit 2013-2017 i rekomandon Policisë të forcojë mekanizmat disiplinorë dhe kontrollin e brendshëm për zvogëlimin e korrupsionit policor.
- ⇒ Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës kanë trajtuar 948 raste të ndryshme në vitin 2015, në të cilat kanë qenë të përfshirë zyrtarët policor për shkak të dyshimit për shkelje të ndryshme.
- ⇒ Drejtoria e Standardeve Profesionale në kuadër të Policisë ka mungesë të transparencës për arsyeje se ajo nuk i bën të ditura rastet për të cilat bën hetime të brendshme për shkeljet disiplinore të personelit policor.
- ⇒ Në vitin 2015 Inspektorati Policor ka pranuar 1,237 ankesa nga qytetarët ndaj Policisë, ku 173 prej tyre janë me elemente të veprës penale. Kurse 161 tjera, prej tyre i janë dërguar Prokurorisë për hetime të mëtejshme.
- ⇒ Inspektorati Policor ka hetuar 220 punonjës të Policisë në vitin 2015. Ndërsa, ka bërë 23 arrestime, 39 rekomandime për suspendime të personelit policor, si dhe 11 rekomandime për transfere të punonjësve të Policisë.

Pavarësia në vendimmarrje e Policisë:

- ⇒ Suspendimi i dy policëve në Prizren në korrik të vitit 2015 ka dëshmuar se në Polici bëhen ndërhyrje politike nga zyrtarë të lartë politikë, madje edhe nga ministra të ekzekutivit. Policia, më saktësisht zyrtarë policor, ende nuk janë autonom në kryerjen e detyrave të tyre profesionale.
- ⇒ Mekanizma vendorë dhe ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut kanë ngritur shqetësime se Policia ka tejkaluar autorizimet e veta gjatë protestës së 28 nëntorit 2015. Avokati i Popullit ka kërkuar nga Prokuroria të kryejë hetime penale për dyshimet në përdorimin disproporcional të forcës.

Transparenca:

- ⇒ Pavarësisht një shkalle solide të transparencës në Policinë e Kosovës, vërehet një tendencë brenda për brenda institucionit për të burokratizuar qasjen e publikut në informacionet paklasifikuara.
- ⇒ Në vitin 2015 Policia e Kosovës ka realizuar 3,500 kërkesa të ndryshme për informata nga mediat, organizatat joqeveritare dhe personat fizik.
- ⇒ Faqja e internetit e Policisë së Kosovës ka nevojë të përmirësohet dukshëm sa i përket ofrimit të informacioneve në fushën e prokurimit publik dhe kontrollit të brendshëm.

Prokurimi publik:

- ⇒ Me ndryshimet që janë bërë në vitin 2016 në Ligjin për Prokurimin Publik është specifikuar tutje neni 3 lidhur me tenderimin për blerje specifike në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Megjithatë, vetëm ky nen ende nuk rregullon në detaje mënyrat e tenderimit për raste të tilla prandaj shihet si envojë përpilimi i Rregullores si derivat i këtij neni.

Mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e Policisë:

- ⇒ Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë vitit 2015 ka mbikëqyrrur vetëm Ligjin për Policinë.
- ⇒ Në komision ka raportuar dy herë ministri i Punëve të Brendshme, tri herë Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ndërsa ish-Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka raportuar vetëm një herë.
- ⇒ Varësia financiare e Inspektoratit Policor nga Qeveria ka ngritur shqetësimet lidhur me (pa)anshmërinë e Inspektoratit në hetimin e shkeljeve ose keqpërdorimeve të mundshme në Polici. Madje, ka kërkesa që Inspektoratit Policor t'i hiqet kompetenca e hetimeve penale ndaj zyrtarëve policor. Ky institucion, nga ana tjetër, ka nisur projektin e regjionalizimit nga viti 2015.
- ⇒ Numri i zyrtarëve policor që kanë deklaruar pasurinë në Agjencinë kundër Korrupsionit në vitin 2015 është vetëm 57 nga afro 9 mijë sa ka kjo organizatë. Për këtë proces AKK-ja nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi dhe nuk ka ndonjë kallëzim penal të kësaj agjencie për zyrtarë të Policisë.

1. HYRJE

Zhvillimi i integriteti në Polici është një koncept i ri jo vetëm në Kosovë, por edhe për policitë e vendeve të rajonit dhe me gjerë. Qëllimi i forcimit të integritetit policor është luftimi i parregullsisve brenda Policisë dhe nuk kufizohet vetëm me qasjen e tanishme të luftimit të korrupsionit por ka për qëllim edhe trajtimin e çështjeve tjera si nepotizmin, mungesën e llogaridhënës, tejkalimin e autorizimeve si dhe dukurive të tjera joformale përmes fuqizimit të mekanizmave brenda për brenda Policisë. Në gjë të tillë koncepti i integritetit synon ta arrijë përmes përafrimit të vlerave policore me rregullat ligjore, etike dhe kulturore të shoqërisë në përgjithësi. Për më tepër, edhe vet qëllimi i fuqizimit të integritetit në Polici ka të bëjë me ngritjen e besueshmërisë së qytetarëve në këtë institucion.

Policia e Kosovës vazhdon të jetë një ndër më të besueshme në rajon. Sidoqoftë, ngritja e besueshmërisë në Polici nuk tregon gjithmonë për gjendjen reale në institucion. Me synim të identifikimit të sfidave në Policinë e Kosovës, ky raport shqyrton funksionimin e qeverisjes së brendshme në Polici përmes këtyre indikatorëve: *menaxhimi i burimeve njerëzore; kontrolli i brendshëm; pavarësia në vendimmarrje e Policisë; transparencja; prokurimi publik; dhe mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e Policisë.*

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i rëndësishëm për Policinë me qëllim të profesionalizimit të personelit policor dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve të Policisë në përputhje me performancën në punë. Kjo natyrisht duhet të bëhet duke përfillur politikat e integritetit. *Kontrolli i brendshëm* i Policisë së Kosovës nënkupton forcimin e mekanizmave të brendshëm policor për luftimin e korrupsionit dhe dukurive të tjera negative brenda radhëve të veta. Llogaridhënia dhe përgjegjësia e personelit policor duhet të mbikëqyret nga kontrolli i brendshëm i Policisë. *Pavarësia në vendimmarrje e Policisë* duhet të garantojë autonomin institucionale dhe shmangien e ndërhyrjeve të jashtme, përfshirë ndikimin politik, në punën e Policisë së Kosovës. *Transparenca* e Policisë është e rëndësishme për të mbajtur publikun të informuar lidhur me aktivitetet e Policisë si dhe të garantojë se Policia është institucion i hapur për publikun, gjë që është edhe një prej parimeve të integritetit. *Prokurimi publik* duhet të sigurojë që buxheti i Policisë shpenzohet sipas procedurave ligjore dhe në pajtim me kërkesat e Policisë. Në këtë drejtim, duhet t'i kushtohet vëmendje luftimit të keqpërdorimeve të mundshme në Polici gjatë aktiviteteve të prokurimit publik. *Mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e Policisë* duhet të kontribuojë në profesionalizimin e Policisë së Kosovës për ta mbajtur atë sa më të përgjegjshme dhe llogaridhënëse.

Ky raport, gjithashtu, përmban një pako me rekomandime për secilin indikator që ndërlidhet ngushtë me qeverisjen e brendshme në Polici. Të gjeturat e këtij hulumtimi kanë për qëllim të shërbejnë si instrument për avokim në lidhje me përmirësimin e

performancës institucionale, ngritjen e qeverisjes së brendshme dhe forcimin e integritetit në Policinë e Kosovës.

1.1. Metodologjia

Për përgatitjen e këtij hulumtimi janë përdorur metodat hulumtuese kualitative. Të dhënat kualitative përfshijnë analizimin e dokumenteve të ndryshme me karakter juridik, strategjitë e institucioneve përkatëse për punën e Policisë së Kosovës, raportet vjetore të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe raporte të organizatave vendore e ndërkombëtare dhe burime të tjera nga institucionet publike të Kosovës.

Të dhënat shtesë janë grumbulluar nga realizimi i intervistave me përfaqësues të institucioneve që mbikëqyrin Policinë e Kosovës dhe njohës të sektorit të sigurisë në Kosovë. Përveç kësaj, grumbullimi i të dhënave për këtë hulumtim është mundësuar edhe nga kontributet e mbledhura nga grupet e fokusit me zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës. Ndërsa, edhe aktivitetet avokuese të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë kanë qenë një burim i rëndësishëm për përpilimin e këtij raporti. Konferencat, takimet dhe aktivitetet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë në fushën e sektorit të sigurisë gjatë vitit 2015 dhe gjysmës së parë të vitit 2016 kanë shërbyer si mundësi e mirë për mbledhjen e të dhënave për këtë hulumtim. Në fund, janë shterur burimet nga arkivat e mediave të Kosovës lidhur me informacionet e raportuara për Policinë e Kosovës, e të cilat kanë pasqyruar të dhëna për integritetin policor.

2. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

2.1. Korniza ligjore

Burimet njerëzore në Polici rregullohen në mënyrë të përgjithshme përmes Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë i miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2012. Sa i përket punësimit të personelit policor, PK-ja, sipas kornizës aktuale ligjore, ka në përbërje a) zyrtarët policor që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe kryejnë autorizimet policore; b) stafin civil për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet për të ushtruar autorizime policore; dhe c) kadetët.¹ Megjithatë,

¹ Neni 44, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

në bazë të të dhënave në dispozicion edhe më tutje mungon ndonjë rregullim më i detajuar e që rregullon prej tyre veç e veç. Në mënyrë po kaq sipërfaqësore është i rregulluar edhe procesi i gradimit brenda për brenda PK-së. Staf civil i PK-së është pjesë e shërbimit civil të Kosovës, ndërsa zyrtarët policor të Policisë nuk bëjnë pjesë në kuadër të shërbimit civil.² As Ligji për Policinë, Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe as Ligji i Punës nuk përshkruajnë se cila është marrëdhënia e punës e zyrtarëve policor.

Duke e marrë parasysh që PK-ja është një institucion me hierarki dhe strukturë komplekse organizative me pothuajse 9,000 punonjës (zyrtarë policor dhe staf civil së bashku), shumë çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore janë të rreguluara përmes akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike të Policisë. Megjithatë, ndryshe nga institucionet tjera publike, PK-ja nuk i publikon aktet e veta nënligjore që rregullojnë çështje të ndryshme me interes për institucionin. Sipas Policisë ato nuk publikohen për shkak se janë kryesisht dokumente që rregullojnë çështje të brendshme të PK-së. Ndërsa, të gjithë ata që duan të kenë qasje në këto dokumente duhet të bëjnë kërkesë zyrtare në Polici, siç e parasheh Ligji për Qasje në Dokumente Publike.³

Sipas Planit Zhvillimor 2016-2020 të PK-së, kjo e fundit do të investojë në profesionalizimin dhe avancimin e burimeve njerëzore. Aty thuhet se rëndësi e madhe do t'i kushtohet ngritjes së avancimit dhe kryerjes së detyrave duke zbatuar standardet më të mira për personelin policor përmes sistemit të menaxhimit të personelit, trajnimeve në vazhdimësi dhe kujdesit ndaj shëndetit.⁴ Në fushën e profesionalizimit të burimeve njerëzore, Policia i ka vënë vetes disa objektiva, siç janë: zhvillimi i karrierës së punonjësve të PK-së në përputhje me performancën në punë; avancimi i sistemit të menaxhimit të personelit në PK; kujdesi shëndetësor për të gjithë të punësuarit përmes kujdesit shëndetësor efikas; dhe ngritja e cilësisë së programeve trajnuese.⁵

2.2. Praktika

Siç dihet, burimet njerëzore në PK janë ngritur, ndihmuar dhe konsoliduar nga bashkësia ndërkombëtare në Kosovë (misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë – UNMIK) e cila ka pas rol vendimmarrës në këtë institucion që prej themelimit (1999) deri në shpalljen e pavarësisë së vendit (2008). Zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore ka vazhduar edhe pas marrjes së kompetencave nga ana e vendorëve. Prandaj, mund të thuhet se PK është në proces të vazhdueshëm të reformimit të brendshëm me qëllim profesionalizimin institucional.

2 Shih Nenin 3 dhe Nenin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

3 Intervistë me një zyrtar të lartë të PK-së, 18 dhjetor 2015.

4 Policia e Kosovës. *Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020*, f. 13. Qasur më 16 prill 2016, në: <<http://goo.gl/3w61BX>>

5 Po aty.

Departamenti i Burimeve Njerëzore (DBNj) në kuadër të PK-së ka për detyrë të zbatojë politikat që ndërliken me personelin dhe trajnimet e ndryshme nëpër të cilat kalojnë punonjësit e këtij institucioni. DBNj duhet të sigurojë që rekrutimi i personelit në PK të bëhet sipas kualifikimeve profesionale dhe meritës në kushtet e konkurrencës së drejtë e të transparencës. Në këtë drejtim, puna e DBNj-së shtrihet në ofrimin e një sistemi efikas për menaxhimin dhe zhvillimin e karrierës të të gjithë personelit policor. Gjithashtu, ky departament duhet të garantojë politika jo-diskriminuese për personelin policor në të gjitha nivelet, përfshirë edhe përfaqësimin e paanshëm gjinor dhe që strukturat e personelit të pasqyrojnë karakterin shumetnik të Kosovës.⁶

Sidoqoftë, Policia ka ofruar të dhëna shumë të mangëta dhe sipërfaqësore sa i përket përshkrimin të vendeve të punës të personelit policor, rekrutimit, vlerësimit të performancës së zyrtarëve policor dhe çështje të tjera lidhur me burimet njerëzore të PK-së.

2.2.1. Buxheti

Buxheti i Policisë së Kosovës për vitin 2015 ka qenë 89,470,530 euro i cili, sipas Policisë, është realizuar ose shpenzuar deri në 99.60 përqind të shumës totale.⁷ Prej këtij buxheti për vitin 2015, afro 72 përqind është shfrytëzuar për paga dhe mëditje, afro 16 përqind për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe afro 8 përqind për shpenzimet kapitale. Ndërsa, pjesa tjetër është shpenzuar për komunalitet (përmbi 1 përqind), për subvencione (afro 2 përqind), të hyrat për subvencione kanë qenë më pak se 1 përqind kurse ato për paga dhe mëditje rreth gjysmë përqind.⁸

Nga ana tjetër, buxheti i Policisë për vitin 2016 është 86,128,721 euro⁹ ose afro 4 përqind më pak në krahasim me vitin 2015. Kjo është kritikuar me arsyen se institucionit të Policisë nuk do të duhej t'i zvogëlohej buxheti për shkak se është në proces të vazhdueshëm të reformave të brendshme dhe ka nevojë për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve teknike, profesionale dhe njerëzore.¹⁰ Zvogëlimi i buxhetit të PK-së për vitin 2016 do të vështirësojë arritjen e qëllimeve të Policisë, si furnizimin me uniforma për pjesëtarët e PK-së, procesin e pensionimit të zyrtarëve policor, rekrutimin e stafit të ri policor, operacionalizimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe çështje të tjera.¹¹

6 Për më shumë detaje lidhur me punën e këtij departamenti të Policisë shih: <<http://goo.gl/sZIGmN>>. Qasur më 16 prill 2016.

7 Po aty, fq. 17

8 Po aty.

9 Shih Ligjin Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

10 KohaVision (KTV), emisioni Puls, "Kush po e rrezikon sigurinë?", 21 mars 2016. Qasur më 27 prill 2016, në: <<https://goo.gl/rfxWE0>>

11 Procesverbali i mbledhjes së Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 20 nëntor 2015, f. 4. Qasur më 26 prill 2016, në: <<http://goo.gl/aQYxll>>

2.2.2. Personeli dhe trajnimet e policëve

PK-ja në radhët e veta aktualisht numëron gjithsej 8,951 punonjës, ku 7,862 prej tyre janë zyrtarë të uniformuar dhe 1,089 të tjerë përbëjnë stafin civil. Në këtë mënyrë, Policia renditet në mesin e atyre institucioneve që kanë numrin më të madh të punonjësve në sektorin publik në vend. Nga ana tjetër, PK-ja nuk ka ofruar të dhëna se sa është paga mujore e zyrtarëve policor.

Tabela 2 - Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të uniformuar dhe stafit civil në PK¹²

Personeli	Numri
Zyrtarë të uniformuar	7,862
Stafi civil	1,089
Gjithsej	8,951

Një sfidë e madhe për PK-në, por edhe për institucionet tjera publike në vend, është zbatimi i normave juridike sa i përket barazisë gjinore. Prej vitit 2015 kur është miratuar Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, në një mënyrë apo tjetër, është bërë e detyrueshme që përfaqësimi gjinor në institucionet publike të jetë 50 përqind për secilën gjini. Ky ligj shprehimisht thotë se *“përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”*.¹³ Një masë e tillë e veçantë do të jetë problematike të vihet në zbatim duke e ditur se ka mospërputhje të madhe sa i përket përfaqësimit gjinor, veçanërisht në sektorin e sigurisë në Kosovë. Në këtë rast, në PK vetëm mbi 13 përqind e të gjithë të punësuarve janë nga radhët e gjinisë femërore, ndërsa rreth 86 përqind janë meshkuj, gjë që e bën vështirë të realizueshme këtë normë. Ligji në fjalë është kritikuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), duke shprehur pikëpamjen që kjo dispozitë duhet të parashikonte një periudhë kalimtare deri në pesë vjet për arritjen e baraspeshës së përfaqësimit gjinor në institucionet publike, përfshirë kështu edhe PK-në. Për më tepër, është shprehur edhe skepticizëm nëse kjo dispozitë do të mund të zbatohet duke u nisur nga fakti që punonjësit tashmë janë në marrëdhënie pune në institucionet përkatëse.¹⁴

12 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. *Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015*, fq. 6. Qasur më 14 prill 2016, në: <<http://goo.gl/H2HvXk>>

13 Neni 6, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

14 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

Tabela 3 - Përfaqësimi gjinor në PK¹⁵

Personeli sipas gjinisë	Përqindja
Meshkuj	86.04%
Femra	13.96%
Gjithsej	100%

Sipas të dhënave statistikore të PK-së, pakicat etnike në Kosovë janë të përfaqësuara mirë dhe në nivel të kënaqshëm në Polici. Rreth 83 përqind e personelit janë nga radhët e popullatës shumicë shqiptare, ndërsa rreth 16 përqind vijnë nga pakicat, duke përfshirë serbë, boshnjakë, turq, goranë, romë, ashkali, egjiptianë dhe pakica të tjera. Megjithatë, PK-ja nuk ka ofruar të dhëna se sa është përqindja e pjesëtarëve të secilës pakicë etnike që punojnë në kuadër të Policisë.

Tabela 4 - Përfaqësimi etnik në PK¹⁶

Personeli sipas përkatësisë etnike	Numri
Shqiptarë	7,501
Pakicat	1,450
Gjithsej	8,951

Në lidhje me trajnimet e zyrtarëve policor gjatë vitit 2015, PK-ja ka organizuar 205 trajnime, ligjërata dhe punëtori për 4,970 pjesëtarë të Policisë, ndërsa 2,354 policë kanë përfunduar ricertifikimin në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Kurse 2,281 zyrtarë policor kanë marrë pjesë në trajnime dhe seminare të organizuara brenda vendit që janë organizuar nga palë të ndryshme, ndërsa 510 policë kanë marrë pjesë në trajnime jashtë vendit.¹⁷ Por as për këto trajnime jashtë vendit PK-ja nuk ka ofruar më shumë informacione dhe të dhëna më të hollësishme.

2.2.3. Pensionimi i zyrtarëve policor

Sfidë e madhe për personelin e Policisë është mosha e zyrtarëve policor duke e bërë PK-në ndër institucionet me moshë më të vjetër të personelit, ku mosha mesatare

¹⁵ Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. *Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015*, f. 6. Qasur më 14 prill 2016, në: <<http://goo.gl/H2HvXk>>

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty, fq. 17.

e pjesëtarëve të PK-së është 43 vjeç.¹⁸ Më shumë se 4,000 policë të Kosovë janë të moshës mbi 40 vjeçare, 2,091 sosh janë mbi moshën 46 vjeç, ndërsa rreth 1,000 prej tyre i përkasin moshës 55 vjeçare.¹⁹ Kjo shtrun nevojën e reformimit të këtij institucioni dhe rekrutimin e stafit të ri në PK. Për të rregulluar këtë çështje është hartuar *Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policor të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore*, në hartimin e të cilit janë të përfshirë MPB-ja, PK-ja dhe sindikata e PK-së.

Në projektligj parashihet që zyrtarët policor dhe punonjësit e IPK-së me autorizime policore fitojnë të drejtën e pensionimit të rregullt atëherë kur arrijnë moshën 55 vjeçare.²⁰ Zyrtarët policorë që do të pensionohen në moshën 55 vjeçare do të marrin 60 përqind të pagës bruto dhe për këtë është arritur pajtim në mes të PK-së, MPB-së dhe Sindikatës së Policisë.²¹

Megjithatë, ky projektligj nuk është miratuar ende nga Qeveria e Kosovës dhe rrjedhimisht nuk i është dërguar Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe miratim. Për më tepër, ligjvënësit që kanë për detyrë mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të punëve të brendshme në Kosovë, përkatësisht MPB-në dhe PK-në, i kanë rekomanduar ekzekutivit të ndajë mjetet buxhetore për zbatimin e projektligjit kur të hyjë në fuqi për përmirësimin e kuotës së moshës së zyrtarëve policor.²² Sipas informatave të Sindikatës së PK-së, zbatimi i ligjit, përkatësisht pensionimi i parakohshëm i zyrtarëve policorë do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës rreth 70 milion euro.²³

Pritet që rreth 1,000 zyrtarë policor do të pensionohen dhe po aq do të rekrutohen kur të bëhet i plotfuqishëm legjislacioni për pensionimin e zyrtarëve policor. Sa i përket punësimit të pjesëtarëve të Policisë, PK-ja do të duhej t'i kushtonte vëmendje më të madhe garantimit të një procesi të drejtë e transparent në përzgjedhjen e kandidatëve për zyrtarë policor për të shmangur çfarëdo mundësie të nepotizmit ose konfliktit të interesit. Plotësimi i stafit me një numër aq të madh përbën një sfidë të madhe në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

18 Procesverballi i mbledhjes së Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 22 dhjetor 2015, fq. 3. Qasur më 26 prill 2016, në: <<http://goo.gl/XmigBY>>

19 Shih: <<http://goo.gl/EQMyUV>>. Qasur më 26 prill 2016.

20 Neni 6, Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policor të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore.

21 Deklaratë e nënkryetarit të Sindikatës së Policisë së Kosovës, Shaban Tasholli, në emisionin Kontakt Intervista të Tribuna Channel, 17 maj 2016, në: <<https://goo.gl/vThMe3>>. Qasur më 21 maj 2016.

22 Procesverballi i mbledhjes së Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 22 dhjetor 2015, f. 3. Qasur më 26 prill 2016, në: <<http://goo.gl/XmigBY>>

23 Deklaratë e nënkryetarit të Sindikatës së Policisë së Kosovës, Shaban Tasholli, në emisionin Kontakt Intervista të Tribuna Channel, 17 maj 2016, në: <<https://goo.gl/vThMe3>>. Qasur më 21 maj 2016.

2.2.4. Gradimi

Në lidhje me procesin e gradimit në Polici, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Policisë i vlerëson nevojat e stafit policor për gradim dhe ia paraqet kërkesën për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.²⁴ Gjatë vitit 2015 janë graduar gjithsej 65 zyrtarë policor, përkatësisht 27 prej tyre janë graduar në togerë dhe 38 pjesëtarë të PK-së në gradën e rreshterit.²⁵ Ndërsa, gjatë vitit 2016 (deri në muajin prill) janë graduar gjithsej 199 zyrtarë policor në gradën e rreshterit si mbikëqyrës të nivelit të parë.²⁶ Nuk ka informacione dhe shpjegime lidhur me gradimet e mundshme në nivelet strategjike.

Ky proces është mbikëqyrur më herët nga nga misionet e UNMIK-ut dhe EULEX-it, por nuk është mbikëqyrur në mënyrë të mirëfilltë dhe në baza të rregullta edhe nga institucionet vendore. Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Policinë për vitin 2015, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës i Kuvendit të Kosovës i ka rekomanduar Policisë reformimin e procesit të gradimit. Për më tepër, sipas mbikëqyrjes parlamentare që ka bërë ky Komision, me përjashtim të dy gradave (polic i ri dhe polic), avancimi në grada të tjera është i pafatizuar dhe është në varësi të nevojave të strukturës së Policisë për gradën e caktuar. Gjithashtu, i njëjti Komision Parlamentar ka kërkuar që në kuadër të gradimeve të vendoset si kriter shtesë për avancim edhe niveli i shkollimit të kryer nga zyrtarët policor.²⁷

Në vitin 2015 IPK-ja ka bërë një inspektim të jashtëzakonshëm për gradimin në PK dhe ka gjetur disa parregullsi lidhur me atë se si DBNj e Policisë kishte udhëhequr me procesin e konkurseve për gradim gjatë viteve 2012-2013. Në inspektimin e IPK-së thuhet se me rastin e gradimeve PK-ja kishte themeluar një komision duke mos përfilur procedurën ligjore dhe kishte caktuar si anëtarë të komisionit zyrtarë policor nga DBNj-ja, të cilat nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë ose pjesë e këtyre komisioneve për gradim. Aty thuhet se një numër i madh i aplikacioneve të zyrtarëve policor për t'u graduar ishin pranuar duke qenë të paplotësuar dhe se nuk ishin plotësuar hapësirat tek të dhënat e pranimit-dorëzimit të aplikacionit. Përveç këtyre mangësive, gjithashtu ishte evidentuar se në disa raste llogaritjet e përgjithshme të pikëve të vlerësimit në gradim ishin ngritur apo zbritur duke shkaktuar kështu mospërputhje ndërmjet pikëve vlerësuese nëpër kritere dhe numrit total të pikëve.²⁸

24 Kontributet e mbledhura nga grupi i fokusit i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.

25 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. *Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015*, fq. 17. Qasur më 14 prill 2016, në: <<http://goo.gl/H2HvXk>>

26 Shih komunikatat e PK-së për gradimin e pjesëtarëve të Policisë gjatë muajve mars dhe prill të vitit 2016: <<http://goo.gl/H9d4Vl>> dhe <<http://goo.gl/KFL06K>>. Qasur më 27 prill 2016.

27 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). *Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë*, f. 2.

28 Inspektorati Policor i Kosovës – Departamenti i Inspektimeve. (2015). *Raport Inspektimi Nr: 7/2015 – Inspektimi i procesit të gradimit në Policinë e Kosovës*, f. 26. Qasur më 27 prill 2016, në: <<http://goo.gl/ondHb1>>

Lidhur me këto dobësi në gradim, IPK-ja i kishte rekomanduar DBNj-së së PK-së që për gradim të përfillë të gjitha procedurat ligjore që rregullojnë gradimin e pjesëtarëve të Policisë. Rekomandim tjetër ka qenë që Policia të jetë e kujdesshme gjatë pranimit të aplikacioneve në mënyrë që ato të jenë të kompletuara dhe të plotësohen në tërësi nga ana e pjesëtarëve të Policisë të cilët shprehin interesim për marrjen e gradave të caktuara sipas nevojave të strukturës së PK-së.²⁹ PK-ja nuk ka ofruar të dhëna nëse janë përfillur këto rekomandime të IPK-së.

Ka dyshime se zhvillimi në karrierë përmes procesit të gradimit nuk bëhet njëjtë kur bëhet fjalë për ata pjesëtarë të Policisë që i takojnë komuniteteve pakicë në Kosovë. Në këtë drejtim, PK-ja është kritikuar se nuk zbaton në mënyrë të përpiktë kriteret për pakicat sikurse i zbaton për zyrtarët policor nga radhët e popullatës shumicë. Për më tepër, ekzistojnë supozime se pjesëtarët e Policisë nga pakicat favorizohen duke kaluar më lehtë në testim dhe se marrin grada në afate shumë të shpejta, duke mos arritur t'i plotësojnë kriteret për gradat e caktuara për shkak të ekzistimit të sistemit të kuotës për gradim për pakicat etnike.³⁰ Në këtë drejtim, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, të gjithë zyrtarët policor duhet t'i nënshtrohen kriterëve dhe procedurave të gradimit në mënyrë të njëjtë e të barabartë.

2.2.5. Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi jetësor

Policët e Kosovës përballen me mungesën e sigurimit shëndetësor. Kjo çështje nuk është rregulluar nga Qeveria e Kosovës, ndërsa legjislati aktual parasheh sigurimin social për zyrtarët policorë, por Qeveria ende nuk ka ndarë buxhet për sigurimin social për policët. Prej janarit të vitit 2017 pritet të fillojë sigurimi shëndetësor për punonjësit e Policisë. Për këtë çështje ka zhvilluar takime Sindikata e Policisë me Minsitrinë e Shëndetësisë për të gjetur format e sigurimit shëndetësor për personelin policor.³¹ Megjithatë, nuk dihen detajet se si do të bëhet sigurimi shëndetësor për punonjësit e këtij institucioni.

Sindikata e PK-së e ka ngritur çështjen e sigurimit shëndetësor për punonjësit e Policisë duke kërkuar nga Qeveria ndarjen e mjeteve buxhetore për realizimin e të drejtës për sigurim shëndetësor për policët. Kjo për shkak se ka shumë policë të lënduar gjatë kryerjes së detyrës dhe si pasojë e sëmundjeve të ndryshme.³² Megjithatë, Sindikata e Policisë do të duhej të jetë më e zëshme dhe më aktive për t'i bërë presion pozitiv

²⁹ Po aty, fq. 27.

³⁰ Intervistë, Kreshnik Gashi, Redaktor në BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese), 3 prill 2016.

³¹ Deklaratë e nënkryetarit të Sindikatës së Policisë së Kosovës, Shaban Tasholli, në emisionin Kontakt Intervista të Tribuna Channel, 17 maj 2016, në: <<https://goo.gl/vThMe3>>. Qasur më 21 maj 2016.

³² Rexhepi, K. (6 shkurt 2016). Sindikata e Policisë Kërkon Sigurim Shëndetësor. *Kallxo.com*. Qasur më 28 prill 2016, në: <<http://goo.gl/EuXjur>>

Qeverisë për realizimin e të drejtave të personelit policor në rrafshin e sigurimit shëndetësor dhe krijimin e kushteve më të mira për zyrtarët policor.

Përveç mungesës së sigurimit shëndetësor, policët e Kosovës nuk e gëzojnë as sigurimin jetësor në kuadër të punës së tyre. Ky lloj siguri është i nevojshëm për çdo zyrtar policor për shkak të lëndimeve serioze dhe plagëve që mund të marrin në detyrë. Në mungesë të sigurimit jetësor policët të cilët pësojnë nga lëndimet nuk marrin as dëmshpërblime për plagët, me përjashtim të ndihmave dhe tretmanit mjekësor që marrin për lëndime.³³

3. KONTROLLI I BRENDSHËM

3.1. Dokumentet për promovimin e integritetit dhe luftimin e korrupsionit në PK

Ngritja e integritetit institucional manifestohet përmes luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të mekanizmave të brendshëm kundër korrupsionit dhe dukurive të tjera negative. Andaj në këtë drejtim do të shqyrtohen kapacitetet e PK-së për qeverisje të mirë brendapërbrenda institucionit të Policisë.

Sa i përket integritetit policor, Policia e Kosovës e ka Kodin e Etikës i hartuar qysh në kohën kur ajo njihet si Shërbimi Policor i Kosovës në periudhën e UNMIK-ut. Në të thuhet se detyrat e zyrtarëve policor nuk janë vetëm çështje formale që burojnë nga Kushtetuta, ligji dhe aktet nënligjore, por përfshijnë një kuptim më të gjerë të drejtave. Me këtë nënkuptohet se zyrtarët policor duhet të jenë të vetëdijshëm edhe për vlerat morale e etike të cilat përcaktojnë rolin e Policisë në shoqëri.³⁴ Personeli policor është i ngarkuar me përgjegjësinë për të demonstruar gjykim të shëndoshë, maturi, paanshmëri, ndershmëri neutralitet, përgjegjshmëri, vetëpërbajtje dhe aftësi komunikimi.³⁵

Lidhur me parandalimin e korrupsionit, Kodi i Etikës i PK-së thekson se zyrtari policor duhet të jetë i vendosur dhe imun ndaj çdo forme të mitos ose ryshfetit. Sipas këtij dokumenti, në të gjitha nivelet e organizimit dhe në strukturën e Policisë parashikohen masa të efektshme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në PK.³⁶

33 Intervistë, Kreshnik Gashi, Redaktor në BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese), 3 prill 2016.

34 Neni 4, Kodi i Etikës së Policisë së Kosovës.

35 Po aty, Neni 15.

36 Po aty, Neni 23 dhe Neni 25.

Megjithatë, për të konsoliduar qeverisjen e brendshme dhe për të parandaluar korrupsionin në Polici kjo e fundit ende nuk e ka planin për zhvillimin e integritetit institucional (ose Planin e Integritetit). Ky plan do të duhej të shërbente si udhërrëfyes për PK-në për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme në Polici dhe të aferave të ndryshme të korrupsionit dhe mitos. Gjithashtu, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit më të mirë dhe adekuat të buxhetit të PK-së, sidomos për shpenzimet që kanë të bëjnë me aktivitetet e Policisë në fushën e prokurimit publik. Jo vetëm kaq, por plani i integritetit do të duhet të vinte theksin edhe tek parandalimi i keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar të personelit policor gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Planin e integritetit duhet të përmbajë planin e veprimit që do të parashihte objektivat e Policisë për periudhën pesëvjeçare për zhvillimin e integritetit dhe besueshmërisë së forcave të rendit. Ndërsa, për zbatimin e tij do të duhej të jenë përgjegjës mekanizmat për kontrollin e brendshëm të Policisë me detyra dhe afate të përcaktuara qartazi.

Mungesa e planit të integritetit është konstatuar edhe në Strategjinë kundër korrupsionit 2013-2017. Në këtë dokument thuhet se këto plane kanë për qëllim të sigurojnë që çdo punonjës publik duhet të respektojë rregullat etike dhe integritetin për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit në minimum,³⁷ përfshirë edhe institucionin e Policisë. Për luftimin e korrupsionit dhe ndërtimin e besimit, kjo strategji apelon për forcimin e kontrollit të brendshëm e të mekanizmave disiplinorë brenda PK-së.³⁸ Për më tepër, PK-së i është kërkuar të organizojë trajnime në fushën e menaxhimit dhe hetimit të korrupsionit, si dhe të kryejë kontroll efektiv të brendshëm me qëllim uljen e korrupsionit policor.³⁹ Nuk dihet se deri në çfarë mase PK-ja i ka arritur objektivat e kësaj strategjie dhe ato të planit të veprimit për luftimin e korrupsionit policor. PK-ja nuk ka ofruar të dhëna për rezultatet e punëve të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të Policisë kundër korrupsionit policor.

Ndërkohë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, PK-ja pritet të nis një pilot-projekt të integritetit policor për parandalimin e korrupsionit përmes një sistemi të paralajmërimit të hershëm. Ky sistem parashihet që Policia të ketë zyrtarë të veçantë që merren vetëm me luftimin e korrupsionit që mund të ndodh brenda institucionit. Gjithashtu, menaxhmenti i lartë i Policisë, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të saj do të këshillohen për të ndërmarrë me kohë masa parandaluese për luftimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit në PK.⁴⁰

37 Agjencia kundër Korrupsionit. (Nëntor 2012). *Strategjia kundër korrupsionit 2013-2017*. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, fq. 22. Qasur më 6 maj 2016, në: <<http://goo.gl/MxxdS9>>

38 Po aty, f. 27.

39 Agjencia kundër Korrupsionit. (Nëntor 2012). *Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë kundër korrupsionit 2013-2017*. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, fq. 28-29. Qasur më 6 maj 2016, në: <<http://goo.gl/MxxdS9>>

40 Kontributet e mbledhura nga dëgjimi publik i Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë më 15 dhjetor 2015.

Pavarësisht se qytetarët kanë perceptim përgjithësisht pozitiv për PK-në, qytetarët kanë shprehur dyshimin dhe frikën të bashkëpunojnë për raportimin e rasteve të ndryshme në Polici. Më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar kanë frikë se mund t'ju zbulohet identiteti nga PK-ja.⁴¹ Kjo nënkupton se PK-ja duhet të punojë më shumë në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve në mënyrë që kështu ata të inkurajohen për raportimin e rasteve në PK.⁴²

3.2. Kontrolli i brendshëm në Polici

Policia e Kosovës i ka mekanizmat e vet të kontrollit të brendshëm përmes të cilëve mbikëqyrë, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve policor gjatë detyrës zyrtare. Këta mekanizma kanë të drejtë të hetojnë të gjitha rastet disiplinore për shkelje të rënda dhe të lehta deri në gradën e nënkolonelit policor, por jo edhe zyrtarët policor me grada më të larta dhe stafin ekzekutiv të Policisë.⁴³ Inicimi i lëndëve disiplinore brenda për brenda PK-së ndaj personelit policor bëhet në tri mënyra: (i) përmes inicimit të brendshëm nga ana e mbikëqyrësit, (ii) me ankesë të qytetarit dhe (iii) sipas detyrës zyrtare. Përveç kësaj, mekanizmat policor të kontrollit të brendshëm janë përgjegjës për shqyrtimin dhe shqiptimin e masave disiplinore për lëndët disiplinore që hetohen brenda PK-së.⁴⁴

Gjatë vitit 2015 janë trajtuar 948 raste të ndryshme në të cilat kanë qenë të përfshirë zyrtarët policor të PK-së për shkak të dyshimit se kanë bërë shkelje të ndryshme. Sipas të dhënave të Policisë, gjatë hetimeve të bëra del se në 56 përqind të këtyre rasteve, akuzat nuk janë argumentuar. Ndërsa, rreth 3 përqind të numrit total të rasteve janë shqiptuar masat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për 0.1 përqind të rasteve është shqiptuar masa e degradimit dhe për rreth 25 përqind të rasteve janë shqiptuar masa e ndalimit në pagë. Kurse, në afro 9 përqind të rasteve u shqiptua masa e vërejtjes me shkrim, për mbi 1 përqind të rasteve ishte shqiptuar masa e vërejtjes gojore dhe 4 përqind e atyre që ishin hetuar u liruan nga akuzat.⁴⁵ Pavarësisht këtyre statistikave, PK-ja nuk ka specifikuar qartazi se për cilat vepra apo raste ishin hetuar zyrtarët policor gjatë vitit 2015.

Në kuadër të kontrollit të brendshëm policor në vitin 2015 janë realizuar 13 auditime të rregullta dhe 1 auditim i jashtëzakonshëm nga Zyra e Auditimit e Policisë. Ato kanë prekur fushën e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me prokuri-

41 Po aty, fq. 24.

42 Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë kundër Korrupsionit, 15 shkurt 2016.

43 Përgjigjet me shkrim të PK-së të dërguara në formë elektronike në QKSS më 29 prill 2016.

44 Po aty.

45 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. *Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015*, f. 17. Qasur më 14 prill 2016, në: <<http://goo.gl/H2HvXk>>

min, financat dhe menaxhimin e pasurisë në PK, por edhe me zbatimin e procedurave administrative për personelin e PK-së. Gjatë procesit të këtyre auditimeve janë dhënë 89 rekomandime për auditimet e rregullta dhe 3 rekomandime nga fusha e auditimit të jashtëzakonshëm.⁴⁶ Megjithatë, PK-ja nuk ka ofruar të dhëna se sa prej këtyre rekomandimeve janë adresuar tashmë apo se çfarë veprimesh janë ndërmarrë për përmirësimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Policia bën edhe inspektime për personelin policor përmes Njësisë së Inspektimit në kuadër të PK-së. Gjatë vitit 2015 janë bërë 314 inspektime të rregullta dhe 121 inspektime të jashtëzakonshme. Këto inspektime janë realizuar në fushën e mbajtjes së disiplinës në Polici, ndërsa janë dhënë gjithsej 906 rekomandime për inspektime.⁴⁷ Njëjtë si me rastet paraprake, nuk ka të dhëna nga Policia se sa prej këtyre rekomandimeve janë plotësuar dhe cilat fusha të Policisë janë prekur nga inspektimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Me gjithë këto statistika, puna e mekanizmave të kontrollit të brendshëm të Policisë, veçanërisht e Drejtorisë së Standardeve Profesionale (DSP) është kritikuar për mungesë të transparencës. DSP-ja, e cila funksionon në kuadër të zyrës së zëvendës-drejtorit të Përgjithshëm të PK-së për Operativ, nuk i bënë të ditura rastet për të cilat bën hetime të brendshme për shkeljet disiplinore të personelit policor. Rrjedhimisht bëhet edhe më jotransparent procesi i vlerësimit të kontrollit të brendshëm policor në kushtet kur nuk dihet se për cilat vepra ose shkelje konkrete hetohen zyrtarët policor.⁴⁸

3.3. Roli i IPK-së në mbikëqyrjen e Policisë

Ndonëse Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është mekanizëm që funksionon nën autoritetin e MPB-së, megjithatë si strukturë është e ndarë nga PK-ja dhe vepron në mënyrë të pavarur prej saj. Ajo ka për detyrë kryesore të mbikëqyrë aktivitetet e Policisë me qëllim të demokratizimit dhe profesionalizimit të saj.

Në ushtrimin e veprimtarisë së vet, IPK-ja ka të drejtë të bëjë hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë pavarësisht gradës apo pozitës që mbajnë. Kjo nënkupton që IPK-së i është rezervuar autorizimi për hetimin e të gjithë personelit policor në rastet kur ka dyshim se ata janë të përfshirë në vepra të ndryshme penale. Në kuadër të hetimeve që bëjnë, IPK-ja është e ngarkuar edhe me përgjegjësinë për hetimin e incidenteve disiplinore të profilit të lartë. Gjithashtu, ajo kryen hetime disiplinore të zyrtarëve policor me gradën më të lartë dhe të nivelit të lartë, pra edhe të

46 Po aty.

47 Po aty.

48 Intervistë, Kreshnik Gashi, Redaktor në BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese), 3 prill 2016.

menaxhimit dhe të zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv në Polici.⁴⁹ Ndërkaq, ajo që e dallon punën e këtij institucioni është se çdo qytetar mund të ushtrojë ankesë në IPK ndaj pjesëtareve të PK-së nëse supozojnë se këta të fundit kanë rënë në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi. Përkundër aktiviteteve në mbikëqyrjen e Policisë, IPK-ja nuk është edhe aq transparente në raport me mediat dhe shoqërinë civile kur bëhet fjalë për ofrimin e informacionit meqë zakonshëm ofrojnë informacione të mangëta për punën që bëjnë.

Gjatë vitit 2015, IPK-ja ka pranuar 1,237 ankesa nga qytetarët, 173 prej të cilave gjatë shqyrtimit nga ana e Departamentit të Hetimeve në IPK-së kanë rezultuar të kenë elemente të veprave penale. Prej këtyre rasteve të kategorizuara me elemente të veprës penale, 161 sosh janë dërguar nga IPK-ja për t'u hetuar në Prokurori me kallëzim penal ose me raport të veçantë, ndërsa 12 ankesa të tjera ende janë në proces të hetimit nga IPK-ja duke u bartur në vitin 2016.⁵⁰ Prokuroritë përkatëse kanë ngritur aktakuzë për 24 raste duke i cilësuar si penale, duke i proceduar në gjykatat kompetente. Kurse, 7 kallëzime penale janë hedhur poshtë nga prokuroritë në mungesë të fakteve, megjithëse 77 kallëzime penale të tjera janë akoma në proces të hetimit nga Prokuroria.

Në raport me Policinë në vitin 2015 IPK-ja ka bërë 23 arrestime, 39 rekomandime për suspendime të personelit policor dhe 11 rekomandime për transfere.⁵¹ Një prej rekomandimeve të IPK-së për suspendim ishte edhe ai për Drejtorin Rajonal të PK-së në Prizren në shtator të vitit 2015. IPK-ja kishte rekomanduar PK-së suspendimin e këtij zyrtari policor pas ndërmarrjes së disa veprimeve hetimore preliminare dhe pasi kishte pranuar informata e ankesa nga qytetarët.⁵² Ndonëse, i suspenduar nga puna dhe i hetuar nga IPK-ja, ai ishte kthyer në vendin e punës, përkatësisht ishte transferuar si shef i operativës në Drejtorinë Rajonale të Policisë (DRP) në Gjakovë⁵³ për t'u rikthyer në Prizren si drejtor rajonal i PK-së për këtë rajon.⁵⁴ Ndërsa, nuk dihet për rezultatin e hetimeve që IPK-ja kishte zhvilluar ndaj tij.

Në vitin 2015 IPK-ja ka hetuar gjithsej 220 punonjës të PK-së, duke përfshirë zyrtarë policor dhe stafin civil të Policisë. Trendi i punonjësve të PK-së që hetohen nga IPK-ja është në rënie nëse krahasohet me vitet paraprake. Për shembull, në vitin 2014, subjekt i hetimit të IPK-së ishin 305 punonjës të Policisë, në vitin 2013 ishin 328 sosh, ndërsa në vitin 2012 numri i zyrtarëve të PK-së të hetuar nga IPK-ja ishte gjithsej 361.

49 Neni 17, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

50 Inspektorati Policor i Kosovës. *Raporti vjetor 2015*, fq. 23-24. Qasur më 5 maj 2016, në: <<http://goo.gl/W00DT>>

51 Po aty, fq. 25.

52 Shih rekomandimin e IPK-së për suspendimin e drejtorit rajonal të PK-së në Prizren, Nexhmi Krasniqi, në: <<http://goo.gl/axHfza>>. Qasur më 5 maj 2016.

53 Shih <<http://goo.gl/6DMt36>>. Qasur më 5 maj 2016.

54 Shih <<http://goo.gl/HqeQEa>>. Qasur më 5 maj 2016.




Figura 1 - Numri i punonjësve të Policisë të hetuar nga IPK-ja gjatë viteve 2012-2015⁵⁵

Ndërkaq zyrtarët e PK-së që i janë nënshtuar hetimeve penale nga IPK-ja në vitin 2015 përfshijnë zyrtarë policor të gradave të ndryshme dhe personelin civil. Rrjedhimisht, janë hetuar 43 zyrtarë të graduar (2 kolonelë, 1 nënkolonel, 2 majorë, 3 kapitenë, 9 togerë dhe 26 rreshterë), 159 zyrtarë policor dhe 18 punonjës nga radhët e stafit civil.⁵⁶ Sidoqoftë, IPK-ja nuk ka ofruar të dhëna se për çka janë dyshuar dhe për cilat vepra janë hetuar këta zyrtarë të PK-së në vitin 2015.

Për rastet e hetuara nga IPK-ja me elemente të veprës penale dhe elemente të shkeljeve disiplinore, PK-ja ka shqiptuar masa të ndryshme disiplinore për personelin policor. Në këtë mënyrë, për ato raste me elemente të veprës penale janë dhënë 30 masa disiplinore, kurse ankesat që kanë pasur të bëjnë me shkelje disiplinore janë dhënë 577 masa disiplinore nga vet PK-ja për punonjësit e saj.

⁵⁵ Inspektorati Policor i Kosovës. *Raporti vjetor 2015*, fq. 20. Qasur më 5 maj 2016, në: <<http://goo.gl/W00DTr>>

⁵⁶ Po aty, fq. 28.

Tabela 5 - Masat disiplinore të shqiptuara nga PK-ja gjatë vitit 2015⁵⁷

Masat disiplinore	Te veprat penale	Te shkeljet disiplinore	Gjithsej
Vërejtje me gojë	1	182	183
Vërejtje me shkrim	4	119	123
Ndalesë në pagesë prej 5% deri 20% e pagës mujore bruto deri në 2 muaj	0	245	258
Ndalesë në pagesë prej 21% deri 30% e pagës mujore bruto nga 2 deri në 6 muaj	13		
Degradim	0	1	1
Ulje në pozitë	0	0	0
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	12	30	42
Gjithsej	30	577	607

Gjykatat e Kosovës në vitin 2015 kanë marrë 4 vendime sipas hetimeve që ka realizuar paraprakisht IPK-ja. Tri prej këtyre vendimeve gjyqësore përfshijnë dënim me gjobë në vlerë prej 2,000 euro, 400 euro dhe 300 euro. Ndërsa, një vendim tjetër ka të bëjë me dënim prej pesë muajve burgim me kusht. Megjithatë, IPK-ja nuk ka specifikuar se për kë bëhet fjalë për këto vendime dhe se cilat nivele të PK-së kanë prekur këto vendime të gjykatave. Njëri prej vendimeve ishte marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe tri vendime të tjera nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.⁵⁸

Rastet për të cilat IPK-ja ka bërë hetime në PK përfshijnë rrezikimin e trafikut publik, rastet e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, rastet e lëndimit trupor, raste të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, rastet e marrjes së rryshfetit dhe raste të kanosjes.

Tabela 6 - Rastet me të shpeshta të hetuara nga IPK-ja në vitin 2015⁵⁹

Rastet e hetuara	Numri i rasteve
Rrezikim i trafikut publik	45 raste
Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	39 raste
Lëndim i lehtë trupor	27 raste
Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare	12 raste
Marrje e rryshfetit	11 raste
Gjithsej	134 raste

⁵⁷ Po aty, fq. 26.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty.

Në vitin 2015, IPK-ja ka hetuar gjithsej 62 vepra penale me elemente të korrupsionit dhe vepra të tjera kundër detyrës zyrtare, siç shihet në tabelën e mëposhtme. Mirëpo nuk dihet nëse këto raste janë hetuar në bazë të ankesave që kanë dorëzuar qytetarët në IPK apo janë iniciuar nga vet IPK-ja.

Tabela 7 - Veprat penale me elemente të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare të hetuara nga IPK-ja gjatë vitit 2015⁶⁰

Vepra penale të hetuara për korrupsion dhe vepra të tjera	Numri i veprave penale
Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	39 vepra penale
Falsifikim i dokumentit zyrtar	4 vepra penale
Marrja e ryshfetit	11 vepra penale
Ushtrim i ndikimit	1 vepra penale
Zbulim i fshehtësisë zyrtare	2 vepra penale
Dhënia e ryshfetit	1 vepra penale
Përvetësimi në detyrë	2 vepra penale
Mashtrimi	2 vepra penale
Konflikti i interesit	0 vepra penale
Gjithsej	62 vepra penale

IPK-ja, në kuadër të aktiviteteve për mbikëqyrjen e PK-së, bën inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Për dallim prej PK-së që bën inspektime të nivelit fillestar, inspektimet e IPK-së shtrihen në nivel më të lartë, siç janë: ndërtesat e Policisë; infrastrukture e asetet përcjellëse; menaxhimi i buxhetit, financave, logjistikën dhe prokurimin; menaxhimin e flotës së automjeteve dhe pajisjeve policore; menaxhimin e burimeve njerëzore; si dhe çështje të tjera.⁶¹ Gjatë vitit 2015 IPK-ja ka bërë 8 inspektime në Polici, përkatësisht 5 inspektime të rregullta dhe 3 inspektime të jashtëzakonshme. Prej këtyre inspektimeve të realizuara nga Departamenti i Inspektimeve i IPK-së janë dhënë 54 rekomandime për PK-në ku janë treguar indikatorët e rrezikut për shkelje të mundshme ligjore dhe keqmenaxhim nga PK-ja.⁶² Raportet e inspektimit të IPK-së për vitin 2015 kanë të bëjnë me performancën policore në menaxhimin e turmave gjatë protestave qytetare, menaxhimin e flotës së automjeteve dhe logjistikës, për procesin e gradimit të zyrtarëve policor, etj.⁶³

60 Po aty, fq. 27.

61 Për më shumë shih Nenin 25, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

62 Inspektorati Policor i Kosovës. *Raporti vjetor 2015*, fq. 34. Qasur më 5 maj 2016, në: <<http://goo.gl/W00DTr>>

63 Për më shumë shih raportet e inspektimit të IPK-së në: <<http://goo.gl/6cLKRi>>. Qasur më 6 maj 2016.

Përveç hetimeve penale dhe disiplinore, si dhe inspektiveve, IPK-ja ka të drejtë edhe të bëjë hetimin e integritetit të punonjësve të PK-së sipas autorizimit nga ana e prokurorit. Kjo për shkak të ruajtjes së etikës dhe integritetit, përkatësisht për të rritur përpjekjet për luftimin e korrupsionit dhe rritjen e besimit në institucionin e Policisë.⁶⁴ Divizioni për Hetime Proaktive dhe Testin e Integritetit që funksionon në kuadër të Departamentit për Hetime Speciale në IPK merret me rastet e organizimit të testeve të integritetit për zyrtarët policorë. Sipas IPK-së, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nuk e parasheh veprën penale të hetimit të integritetit për zyrtarët policorë, gjë që ka pamundësuar zhvillimin e testeve të integritetit për punonjësit e Policisë.⁶⁵

Sidoqoftë, zyrtarë të lartë të IPK-së kanë pranuar se kanë bërë teste për hetimin e integritetit me disa zyrtarë policorë. Disa prej tyre e kanë kaluar me sukses testin e integritetit, por ka pasur një rast kur një punonjës i Policisë kanë rënë nga testi i integritetit.⁶⁶ Në rrethanat kur zyrtarët e PK-së nuk e kalojnë testin e integritetit, IPK-ja përdor teknika dhe metoda të veçanta hetimore pas një autorizimi nga ana e prokurorit. Këto teknika dhe metoda të veçanta hetimore përfshijnë masat e vëzhgimit dhe përgjimit.⁶⁷ Por, në IPK shpeshherë janë ankuar se nuk kanë mundur të bëjnë shumë sa i përket hetimit të integritetit policor meqë prokurorët nuk i kanë dhënë autorizim IPK-së të hetojë integritetin e zyrtarëve policorë.⁶⁸

Megjithatë, nuk dihet saktë se sa teste për hetimin e integritetit janë realizuar nga IPK-ja, në cilën periudhë janë bërë ato dhe cili ka qenë rezultati i saktë i tyre. Në raportet vjetore të IPK-së për vitin 2014 dhe 2015 nuk përmendet asgjë lidhur me testin e integritetit. Ndërkohë, duket se ekziston një tendencë nga ana e IPK-së që mos t'i bëjë të njohura e t'i mbajë "sekrete" për publikun rastet e testit të integritetit.⁶⁹

64 Neni 20, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

65 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, fq. 20. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

66 Gjatë dëgjimit publik të Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë më 15 dhjetor 2015, drejtoresha e Departamentit për Hetime Speciale në IPK, Valbona Osmani, ka raportuar për rastet e testeve të hetimit të integritetit që ka bërë divizioni përkatës i IPK-së ndaj disa zyrtarëve policorë.

67 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, fq. 20. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

68 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). *Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë*, fq. 10-11.

69 Kontributet e mbledhura nga dëgjimi publik i Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë më 15 dhjetor 2015.

4. PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE E POLICISË

Sipas legjislacionit në fuqi, Policia e Kosovës është institucion që ushtron veprimtarinë e vet në kuadër të fushëveprimit të MPB-së.⁷⁰ Ndërsa, funksionon nën autoritetin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe i jep llogari drejtpërdrejt ministrit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e Policisë. Megjithatë, autoriteti i ministrit “nuk përfshinë menaxhimin operacional të Policisë.”⁷¹ Sidoqoftë, sipas Kushtetutës së Kosovës, kryeministri e emëron drejtorin e Përgjithshëm të PK-së.⁷² Drejtori i Përgjithshëm i PK-së zgjedhet pa ndonjë konkurs publik dhe sipas praktikës së emërimeve të mëhershme, ai kryesisht është zgjedhur nga radhët e zyrtarëve policor që kanë qenë zëvendës drejtorë të Përgjithshëm të PK-së. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe zëvendës drejtorët e përgjithshëm emërohen për një mandat pesëvjeçar, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë vjet, nga autoriteti që i ka emëruar.⁷³

Emërimi i tyre nga Qeveria nënkupton se jo vetëm drejtori i përgjithshëm, por edhe zëvendësit e tij varen nga Qeveria sa i përket emërimit në këto poste. Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i PK-së ka të drejtë të emëroj drejtorët e departamenteve të PK-së, drejtorët rajonalë të Policisë, si dhe komandantët e stacioneve Policore.⁷⁴ Në këtë mënyrë, Qeveria ushtron kontrollin dhe ndikimin ekzekutiv në zgjedhjen e menaxhmentit të lartë të PK-së. Bashkë me këtë, PK-ja gjithashtu, varet financiarisht nga Qeveria duke pasur parasysh se kjo e fundit e ndanë buxhetin për Policinë. Kur është fjala për buxhetin e PK-së, drejtori i përgjithshëm i Policisë e përgatit atë dhe ia përcjell ministrit për shqyrtim.⁷⁵

Mundësia e ndikimit politik në vendimmarrjen e Policisë ilustronhet përmes rasteve të shqyrtuara në vijim. Gjetjet e mëposhtme tregojnë se ka ndërhyrje të jashtme në punën dhe autonominë e këtij institucioni.

4.1. Suspendimi i zyrtarëve policor në Prizren

Rasti për të cilin mendohet se ka pasur ndërhyrje të drejtpërdrejtë politike mbi punën e PK-së, është ai kur dy policë të rajonit të Prizrenit i kishin shqiptuar një gjobë për

70 Neni 4, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

71 Po aty, Neni 5.

72 Neni 128, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIV).

73 Neni 37, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

74 Po aty, Neni 37, Neni 40 dhe Neni 41.

75 Po aty, Neni 51.

parkim të gabuar të veturës shoferit të një ministri të Qeverisë së Kosovës.⁷⁶ Duke pretenduar se policët kishin treguar sjellje të pahijshme, ministri ishte ankuar tek drejtori i DRP-së në Prizren.⁷⁷ Në të njëjtën kohë, pos ankesës, zyrtari i lartë politik i ekzekutivit kishte ushtruar ndikimin e tij politik për suspendimin e policëve nga puna.⁷⁸ Me vendim të drejtorit të DRP-së në Prizren dy policët ishin suspenduar përkohësisht nga ushtrimi i detyrave të punës dhe autorizimeve policore në afat prej 48 orëve. Për më tepër, në vendim thuhej se policët kishin bërë “shkelje të rëndë disiplinore” dhe suspendimi më pas u ishte zgjatur edhe për 3 muaj të tjerë.

Rasti ishte hetuar nga IPK-ja, e cila kishte konstatuar se dy policët nuk kishin bërë shkelje ligjore dhe se në veprimet e tyre nuk ka pasur elemente të veprës penale.⁷⁹ Për të hequr dilemat, Policia ka bërë hetime të brendshme disiplinore me çka edhe ishin hedhur poshtë pretendimet e ministrit se policët nuk kishin qenë në nivel të detyrës. Komisioni i Brendshëm Disiplinor i PK-së kishte konstatuar se nuk është argumentuar me asnjë fakt se dy zyrtarët policor kishin “treguar sjellje të pahijshme” lidhur me këtë rast.⁸⁰ Pas përfundimit të hetimeve penale nga IPK-ja dhe hetimeve disiplinore nga PK-ja, ishte marrë vendim për rikthimin në punë të policëve.⁸¹ Edhe pas rikthimit në punë të policëve dhe publikimit në media të këtij rasti, ministri kishte ushtruar, në një formë a tjetër, presion mbi policët. Ai kishte telefonuar njërin prej tyre duke shprehur pakënaqësi pse zyrtarët policor kishin vendosur të bënin të njohur për publikun “incidentin” me të.⁸²

Ky rast tregon se zyrtarët policor nuk e gëzojnë autonominë për të kryer punën e tyre dhe, për më tepër, vet politika kishte ndërhyrë në pavarësinë e Policisë.⁸³ Ndërkohë, ka edhe sugjerime që veçanërisht për policët e trafikut gjatë detyrës zyrtare të mbajnë me vete kamera vëzhgimi dhe në këtë mënyrë puna e policëve do të mbikëqyrej vazhdimisht qoftë nga eprorët e tyre në PK ose nga IPK-ja.⁸⁴ Në njërin anë kjo do të ndikonte në rritjen më të madhe të përgjegjësisë së zyrtarëve policor dhe në anën tjetër do t’ju bënte me dije shkelësve të ligjit, qoftë ata edhe politikanë si rasti i mësipërm, për të mos ndërhyrë në punën e policëve.

76 Fjala është për ministrin pa portofol të Qeverisë së Kosovës, Rasim Demiri. Ngjarja kishte ndodhur në Prizren në korrik të vitit 2015 kur zyrtarët policor gjatë detyrës së tyre zyrtare gjobitën shoferin e ministrit.

77 Nikolla, A. (12 shkurt 2016). Dënuan ministrin, u suspenduan policët (VIDEO). *Zëri*. Qasur më 7 maj 2016, në: <<http://goo.gl/xkl2he>>

78 Po aty.

79 KIPRED. (Mars 2016). *Observeri i Sektorit të Sigurisë së Kosovës – Vëllimi I, Nr. 3*. Prishtinë: KIPRED, f. 9. Qasur më 3 maj 2016, në: <<http://goo.gl/CbsGAX>>

80 Nikolla, A. (12 shkurt 2016). Dënuan ministrin, u suspenduan policët (VIDEO). *Zëri*. Qasur më 7 maj 2016, në: <<http://goo.gl/xkl2he>>

81 Po aty.

82 Nikolla, A. (7 prill 2016). Ministri pa portofol nuk ndalet, telefonon policët që i shqiptuan gjobë. *Zëri*, f. 5.

83 Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë kundër Korrupsionit, 15 shkurt 2016.

84 Intervistë, Petrit Zogaj, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes FOL, 18 shkurt 2016.

Ndonëse zyrtarët policor iu kthyen punës për shkak se u vërtetua se nuk kishin bërë kurrfarë shkeljesh, mbetet shqetësues fakti se si politikanë për shkak të fuqisë politike që kanë e shfrytëzojnë ose mbase edhe e keqpërdorin atë për të ndikuar në punët e brendshme të PK-së. Kjo dëshmon se elemente të caktuara në Polici dorëzohen para presioneve politike apo edhe vullnetarisht iu shërbejnë interesave të ngushta politike jashtë mandatit të tyre. Në të vërtetë, PK-ja duhet të veprojë njëjtë me të gjitha ata që shkelin ligjin, ndërsa zyrtarët policor nuk duhet të ndihen të frikësuar kur ndëshkojnë politikanë të cilët shkelin ligjin dhe rregullat në komunikacion ose në situata të tjera.

4.2. Operacioni policor i 28 nëntorit 2015

Më 28 nëntor 2015 partitë opozitare të Kosovës⁸⁵ organizuan një protestë në Prishtinë me qëllim të kundërshtimit të dy marrëveshjeve të cilat i kishte negociuar Qeveria e Kosovës me Serbinë dhe me Malin e Zi.⁸⁶ Bëhet fjalë për kundërshtimin që i bëri opozita Marrëveshjes për Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë dhe asaj për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Sidoqoftë, situata u përshkallëzua pas paraqitjes në publik të deputetit të opozitës, Albin Kurti,⁸⁷ i cili kishte kohë që kërkohej nga Policia për shkak se gjykata kishte lëshuar një urdhërarrest ndaj tij.⁸⁸ PK-ja e arrestoi atë në zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje pas përfundimit të protestës.

Mënyra se si Policia udhëhoqi operacionin pas protestës nuk është konsideruar si profesionale në vlerësimin real të situatës. Si rrjedhojë e kësaj, kishte pasur tejkalim të autorizimeve të Policisë duke përdorur forcë të tepruar, derisa për realizimin e aksionit policor ishte angazhuar njësia më elite e Policisë - Njësia Speciale Intervenuese (FIT), pjesëtarët e së cilës kishin intervenuar brenda këtij subjekti politik. Në këtë mënyrë, demonstrimi i forcës nga PK-ja kishte ndodhur duke vënë në funksion njësinë FIT para se të shqyrtohej mundësia që për këtë aksion policor të angazhoheshin njësi të tjera të Policisë. Gjatë këtij operacioni ishin arrestuar dhjetëra aktivistë të Vetëvendosjes në ndërtesën e këtij subjekti, respektivisht 97 persona.⁸⁹ Duket se kjo ka qenë hera e parë kur forcat e rendit janë futur dhe kanë intervenuar në zyrat e një subjekti politik opozitar në Kosovë, që prej përfundimit të luftës më 1999.

Mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë kanë ngritur dyshimet se me këtë rast kishte pas përdorim të tepruar të forcës, të dhunës fizike, si dhe tejkalim të autorizimeve nga

85 Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma për Kosovën.

86 Për më shumë shih këtë material: <<https://goo.gl/gr1P0r>>. Qasur më 8 maj 2016.

87 Po aty.

88 Shih njoftimin e Prokurorit të Shtetit për hetimet e Departamentit për Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës ndaj deputetit Kurti: <<http://goo.gl/BhygUi>>. Qasur më 8 maj 2016.

89 Shih komunikatën për media të PK-së për ngjarjet e 28 nëntorit 2015, në: <<http://goo.gl/tZKUxu>>. Qasur më 8 maj 2016.

ana e Policisë. Në këtë drejtim, IAP-ja pas mbikëqyrjes së këtij aksioni policor ka dal me konstatimin se ekzistojnë pretendime serioze për shkeljen e të drejtave të njeriut. Ky institucion i është drejtuar me një kërkesë zyrtare Prokurorit të Shtetit për të nisur hetime objektive për ndërhyrjen e PK-së në selinë e Lëvizjes Vetëvendosje. Për më tepër, sipas IAP-së ekziston bazë e mjaftueshme për organin e akuzës që të kryejë hetime penale nëse janë shkelur Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale me rastin e operacionit të PK-së më 28 nëntor 2015.⁹⁰ Megjithatë, ky rast është në prokurori dhe nuk dihet ende për rezultatet e kërkesës së Avokatit të Popullit.

Më kritike ka qenë organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Amnesty International (AI). Kjo e fundit ka shprehur shqetësimin se nga ana e pjesëtarëve të Njësisë Speciale të PK-së ka pasur përdorim të tepruar të forcës gjatë aksionit policor. AI-ja i ka dërguar një letër⁹¹ ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës në të cilën thuhet se është e pakuptueshme pse PK-ja kishte zgjedhur pikërisht tani kohën dhe vendin për të kryer këtë arrestim kur ka pas mundësi ta realizojë atë në raste të tjera.⁹² Madje, aty përmendet se është "plotësisht e pavend dhe e tepërt" që një forcë kaq e madhe policore, e pajisur me armë automatike, të angazhohej për arrestimin e një personi të vetëm.⁹³ Për më tepër, kjo organizatë alarmon se ky operacion me kaq shumë zyrtarë policor të armatosur rëndë jepte përshtypjen e një aksioni ndëshkues kundër partisë politike, në vend se të ishte një operacion i thjeshtë arresti.⁹⁴

Në vlerësimin e vet për veprimet e PK-së, Amnesty International ka konstatuar se përdorimi i forcës atë ditë nga Policia nuk ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, standardet për zbatimin e ligjit dhe për të drejtat e njeriut. Si pasojë e kësaj, ajo ka konsideruar se ekzistojnë prova mjaft të besueshme për hapjen e hetimeve penale ndaj atyre që dyshohen se kanë pas përgjegjësinë për përdorimin e dhunshëm të forcës, duke përfshirë edhe komandantët policor.⁹⁵ Ndërsa, i ka sugjeruar MPB-së dhe PK-së të rishikojnë procedurat operacionale, si dhe praktikat e përdorimit të forcës e të armëve të zjarrit nga forcat e rendit për të garantuar që ato të jenë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, standardet për të drejtat e njeriut dhe të zbatimit të ligjit.⁹⁶

Këtë aksion policor do të duhej ta hetonte IPK-ja për të vlerësuar nëse kishte pas përdorim të tepruar të forcës dhe tejkallim të autorizimeve nga PK-ja. QKSS-ja ka kërkuar intervistë me zyrtarë të lartë të IPK-së, por kjo e fundit nuk është përgjigjur pozitiv-

90 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

91 Amnesty International, "Excessive and abusive use of force by police" [Përdorim i tepruar dhe i dhunshëm i forcës nga Policia]. Ref: TG EUR 70/2016.004. Letra dërguar ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, mban datën 29 shkurt 2016.

92 Po aty, fq. 1.

93 Po aty, fq. 2.

94 Po aty.

95 Po aty, fq. 3.

96 Po aty, fq. 4.

isht. Sidoqoftë, as në raportin vjetor të IPK-së për vitin 2015 dhe as në faqen e saj të internetit nuk përmendet nëse ky institucion ka zhvilluar hetime ose inspektime ndaj Policisë për ngjarjet e 28 nëntorit 2015.

Ndërkohë, MPB-ja i ka hedhur poshtë të gjitha dyshimet dhe pretendimet se PK-ja nuk kishte qenë në nivel të detyrës me rastin e aksionit policor të përmendur më sipër. Krerë të kësaj ministrie kanë shprehur bindjen se intervenimi i PK-së në Vetëvendosje është udhëhequr nga Policia dhe se MPB-ja nuk ka qenë në dijeni duke kundërshtuar kështu kritikën se aksioni policor kishte elemente politike. Sipas MPB-së, të gjitha vendimet janë marrë nga PK-ja duke nisur prej drejtorit të përgjithshëm deri te drejtorët dhe komandantët e operativës në Polici.⁹⁷

Kurse, PK-ja është deklaruar se vetëm ka kryer obligimet ligjore që i takojnë për zbatimin e urdhërarresteve të lëshuara nga organet e drejtësisë. Qëndrim i Policisë ka qenë se “në asnjë mënyrë nuk lejon përdorimin e tepruar të forcës” nga pjesëtarët e saj dhe se këta të fundit janë të trajnuar për përdorimin e forcës minimale të nevojshme për të tejkaluar rezistencën. Ndërsa, për këtë aksion policor, PK-ja ishte shprehur se bazuar në situatën dhe rrethanat me zhvillim të shpejtë, ishin të detyruar të përdorin forcë proporcionale dhe të nevojshme si reagim ndaj dhunës së drejtuar ndaj policëve.⁹⁸ Sidoqoftë, dy mekanizma të brendshëm të PK-së (Komisioni për shqyrtimin e përdorimit të forcës dhe DSP-ja) kanë shqyrtuar veprimet e policëve që kanë marrë pjesë në operacionin e 28 nëntorit 2015.⁹⁹ Por, nuk dihet për të gjeturat e këtyre dy mekanizmave nëse kishte pasur përdorim të tepruar të forcës nga zyrtarët policor apo jo. PK-ja nuk i ka bërë të njohura për publikun rezultatet e këtij vlerësimi të brendshëm.

Megjithatë, mbetet shqetësues fakti se PK-ja ende nuk ka dhënë sqarime shtesë për përfshirjen e një numri të madh të zyrtarëve policor në këtë aksion. Për më tepër, angazhimi i Njësisë Speciale Intervenuese, e njohur ndryshe si FIT, që zakonisht merret me situata të rrezikut ekstrem e bën mbase edhe më të ndërlikuar vet aksionin e Policisë. Rrjedhimisht, PK-së i ishte sugjeruar që në vend të njësisë me elite të PK-së, të angazhohet njësi të tjera policore për realizimin e këtij operacioni policor pa qenë nevoja që të intervenohet me armë të gjata dhe me njësinë më të specializuar të Policisë.¹⁰⁰ Edhe zyrtarë të lartë të PK-së kanë shprehur pakënaqësi për rrjedhën e këtij operacioni të PK-së me arsyen se nuk ishin vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat dhe situata lidhur me këtë çështje nga niveli i lartë operativ i PK-së.¹⁰¹

97 Deklaratë e ministrit të Punëve Brendshme, Skënder Hyseni, në emisionin Rubikon të KTV-së, 22 mars 2016, në: <<https://goo.gl/u3zgRz>>. Qasur më 9 maj 2016.

98 Për më shumë, shih: <<http://goo.gl/tZKUxu>>. Qasur më 8 maj 2016.

99 Po aty.

100 Intervistë, Kreshnik Gashi, Redaktor në BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese), 3 prill 2016.

101 Intervistë me një zyrtar të lartë të PK-së, 18 dhjetor 2015.

Nga ana tjetër, vlerësimet që kishte bërë Policia për njëjën ndër protestat më masive në Prishtinë që ishte mbajtur më 9 janar 2016 kishte ngritur dyshimet për ndikimin politik mbi punën e PK-së. Nga radhët e Policisë kishte dal konstatimi se numri i protestuesve në protestë kishte qenë 8,000 pjesëmarrës.¹⁰² Ndërkohë, kjo duket të kishte qenë larg vlerësimi real të numrit të protestuesve marrë parasysh faktin që kjo protestë kishte qenë masive, përkatësisht vlerësohet të kenë qenë rreth 20,000 pjesëmarrës në protestë.¹⁰³ Ky deklaram mund të ketë reflektuar një vlerësim të qëllimshëm të Policisë, i cili ose është bërë për shkak të direktivave politike ose ka pasur për qëllim të zvogëlojë në mënyrë deklarative potencialin protestues.

Kjo, në njëjën anë, nënkupton se Policia duhet të fuqizojë kapacitetet e veta sa i përket vlerësimi dhe menaxhimit të situatave kur ka të bëjë me protestat. Ndërsa, në anën tjetër, duhet të qëndroj larg çfarëdo ndikimi politik të mundshëm në punën e saj, qoftë kjo edhe kur bën vlerësimin e numrit të protestuesve kur ato organizohen nga subjektet opozitare apo kushdo qoftë.

5. TRANSPARENCA

5.1. Korniza ligjore

Transparenca e Policisë së Kosovës (PK) është një prej parimeve udhëzuese të këtij institucioni, e që parashihet edhe me Ligjin për Policinë në atë mënyrë që publikut t'i ofrohen informata dhe të sigurohet që institucioni i Policisë të jetë sa më i hapur për publikun.¹⁰⁴ Një përkufizim i tillë ligjor është mjaft përgjithësues. Megjithatë, kjo është përforcuar më tej përmes dokumenteve strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Në këto dokumente theksohet se çështjet operative dhe aktivitetet e Policisë që janë me interes publik mbulohen nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) e PK-së, e cila synon t'i ofrojë publikut informata të plota dhe me kohë përmes mediave.¹⁰⁵ Sipas dokumenteve që përcaktojnë marrëdhënien e Policisë me publikun, mediat kanë qasje

102 Deklaratë e zëdhënësit të PK-së, Baki Kelani, në konferencën për media të PK-së, 9 janar 2016, në: <<https://goo.gl/B51VXA>>. Qasur më 9 maj 2016.

103 Klan Kosova, "Loja me numrin e protestuesve vazhdon", 10 janar 2016, në: <<https://goo.gl/f2Hcfs>>. Qasur më 9 maj 2016.

104 Neni 2, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

105 Ministria e Punëve të Brendshme. (2014). *Strategjia e Komunikimit dhe Plani i Veprimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme 2014-2016*. Prishtinë: Ministria e Punëve të Brendshme, fq. 4-10. Qasur më 13 prill 2016, në: <<http://goo.gl/AKi6fi>>

në informatat e Policisë sipas kërkesës ose në mënyrë pro-aktive,¹⁰⁶ që nënkupton përmes informacioneve, komunikatave për shtyp, fushatave të ndryshme, komunikimit përmes internetit dhe rrjeteve sociale, si dhe konferencave për shtyp.

Sidoqoftë, ekzistojnë kufizime kur është fjala për informatat policore që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, rendin publik dhe reputacionin e të tjerëve,¹⁰⁷ të cilat nuk mund të jenë të qasshme për publikun. Ndërsa, me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, klasifikimi i informacioneve bëhet vetëm në rast se kjo është e nevojshme. Në këtë rrafsh, informacionet që kanë të bëjnë me sigurinë publike klasifikohen nga Autoriteti i Klasifikimit, përkatësisht PK-ja.¹⁰⁸ Edhe pse ky ligj i jep autonomi Autoritetit Klasifikues, prapëseprapë është vështirë të dihet se në çfarë mase praktikohen kriteret e klasifikimit dhe nëse kjo keqpërdoret nga ky autoritet.

Legjislacioni në fuqi obligon institucionet publike të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe PK-në, që të garantojnë për palët e ndryshme qasje në dokumente publike për të cilat kërkohet qasja. Kur dhënia e dokumenteve për publikun cenon sigurinë kombëtare, mbrojtjen, marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë publike në vend etj,¹⁰⁹ atëherë ato nuk mund të jenë të qasshme për publikun.

5.2. Praktika

Komunikimi i PK-së me publikun bëhet përmes Zyrës për Informim të Policisë (ZIMP) të Policisë në nivel qendror dhe rajonal të policisë. ZIMP është e organizuar në nivel qendror në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe në Drejtoritë Rajonale të Policisë (DRP) në Prishtinë, Mitrovicë-Jugu, Mitrovicë-Veriu, Pejë, Gjiilan, Prizren, Ferizaj dhe Gjakovë. Roli parësor i ZIMP është të organizojë, menaxhojë dhe koordinojë të gjitha aktivitetet lidhur me bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe mediave.¹¹⁰

PK-ja konsiderohet ndër institucionet që gëzon shkallë deri diku të mirë të transparencës dhe komunikimit në raport me institucionet publike, opinionin publik, mediat, organizatat joqeveritare dhe palët e tjera që kërkojnë informacione nga PK-ja. Megjithatë, duket se ekziston një tendencë brenda për brenda institucionit për të bërë sa më të burokratizuar qasjen e publikut në informacionet e PK-së dhe njëlloj *centralizimin* nga ana e ZIMP të Policisë¹¹¹, sa i përket ofrimit të informatave tek ata që bëjnë kërkesë për

106 Po aty, fq. 10-11.

107 Po aty, fq. 11.

108 Neni 4 dhe Neni 7, Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.

109 Neni 12, Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

110 Kontributet e mbledhura nga grupi i fokusit i organizuar nga QKSS-ja me zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës më 7 tetor 2015.

111 Intervistë, Rifat Marmullaku, Ish-zyrtar i lartë i Policisë së Kosovës, 3 korrik 2015.

informacione. Në të vërtetë, PK-ja është kritikuar shpesh se ofron informata shumë të përgjithësuara, nuk ofron statistika të hollësishme dhe se nuk u përgjigjet me kohë kërkesave zyrtare që bëhen për qasje në informacione ose dokumente publike, me theks të veçantë në kontratat e prokurimit publik.¹¹² Këto mangësi në fushën e transparencës pamundësojnë që informatat ose përgjigjet që merren nga Policia të ndikojnë në nxjerrjen e një vlerësimi real të situatës për çështjet që ndërlidhen me këtë institucion. Nga ana tjetër, nuk ka prezencë të duhur të menaxhmentit të lartë të PK-së në media. Rrjedhimisht një prezencë më e madhe në media e menaxhmentit të PK-së do të ishte në interes të fuqizimit të qeverisjes së mirë të PK-së. Për më tepër, vlerësohet që PK-ja duhet të krijojë mundësinë për zyrtarë policor të niveleve të ndryshme të shprehin mendimin e tyre për çështje të caktuara të PK-së në publik apo media brenda kufizimeve ligjore dhe rregullave të brendshme të Policisë.¹¹³

Ky institucion çdo vit publikon raportin vjetor ku janë të përmbledhura punët, veprimet dhe aktivitetet e PK-së gjatë 12 muajve të vitit përkatës. Në raportin vjetor të punës për vitin 2015, i cili përmban jo më shumë se 28 faqe, ofrohen të dhëna dhe informata mjaft të përgjithësuara. Megjithatë, nëse krahasohet me raportet vjetore të viteve paraprake, vërehet një përmirësim sa i përket statistikave për vitin 2015. Aty ofrohen të dhëna statistikore më të hollësishme lidhur me burimet njerëzore, sigurinë publike, operacionet policore në luftimin e krimit të organizuar dhe ekstremizmit të dhunshëm, hetimet policore për vepra të ndryshme penale, si dhe numerikisht përmenden rastet kur PK-ja ka bërë hetime të brendshme për shkeljet e zyrtarëve policor gjatë detyrës zyrtare. Pavarësisht kësaj, raporti vjetor për vitin 2015 përmban të dhëna shumë sipërfaqësore për mekanizmat e kontrollit të brendshëm të PK-së dhe për rolin e Policisë gjatë protestave të vitit 2015, ku PK-ja ishte sfiduar seriozisht në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Njëri nga elementet e transparencës është faqja e internetit e PK-së në të cilën publikohen aktivitetet e policisë, ndonëse në mënyrë të përgjithësuar.¹¹⁴ Aty janë të vendosura shpalljet për mundësitë e punësimit në Polici me dokumentacionet përkatëse për aplikim për një vend të punës. Në këtë drejtim janë të publikuara udhëzuesi për kandidatët, aplikacioni i punësimit për personelin policor në PK, lista e kandidatëve që kalojnë dhe nuk kalojnë testin me shkrim, intervistën, si dhe lista e kandidatëve që pranohen dhe atyre që nuk pranohen për pozita të punës në nivele të ndryshme në Polici. Ngjashëm si me shpalljet për vendet e lira të punës, në faqen e internetit të PK-së publikohen shpalljet edhe për procesin e gradimit në PK-së lidhur me gradat e ndryshme për të cilat aplikojnë zyrtarët policor. Aty mund të shihet lista e kandidatëve të cilët janë promovuar në grada të ndryshme policore dhe rezultatet nga procesi i përzgjedhjes që e bën vet PK-ja gjatë procesit të gradimit.¹¹⁵

112 Intervistë, Kreshnik Gashi, Redaktor në BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese), 3 prill 2016.

113 Po aty.

114 Shih faqen e internetit të PK-së: <www.kosovopolic.com>. Qasur më 14 prill 2016.

115 Për më shumë, shih: <<http://goo.gl/U8iwcG>>. Qasur më 15 prill 2016.

Policia në baza ditore publikon në internet të gjitha komunikatat për media për të informuar publikun lidhur me aktivitetet policore dhe të njëjtat ua shpërndan të gjitha mediave në Kosovë në mënyrë elektronike. Gjatë vitit 2015, PK-ja ka lëshuar gjithsej 640 komunikata (mesatarisht afro 2 komunikata në ditë), gjegjësisht 126 prej tyre janë publikuar nga niveli qendror i Policisë, ndërsa drejtoritë rajonale të Policisë kanë lëshuar gjithsej 514 komunikata për shtyp. Megjithatë, PK-ja nuk ka ofruar të dhëna e shpjegime se sa ka qenë numri i komunikatave për shtyp që janë lëshuar sipas secilës prej tetë DRP-ve veç e veç dhe se cila drejtori rajonale ka qenë më pak a më shumë e ngarkuar në informimin e publikut lidhur me punën e tyre.

Tabela 8 – Numri i komunikatave për media të PK-së gjatë vitit 2015¹¹⁶

Komunikatat e publikuara nga niveli qendror i PK-së	126
Komunikatat e publikuara nga drejtoritë rajonale të PK-së	514
Gjithsej	640

Përveç kësaj, Policia publikon statistika të përgjithshme 24-orëshe në faqen e internetit për çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me sigurinë publike, si: aksidentet fatale, aksidentet me të lënduar, aksidentet pa të lënduar, tiketat e trafikut të shqiptuara, personat e arrestuar dhe personat në mbajtje. Këto statistika botohen dhe rifreskohen çdo ditë nga ana e PK-së, që i bie se gjatë një viti kalendarik publikohen 365 raporte 24-orëshe. Sipas të dhënave të Policisë, kjo e fundit në vitin 2015 ka realizuar 3,500 kërkesa të ndryshme për informata nga mediat, organizatat joqeveritare dhe personat fizik.¹¹⁷ Përkundër kësaj, nuk dihet se sa kërkesa janë bërë në Polici gjatë kësaj periudhe (janar 2015-prill 2016) për qasje në dokumente publike, përkatësisht sa prej tyre janë realizuar ose refuzuar nga PK-ja varësisht prej kërkesave të palëve të ndryshme për të pasur qasje në dokumente të tilla.

Sa i përket aktiviteteve në fushën e prokurimit publik, Policia nuk i publikon në faqen e vet të internetit vlerësimin dhe aplikimet e operatorëve ekonomik. Nuk publikohen as vendimet e PK-së sa i përket procedurave të prokurimit publik. Megjithatë, për çështjet që ndërlidhen me procedurat e prokurimit publik të Policisë si autoritet kontraktues publikohen nga ana e institucioneve përkatëse të prokurimit publik në vend. Pos kësaj, as aktivitetet e Zyrës së Auditimit të Brendshëm, Drejtorisë së Standardeve Profesionale dhe Njësisë së Inspektimit të PK-së nuk bëhen publike nga Policia në faqen e internetit. Ndërsa, në raportin vjetor të punës së PK-së për vitin 2015 ato përmenden në mënyrë shumë të përgjithshme.¹¹⁸

116 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. *Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015*, f. 18. Qasur më 14 prill 2016, në: <<http://goo.gl/H2HvXk>>

117 Po aty.

118 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. *Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015*, f. 17. Qasur më 14 prill 2016, në: <<http://goo.gl/H2HvXk>>

6. PROKURIMI PUBLIK

Sektori i prokurimit publik në Kosovë është i rregulluar përmes Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme. Ky ligj ishte kritikuar vazhdimisht se nuk ishte në përputhje me rrethanat dhe se ishte bërë pengesë për funksionimin e mirë të aktiviteteve të prokurimit publik. Sikur institucionet tjera publike edhe Policia i nënshtrohet këtij ligji kur bëhet fjalë për prokurimin publik.

Me ndryshimet e reja të Ligjit për Prokurimin Publik në vitin 2016, për herë të parë rregullohet se kur zbatohen rregullat e këtij ligji për kontratat në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Duke e marrë parasysh ndjeshmërinë e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë ka raste kur për disa lloje të kontratave aplikohen procedura të vecantë të prokurimit publik, gjegjësisht me atë rast nuk zbatohen rregullat e Ligjit për Prokurim Publik. Në këtë mënyrë, ligji nuk aplikohet për furnizimin me pajisje të ndryshme, si dhe për prokurimet në punët dhe shërbimet e ndjeshme. Ligji nuk aplikohet as për furnizim të pajisjeve ushtarake.¹¹⁹ Për këto aktivitete duhet të miratohet një Rregullore nga Qeveria e Kosovës mbi prokurimin për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë. Ndërsa, rastet kur nuk zbatohet Ligji i ndryshuar, por as Rregullorja është kur bëhet fjalë për ato kontrata ku zbulimi i informacionit mund të cenojë interesat thelbësore të sigurisë së vendit¹²⁰ dhe për raste të tjera. Në këto situata ndiqen rregulla të veçanta të prokurimit publik. Këto ndryshime në Ligjin për Prokurimin Publik janë bërë si pasojë e kërkesave të Bashkimit Evropian për harmonizimin e ligjit me legjislacionin e BE-së, gjegjësisht Direktivën nr. 2009/81/EC¹²¹ për kontratat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Sistemi i prokurimit publik në PK është i ndarë nga ai i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shërben si departament i pavarur në kuadër të PK-së. Departamenti i Prokurimit Publik të PK-së i raporton drejtpërdrejt drejtorit të përgjithshëm të PK-së lidhur me çështje dhe procedura të ndryshme të prokurimit publik. Sistemi i prokurimit publik mbetet një prej sfidave më të mëdha në PK kur është fjala për keqpërdorimin e fondeve publike dhe përfshirjen e zyrtarëve publikë në rastet e korrupsionit.¹²²

Sa i përket dyshimeve dhe hetimeve për korrupsion në fushën e prokurimit publik në PK, në vitin 2015 Gjykata Themelore në Prishtinë ka hedhur poshtë aktakuzën ndaj disa zyrtarëve të PK-së, ne mesin e të cilëve ka qenë ish-shefja e prokurimit në PK. Të akuzuarit për skandalin e tenderit për armë janë lënë të lirë nga akuzat. Aktakuza ishte

119 Neni 3, Ligji Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237.

120 Po aty.

121 Shih: <<https://goo.gl/UsM0V1>>. Qasur më 13 maj 2016.

122 Perteshi, Skender. (2014). *Llogaridhënie apo jo? Menaxhimi i parasë publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Qasur më 13 maj 2016, në: <<http://goo.gl/zxJJCq>>

hedhur poshtë nën arsyetimin se prokuroria nuk i ishte përmbajtur afateve ligjore të hetimit. Për këtë rast, në vitin 2011, Policia e EULEX-it kishte kryer bastisje në MPB dhe në PK me pretendimin se gjatë tenderit për importin e armëve dhe municioneve për PK-në kishte pasur keqpërdorime. Sipas EULEX-it, dëmet që i ishin shkaktuar buxhetit të Kosovës nga ky rast ishin të mëdha.¹²³ Mirëpo, në vitin 2016 akuzat ndaj zyrtarëve të Policisë rreth tenderit me armë ishin ri-aktualizuar meqë EULEX-i kishte ngritur aktakuzë pas një vendimi të Gjykatës Supreme në dhjetor, e që kishte vlerësuar ligjshmërinë e Gjykatës Themelore në Prishtinë për hedhjen e aktakuzës. Gjykim për këtë rast u paralajmërua se do të fillojë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, por akoma nuk është caktuar data e gjykimit.¹²⁴ Që nga vitit 2015 tre tenderë të Policisë janë duke u hetuar nga IPK-ja: furnizimi me uniformë të për PK-në, ndërtimi i objektit K9 dhe lënda e tenderit për rregullimin e poligonit për gjuajtje me armë zjarri. Nuk ka informacione nga IPK-ja për zhvillimin e këtyre hetimeve dhe nëse është gjetur ndonjë parregullsi gjatë aktiviteteve të prokurimit publik në lëndët e këtyre tenderëve.

QKSS-ja ka kërkuar nga PK-ja të dhëna se sa ka qenë shuma e shpenzuar e buxhetit të PK-së për vitin 2015 në prokurim publik, cilat janë kapacitetet profesionale të prokurimit në Polici, si bëhet menaxhimi i kontratave të PK-së nga autoritetet kontraktuese, a ka pasur ndonjë kontratë sekrete në PK gjatë vitit 2015 deri më tash (prill 2016), etj. Sidoqoftë, Policia nuk ka ofruar të dhëna për aktivitetet që ka zhvilluar në fushën e prokurimit publik.

7. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE DHE DEMOKRATIKE E POLICISË

7.1. Mbikëqyrja parlamentare

Mbikëqyrja e politikave të sektorit të sigurisë në Kosovë, përfshirë Policinë, nga ana e Kuvendit të Kosovës parashihet me Kushtetutën e Kosovës.¹²⁵ Akti më i lartë juridik e politik i vendit parasheh që *“Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyrë buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë”*¹²⁶

123 Kreshnik Gashi. (4 qershor 2015). Të Pafajshëm të Akuzuarit për Aferën e Armëve të Policisë. *Kallxo.com*. Qasur më 13 maj 2016, në: <<http://goo.gl/NwFGwg>>

124 Shih: <<http://goo.gl/1Uh9BR>>. Qasur më 24 maj 2016.

125 Neni 65, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIV).

126 Po aty, Neni 125.

Mbikëqyrja e Policisë nga Kuvendi bëhet përmes disa mekanizmave parlamentar. Në rend të parë është interpelanca kur një grup i deputetëve mund të parashtojë kërkesë për shqyrtimin e një çështje që ndërlidhet me Policinë në seancë të Kuvendit.¹²⁷ Interpelanca, në këtë rast, i kërkohet ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me një çështje të caktuar në Polici, meqë PK-ja funksionon nën autoritetin e kreut të MPB-së. Ndërsa, edhe pyetjet parlamentare të deputetëve për përgjigje me gojë dhe përgjigje me shkrim janë një formë tjetër e mbikëqyrjes së PK-së nga ana e Kuvendit.

Kontrolli parlamentar i PK-së ushtrohet në mënyrë të veçantë nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (KPBSMFSK). Sa i përket Policisë, KPBSMFSK-ja mbikëqyrë shpenzimet dhe menaxhimin financiar të PK-së, kurse në bashkëpunim me IPK-në mbikëqyrë çështjet që kanë të bëjnë me masat disiplinore ndaj pjesëtarëve të Policisë.¹²⁸ Ky komision parlamentar mbikëqyr edhe zbatimin e ligjeve të fushëveprimit të tij, me theks të veçantë të Ligjit për Policinë dhe legjislacionin përcjellës që ndërlidhet me punën e PK-së. Në fushën e legjislacionit, komisioni është i detyruar të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe në këtë rast MPB-ja, PK-ja e IPK-ja duhet të raportojnë në komision së paku një herë në vit sa i përket të zbatimit të ligjeve përkatëse.¹²⁹ Pos këtyre çështjeve, KPBSMFSK-ja duhet të bashkëpunojë me MPB-në nga e cila mund të kërkojë të dhëna konkrete, në të cilën përfshihen raportet e drejtpërdrejta të ministrit të Punëve të Brendshme, si dhe të krerëve të Policisë e të IPK-së, kur kjo kërkohet nga Komisioni.¹³⁰

Gjatë vitit 2015, prej 25 mbledhjeve të rregullta të këtij Komisioni, dy herë ka raportuar ministri i unëve të brendshme, tri herë drejtori i përgjithshëm i PK-së, ndërsa ish-kryeshafi ekzekutiv i IPK-së ka raportuar vetëm një herë në vitin 2015.¹³¹ Prej tri raporteve që KPBSMFSK-ja ka shqyrtuar gjatë vitit 2015, në asnjërin prej tyre nuk përfshihet PK-ja ose MPB-ja, por vetëm IPK-ja, ku ka shqyrtuar raportin e saj vjetor për vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe kohore (janar-dhjetor 2015), anëtarët e komisionit kanë arritur të mbanin tri dëgjime publike, dy prej të cilave kanë qenë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për PK-në dhe një me MPB-në.¹³²

KPBSMFSK po ashtu ka monitoruar Ligjin për PK-në gjatë vitit 2015 si dhe ka hartuar një raport me rekomandime për gjetjet e dala gjatë periudhës monitoruese të vitit 2015. Aty komisioni i rekomandon MPB-së, PK-së dhe IPK-së që në vazhdimësi të ngrihin kapacitetet dhe bashkëpunimin në kryerjen e autorizimeve ligjore.

127 Neni 44, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 29 prill 2010. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/rQnaaA>

128 Po aty, fq. 51.

129 Po aty, Neni 73.

130 Po aty, fq. 51.

131 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). *Raporti i punës për vitin 2015*, fq. 5.

132 Po aty.

Sa i përket qeverisjes së mirë dhe integritetit, zyrtarëve policor u sugjerohet që të zbatojnë detyrat dhe autorizimet policore në mënyrë të ligjshme, sipas Kushtetutës, ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, standardeve operative, Kodit të Etikës së PK-së dhe standardeve ndërkombëtare për zbatimin e ligjit. Për më tepër, pjesëtarët e PK-së duhet të përfshihen në programe të certifikuara trajnimi dhe edukimi për të njohur më mirë kryerjen e autorizimeve policore, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut sipas parimit të legjitimitetit, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit.¹³³ Komisioni parlamentar ka rekomanduar që të zbatohet testi i integritetit për zyrtarët policor sipas modelit të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian. Ndërkohë, ligjvënësit i kanë bërë thirrje PK-së që në mënyrë të vazhdueshme të përfshijnë pjesëtarët e gjinisë femërore të PK-së në të gjitha strukturat e Policisë.¹³⁴

Gjithashtu, në këtë raport nga Komisioni kërkohet që Policia të avancojë tutje punën e saj në funksionalizimin dhe standardizimin e formave në sektorët si: policimit të udhëhequr nga inteligjenca, policimit në bashkësi, patrullimit, si dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike me standardet e përvetësuar të kontrollit të turmave dhe trazirave në rastet e prishjes së rendit dhe qetësisë publike.¹³⁵ Në fushën e sundimit të ligjit, komisioni ka sugjeruar fuqizimin e marrëdhënieve ndërmjet PK-së me prokurorinë dhe gjykatat e Kosovës. Ndërsa, është rekomanduar edhe themelimi i Policisë Gjyqësore për rritjen e efikasitetit në kryerjen e hetimit të veprave penale nga Policia me qëllim të sigurimit të pavarësisë në hetimet penale.¹³⁶

Pavarësisht këtyre aktiviteteve, puna dhe dinamika e komisionit parlamentar ka qenë peng i krizës politike në vend e cila filloje që nga mesi i 2014, 2015 dhe vazhdoi edhe në katër muajt e parë të vitit 2016. Si rrjedhojë, anëtarët e komisionit nga radhët e opozitës nuk kanë marrë pjesë në shumë prej mbledhjeve të komisionit, veçanërisht gjatë vitit 2015 dhe në pjesën e parë të vitit 2016. Deputetët e opozitës kanë bojkotuar punimet e komisionit dhe të Kuvendit në përgjithësi për shkak të kundërshtimit të Marrëveshjes për Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë dhe për demarkacionin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Sidoqoftë, kjo ka ndikuar edhe në numrin e takimeve të KPBSMFSK-së për mbikëqyrjen parlamentare të Policisë dhe ka shkaktuar probleme në vet efikasitetin e mbikëqyrjes civile të sektorit të sigurisë në përgjithësi nga Kuvendi.¹³⁷

133 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). *Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë*, fq. 1.

134 Po aty, fq. 2.

135 Po aty.

136 Për më tepër detaje lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë nga komisioni parlamentar, shih: Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). *Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë*.

137 Kosovar Centre for Security Studies. *Annual Report 2015 – Assembly of Kosovo (Period covered: January-December 2015)*, fq. 5.

Mbikëqyrja parlamentare, me theks të veçantë ajo e KPBSMFSK-së, ballafaqohet me mungesën e kapaciteteve profesionale për shkak të numrit të vogël të stafit administrativ.¹³⁸ Siç shihet nga aktivitetet e komisionit për vitin 2015, mbikëqyrja parlamentare e institucioneve të sigurisë është ende sipërfaqësore dhe funksionimi i tyre nuk mbikëqyret në mënyrë më të thukët nga Kuvendi.¹³⁹ Për këtë arsye, Kuvendi duhet të shfrytëzojë buxhetin e vet për të investuar në burimet profesionale të komisionit përmes angazhimit të ekspertëve që kanë njohuri në çështjet e sigurisë dhe punëve të brendshme. Edhe pse deri më tash KPBSMFSK kryesisht është mbështetur tek organizatat e ndryshme ndërkombëtare, tashmë është nevojë urgjente ngritja e kapaciteteve të brendshme profesionale në mënyrë që përmes analizave dhe ekspertizave të bëhet një mbikëqyrje e mirëfilltë parlamentare e sektorit të sigurisë.¹⁴⁰

7.2. Mbikëqyrja e Policisë nga institucionet tjera

7.2.1. Inspektorati Policor i Kosovës

Roli, veprimtaria dhe aktivitetet e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) në mbikëqyrjen e PK-së gjatë vitit 2015 janë trajtuar në seksionet e mëparshme në kuadër të këtij raporti (shih seksionin “Kontrolli i brendshëm” dhe seksionin “Pavarësia në vendimmarrje e Policisë”). Ky institucion, siç është analizuar në këtë raport, ka mandat për të bërë hetime penale, hetimeve disiplinore dhe hetimin e integritetit ndaj zyrtarëve policor, si dhe inspektimeve të rregullta e të jashtëzakonshme në PK.

Në vitin 2015 ka IPK-ja nisur projektin e regjionalizimit, përkatësisht janë hapur tri zyre rajonale të këtij institucioni në Gjilan, Prizren dhe Mitrovicën Veriore. Kjo shihet si mundësi e mirë për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit të IPK-së me qytetarë nga rajonet e ndryshme të Kosovës. Zyrat rajonale të IPK-së do të duhej të shërbejnë për parandalimin e shkeljeve penale e disiplinore të policëve, por edhe në ngritjen e integritetit të punonjësve të Policisë.¹⁴¹ Ndërsa, që nga maji i vitit 2016 IPK-ja udhëhiqet nga Kryeshefi i ri Ekzekutiv, Hilmi Mehmeti, i cili ishte shpallur si kandidati më i suksesshëm për këtë pozitë nga ana e MPB-së.¹⁴²

Në kuadër të mbikëqyrjes së punës së IPK-së, KPBSMFSK-ja mbikëqyr edhe zbatimin e Ligjit për IPK-në. Gjatë vitit 2013 komisioni parlamentar ka dal me një raport për

138 Po aty, fq. 11.

139 Kontribute të mbledhura nga konferenca e QKSS-së me temën: “Vlerësimi i integritetit në Policinë e Kosovës”, 26 nëntor 2015, Prishtinë.

140 Po aty.

141 Inspektorati Policor i Kosovës. *Raporti vjetor 2015*, f. 40. Qasur më 5 maj 2016, në: <<http://goo.gl/W0ODTr>>

142 Shih: <<http://goo.gl/nuxlHa>>. Qasur më 9 maj 2016.

mbikëqyrjen e të këtij Ligji ku kishte gjetur disa parregullsi në funksionimin e IPK-së. Aty përmendet se Ligji për IPK-në zbatohet vetëm pjesërisht. Për më tepër, theksohet se IPK-ja kishte shkelur ligjin gjatë rekrutimit të personelit pa shkollim adekuat.¹⁴³ Parregullsi ishin vërejtur edhe tek menaxhimi i buxhetit, kur IPK-ja kishte shpërblyer personelin e vet pa bazë ligjore me dy paga shtesë brenda vitit kalendarik.¹⁴⁴ Ndërsa, në raport me Policinë, KPBSMFSK-ja kishte kritikuar IPK-në sa i përket hetimeve penale ndaj zyrtarëve policor. Komisioni parlamentar ka kritikuar se kishte pasur paraqitje publike joprofesionale të personelit të IPK-së gjatë arrestimit të pjesëtarëve të Policisë të dyshuar për vepra penale ne disa raste. Megjithatë, KPBSMFSK-ja nuk ka bërë të ditur se në cilat raste IPK-ja ishte treguar joprofesionale sa i përket kësaj çështjeje.¹⁴⁵ Gjatë mbikëqyrjes së IPK-së, komisioni parlamentar kishte gjetur se ka pasur zbatim të standardeve të dyfishta nga IPK-ja kur ka dhënë rekomandime për suspendimin e zyrtarëve policor.¹⁴⁶ Komisioni parlamentar kishte dal me disa rekomandime për evitimin e këtyre parregullsive, por nuk dihet nëse këto të gjetura janë adresuar nga ana e IPK-së.¹⁴⁷

Nga ana tjetër, duke e ditur që buxheti i IPK-së ndahet nga MPB-ja dhe financiarisht varet nga Qeveria e Kosovës, ekzistojnë shqetësime lidhur me paanshmërinë e IPK-së në hetimin e shkeljeve ose keqpërdorimeve të mundshme që ndodhin në Polici. Funksionimi i IPK-së nën autoritetin e MPB-së, njëjtë siç funksionon edhe PK-ja, ka shkaktuar reagime se hetimet penale që bën IPK-ja ndaj zyrtarëve policor vështirë se mund të jenë të pavarura dhe objektive.¹⁴⁸ Madje, Avokat i Popullit ka kërkuar që IPK-së t'i hiqet kompetenca e hetimeve penale ndaj zyrtarëve policor me arsyen se kur bëhet fjalë për dyshime të veprave penale, qoftë edhe të pjesëtarëve të PK-së, kjo çështje duhet t'i kalohet me automatizëm organeve të drejtësisë.¹⁴⁹ Në vend të kësaj, IPK-ja do të duhej të konsolidonte dhe forconte mekanizmat e vet të brendshëm për të zhvilluar konceptin e etikës profesionale ndaj zyrtarëve policor në baza të rregullta.¹⁵⁰ Si institucion që detyrë parësore ka mbikëqyrjen e PK-së, funksioni kryesor i IPK-së duhet të

143 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së. (Qershor 2013). *Raport: Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-231 për IPK*, fq. 9.

144 Po aty.

145 Po aty.

146 Po aty.

147 Për më tepër detaje lidhur me rekomandimet e komisionit parlamentar për IPK-në drejtuar deputetëve të Kuvendit, shih: Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (19 qershor 2013). *Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës*.

148 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, fq. 17-18. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

149 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

150 Kontribute të mbledhura nga konferenca e QKSS-së me temën: "Vlerësimi i integritetit në Policinë e Kosovës", 26 nëntor 2015, Prishtinë.

fokusohet në realizimin e politikave afatmesme për fuqizimin e etikës dhe integritetit të personelit policor, sidomos në zhvillimin e masave kundër korrupsionit policor.

7.2.2. Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucion tjetër me rëndësi për mbikëqyrjen e PK-së është Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në fushën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjatë vitit 2015 është zgjeruar bashkëpunimi ndërmjet IAP-së dhe PK-së gjatë takimeve të përbashkëta që kanë pasur drejtuesit e këtyre dy institucioneve sa i përket të drejtave të njeriut. Policia ka nxjerrë një udhëzim që obligon personelin policor për të zhvilluar komunikim të rregullt me IAP-në për qasjen në të dhënat dhe informatat e PK-së me kohë.¹⁵¹

Sa i përket mbikëqyrjes së PK-së në rrafshin e të drejtave dhe lirive të njeriut, IAP-ja ndër çështjet më problematike e ka konsideruar mekanizmin e ankesës. Avokati i Popullit nuk ka pranuar ndonjë ankesë nga policët për shkeljen e të drejtave të njeriut, duke vlerësuar se kjo mund të jetë më shumë si pasojë e mundësisë për t'u diskriminuar personeli policor në vendin e punës. Sipas IAP-së, personeli policor, sikurse edhe punonjësit e sektorit publik, kanë frikë të ankohen për shkak se mund të jenë viktimë e hakmarrjes dhe subjekt i presioneve të ndryshme, qoftë edhe me largimin nga puna nga eprorët e tyre nëse ankohen për shkelje të të drejtave të njeriut.¹⁵²

IAP-ja mbikëqyrë punën e Policisë me rastin e tubimeve publike dhe protestave. Me përjashtim të protestës së 28 nëntorit 2015, ku IAP-ja ka konstatuar se ekzistojnë pretendime serioze për shkeljen e të drejtave të njeriut nga Policia,¹⁵³ në protestat e tjera vlerësohet se PK-ja ka qenë shumë më e kujdesshme dhe më e matur në këtë drejtim. Avokati i Popullit nuk ka ngritur dyshime ose pretendime se në protestat tjera kishte pasur tejkallim të autorizimeve ose sjellje jo korrekte të zyrtarëve policor ndaj protestuesve.¹⁵⁴

Ndërkohë, me ndryshimet e reja të legjisllacionit për Avokatin e Popullit, ky institucion vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.¹⁵⁵ IAP-ja ka të drejtë të bëjë inspektime të rregullta në të gjitha qendrat dhe vendet, ku njerëzit mbahen të privuar prej

151 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

152 Po aty.

153 Për vlerësimet e Avokatit të Popullit në lidhje me intervenimin e Policisë në protestën e 28 nëntorit 2015, shih seksionin e këtij raporti me titull: "Pavarësia dhe vendimmarrja në Polici".

154 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

155 Neni 17, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

lirisë. Avokati i Popullit synon të bëjë inspektime në stacionet policore për të evituar të gjitha shkeljet që mund të ndodhin sa i përket kësaj çështjeje.¹⁵⁶

7.2.3. Agjencia kundër Korrupsionit

Policia ka bashkëpunim me Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) në çështjet që kanë të bëjnë me deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, si dhe dhuratave të zyrtarë të lartë të PK-së. Zyrtarët e lartë të Policisë janë të obliguar të deklarojnë pasurinë e tyre në AKK që nga viti 2008. Kurse, gjatë vitit 2015 gjithsej 57 zyrtarë të PK-së kanë deklaruar pasurinë në AKK,¹⁵⁷ ku përfshihen drejtori i përgjithshëm i PK-së, dy zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive të Policisë dhe drejtorët e DRP-ve, si dhe zyrtarë të tjerë të PK-së.¹⁵⁸ Për këtë proces AKK-ja nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi ose vërejtje dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë kallëzim penal të kësaj agjencie për zyrtarë të Policisë.¹⁵⁹ Përkundër asaj se e deklarohen pasurinë është e vështirë t'ju besohet të dhënave që i deklarojnë me faktin se AKK-ja nuk ka mandat ligjor të kërkojë deklarin e prejardhjes së pasurisë nga zyrtarët e lartë publik, përfshirë zyrtarët e PK-së.¹⁶⁰

Ndërsa, sa i përket rasteve të mundshme të konfliktit të interesit, AKK-ja në raportin e vet vjetor për vitin 2015 nuk ka specifikuar nëse ka hasur në ndonjë rast të tillë në PK. Megjithatë, kjo çështje duket të shumë sfiduese për Policinë. Gjatë vlerësimi të rrezikut nga fenomeni i korrupsionit, PK-ja ka evidentuar si rrezik të intensitetit të lartë për zyrtarët e saj konfliktin e interesit. Si rrjedhojë e kësaj, AKK-ja i ka sugjeruar PK-së që për forcimin e integritetit të nxjerrë një rregullore të brendshme për parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit brenda për brenda Policisë.¹⁶¹

7.2.4. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Funksioni i mbikëqyrjes demokratike të institucioneve publike në fushën e kontrollit ekonomik dhe financiar ushtrohet përmes Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP). ZAP-i bënë auditimin vjetor të pasqyrave financiare të institucioneve publike. Sido-

156 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, f. 17. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

157 Përgjigjet me shkrim të PK-së të dërguara në formë elektronike në QKSS më 29 prill 2016.

158 Shih listën e Agjencisë kundër Korrupsionit të zyrtarë të lartë publik për vitin 2016. Qasur më 12 maj 2016, në: <<http://goo.gl/Aj4nzG>>

159 Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë kundër Korrupsionit, 15 shkurt 2016.

160 Po aty.

161 Po aty.

qoftë, ZAP-i nuk përgatit raport të veçantë auditimi për Policinë, por atë e përfshin në kuadër të raportit vjetor për menaxhimin financiar të MPB-së.

Në raportin për vitin 2014, ZAP-i ka vlerësuar se PK-ja ka forcuar dukshëm kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave dhe ka zbatuar ndëshkimet e parapara me kontratë për vonesat që janë shkaktuar nga operatorët ekonomikë.¹⁶² Ndërkohë, ZAP-i ka rekomanduar vazhdimisht forcimin e kontrolleve të flotës së PK-së, megjithatë menaxhimi i automjeteve në Polici nuk është në nivelin e kënaqshëm. Shumë automjete policore presin për servisim prej vitit 2009, derisa pjesa më e madhe e tyre nuk janë servisuar si pasojë e mungesës së pjesëve rezervë.¹⁶³ ZAP-i e ka vlerësuar si rrezik numrin e madh të automjeteve të Policisë që presin për servisim për arsye se jetëgjatësia e këtyre automjeteve është mjaft e kufizuar.¹⁶⁴ Për këtë rast, i është rekomanduar ministrit të Punëve të Brendshme të rishikojë arsyet e mos adresimit të këtij rekomandimi të ZAP-it nga Policia dhe të përcaktojë masa shtesë për forcimin e kontrolleve në këtë njësi. Ndërsa, vërejtje të tjera kanë të bëjnë me mirëmbajtjen jo të mirë të dosjeve të personelit në PK ku rekomandimet për këtë çështje janë adresuar vetëm pjesërisht nga ana e Policisë.¹⁶⁵

Ndërkohë, KPBSMFSK-ja ka sugjeruar PK-në të ndër marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it sa i përket pasqyrave financiare vjetore rreth shpenzimeve buxhetore dhe rekomandimet tjera.¹⁶⁶ Komisioni parlamentar ka vërejtur se Policia i zbaton vetëm pjesërisht rekomandimet e ZAP-it në lidhje me shpenzimet buxhetore.¹⁶⁷ Nga ana tjetër, Policia nuk ka ofruar të dhëna lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimet e ZAP-it.

162 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. (Qershor 2015). *Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014*, fq. 15. Qasur më 12 maj 2016, në: <<http://goo.gl/6XEVRp>>

163 Po aty, fq. 22.

164 Po aty, fq. 22.

165 Po aty, fq. 30.

166 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). *Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë*, fq. 1.

167 Po aty, fq. 21.

REKOMANDIME

Menaxhimi i burimeve njerëzore:

- Qeveria e Kosovës të miratojë sa më shpejt ligjin që rregullon pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policor. Gjithashtu, të ndahen mjetet buxhetore për Policinë për këtë çështje për përmirësimin e kuotës së moshës së zyrtarëve policor. Në këtë rrafsh, Policia duhet t'i kushtojë vëmendje më të madhe garantimit të një procesi të drejtë e transparent në përzgjedhjen e kandidatëve për zyrtarë policor për të shmangur çfarëdo mundësie të nepotizmit ose konfliktit të interesit.
- Policia të merr parasysh rekomandimet e Inspektoratit Policor për gradimin e zyrtarëve policor. Gradimet të bëhen duke respektuar procedurat ligjore dhe në bazë të meritës. Gjithashtu, menaxhmenti i Policisë të adresojë rekomandimet e Komisionit përkatës parlamentar që avancimi në grada të jetë i afatizuar.
- Qeveria duhet urgjentisht të rregullojë sigurimin shëndetësor për zyrtarët policor. Duhet të ketë edhe sigurim jetësor për policët në kuadër të punës së tyre meqë ata nuk marrin ndonjë dëmshpërblim ose kompensim për lëndimet dhe plagët gjatë detyrës zyrtare.

Kontrolli i brendshëm:

- Policia e Kosovës duhet të përgatis planin e integritetit me qëllim kryesor parandalimin dhe zvogëlimin e korrupsionit brenda-për-brenda institucionit. Për zbatimin e tij duhet të bëhet plani i veprimtari që do të parashihet me masat konkrete për forcimin e integritetit në radhët e Policisë, sidomos në këtë çështje: menaxhimin më të mirë të buxhetit të Policisë, menaxhim më të mirë të shpenzimeve në fushën e prokurimit publik, si dhe luftimin dhe parandalimin e korrupsionit policor.
- Të forcohen kapacitetet profesionale të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të Policisë për luftimin e korrupsionit policor. Përveç kësaj, të trajnohen zyrtarët e Policisë në fushën e hetimit dhe luftimit të korrupsionit policor.
- Inspektorati Policor i Kosovës të zhvillojë konceptin e etikës profesionale ndaj Policisë për hetimin e integritetit të personelit policor. Në këtë drejtim, duhet të kryejë funksionin e vet ligjor për të bërë teste të integritetit ndaj zyrtarëve policor me synim të profesionalizimit e demokratizimit të forcave të rendit. Inspektorati të jetë më transparent kur bëhet fjalë për hetimin e integritetit të policëve.

Pavarësia në vendimmarrje e Policisë:

- Politikanë të profilit të lartë, qoftë edhe ministra të Qeverisë së Kosovës, të qëndrojnë larg dhe mos të ndikojnë në punën e Policisë. Duhet të garantohet pavarësia e Policisë dhe policët nuk duhet të kenë frikë për ndëshkimin e politikanëve kur këta të fundit shkelin ligjin. Çfarëdo lloj ndërhyrje e jashtme në punët e brendshme të Policisë nuk duhet të pranohet nga menaxhmenti dhe niveli vendimmarrës i strukturës së Policisë.
- Policia e Kosovës në fakt duhet të motivohet të merret pikërisht me zyrtarë publik, e sidomos ata partiak, duke qenë se këta të fundit kanë përgjegjësi publike shumë më shumë se sa qytetarët e rëndomtë apo të tjerët. Kjo do të jepte shenjë të qartë të funksionimit, jo vetëm të Policisë si institucion, por edhe të shtetit nëpërmjet zbatimit të rendit dhe ligjit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.
- Policia e Kosovës të merr parasysh rekomandimet e mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë lidhur me intervenimin e Policisë në protestën e 28 nëntorit 2015. Inspektorati Policor i Kosovës do të duhej deri më tash (maj 2016) të dilte me një raport për performancën e Policisë në këtë protestë. Është urgjente që Inspektorati Policor, në afatin sa më të shkurtër, të inspektojë dhe hetojë këtë çështje. Ndërsa, organet e drejtësisë të zhvillojnë hetime të pavarura, në bazë të kërkesës së Avokatit të Popullit, nëse Policia kishte shkelur të drejtat e njeriut dhe tejkaluar autorizimet në këto ngjarje.

Transparenca:

- Komunikimi i Policisë së Kosovës me publikun duhet të avancohet. Kjo e fundit të ofrojë informata dhe statistika më të detajuara për aktivitetet e saja. Pos kësaj, duhet të ngritën kapacitetet e Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun të Policisë për t'ju përgjigjur kërkesave për informacion me kohë dhe në mënyrë të shpejtë.
- Raporti vjetor i Policisë të jetë më gjithëpërfshirës dhe të përfshijë në mënyrë më të plotë aktivitetet e departamenteve, drejtorive rajonale të Policisë dhe mekanizmave të brendshëm.
- Faqja e internetit e Policisë të rifreskohet dhe të përmbajë më shumë informacione për Policinë. Ajo duhet të jetë më lehtë e qasshme dhe duhet të thjeshtësohet më shumë.

Prokurimi publik:

- Ndryshimet e reja në Ligjin për Prokurim Publik duhet të ndikojnë në transparencën financiare të institucioneve të sigurisë, përfshirë Policinë e Kosovës. Kjo, gjithashtu, duhet të ndikojë në menaxhim më të mirë të aktiviteve të

prokurimit publik në Polici duke e ditur që në të kaluarën zyrtarë të Policisë ishin të dyshuar për keqpërdorime me procedura të prokurimit.

- Policia duhet të ofrojë më shumë të dhëna për kontratat që i lidhë me operatorë të ndryshëm ekonomikë për aktivitetet e prokurimit publik në institucionin e Policisë.

Mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e Policisë:

- Kuvendi i Kosovës duhet të jetë më aktiv dhe roli i tij të jetë më i madh në mbikëqyrjen demokratike të Policisë së Kosovës. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës të investojë në burime profesionale duke angazhuar ekspertë për të ushtruar mbikëqyrje të mirëfilltë parlamentare të sektorit të sigurisë, veçanërisht në Polici. Kapacitetet aktuale të komisionit janë të pamjaftueshme në mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare të Policisë dhe të zbatimit të legjislacionit të Policisë së Kosovës. Nga ana tjetër, Policia të adresojë rekomandimet e këtij komisioni sa i përket zbatimit të Ligjit për Policinë.
- Të inkurajohen zyrtarët policor dhe stafi civil i Policisë që në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut në vendin e punës të ushtrorjnë ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit. Zyrtarët që ushtrorjnë ankesë për shkelje të të drejtave të njeriut të mos bëhen subjekt i diskriminimit, viktimizimit ose hakmarrjes nga eprrorët e tyre në Polici.
- Policia e Kosovës të adresojë rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me shpenzimet dhe kontrollin financiar sipas raporteve vjetore të auditimit.

INTEGRITETI NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Autor: Skender Perteshi

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Menaxhimi financiar

- ⇒ Gjatë tre viteve të fundit, realizimi i shpenzimit të buxhetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), ka qenë në nivel të kënaqshëm. Është shpenzuar mbi 95 përqind e buxhetit të ndarë nga Qeveria e Kosovës;
- ⇒ Sfidë mbetet shpenzimi më i madh i buxhetit në 3 mujë të vitit të fundit (70%);
- ⇒ Buxheti për MFSK-në në vitin 2016 është caktuar të jetë 45 milion Euro, 9 përqind më i lartë krahasuar me vitin paraprak (41 milion Euro). Kjo shtesë është bërë me qëllim të modernizimit dhe përmbushjes së standardeve të nevojshme për transformim e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës.

Prokurimi publik

- ⇒ Procesi i prokurimit publik vazhdon të jetë sfidë për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës për shkak të dobësive nga njësitet kërkuese në hartimin e dosjeve të tenderëve, si dhe dizajnimin të specifikacioneve teknike;
- ⇒ Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk ka bërë pothuajse fare hulumtim të tregut për produktet, pajisjet, si dhe shërbimet të cilat ky institucion i kontraktton nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, gjë që potencialisht mund të lidhen kontrata me operatorët ekonomik të cilët ofrojnë çmime më të larta, krahasuar me çmimet e tregut vendor;
- ⇒ Stafi aktual i departamentit të prokurimit publik në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë ndjekur trajnimet e duhura të prokurimit publik megjithatë lypset ngritja e kompetencës në prokurimi e mbrojtjes, atë të inxhinierisë së ndërtimit dhe teknologjisë informative;
- ⇒ Neni 3 i Ligjit për Prokurim Publik i referohet përjashtimit të prokurimit të rregullt për arsye të sigurisë nacionale. Megjithatë, mungesa e rregullorës dhe zbatimi i tij në mungesë të procedurave të detajuara krijon hapësirë për shqetësime në integritet;
- ⇒ Gjatë vitit 2015, operatorët e ndryshëm ekonomik kishin bërë 6 ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Dy nga këto 6 ankesa ishin vendosur në favor të operatorëve ekonomik nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, dhe që të dy ankesat ishin aktivitete të prokurimit publik me vlerë të madhe;

Kontrolli i brendshëm

- ⇒ Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka të kryera trajnimet e duhura profesionale për auditim dhe inspektime në këtë institucion. Në këtë njësi punojnë vetëm me 3 zyrtar, që është numër shumë i vogël në krahasim me numrin e inspektimeve dhe mbikëqyrjes të cilën duhet ta kryej ky njësit;
- ⇒ Gjatë vitit 2015, NjAB ka kryer 9 inspektime;
- ⇒ Nga 33 rekomandimet e dhëna nga Njësia e Brendshme e Auditimit për vitin 2014, kdhe si rezultat Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës kishte adresuar vetëm 11 prej tyre;

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

- ⇒ Përshkrimet e detyrave të vendit të punës janë përpiluar në fazën e hershme të themelimit të FSK-së;
- ⇒ Lypset zbatimi i parimit të meritës në të gjitha nivelet e gradimit;
- ⇒ MFSK ka mungesë të kadrove profesionale të shkolluar dhe trajnuar mirë në kryerjen e punëve të karakterit jo ushtarak, sidomos në përgatitjen e planeve të punës, analizave dhe vlerësimin e nevojave për trajnime të Forcës së Sigurisë së Kosovës-së, si dhe menaxhimin e përgjithshëm të institucionit;
- ⇒ Mungesa e njohurive të gjuhëve të huaja, sidomos ajo e gjuhës angleze, është mjaft problematike për këtë institucion. Kjo ndikon negativisht në partneritetin bilateral dhe ngritjen e inter-operabilitetit sidomos në kontekst të integritetit në Paktin e Atlantikut të Veriut (NATO).

Integriteti dhe besueshmëria

- ⇒ MFSK nuk është pjesë e strategjisë nacionale kundër korrupsionit (2013-2017), dhe kjo ministri, nuk ka asnjë obligim për implementimin e këtij dokumenti. Ajo së voni është ftuar në takimet ndër-qeveritare ku ka marr vetëm disa obligime në Planin e Veprimt;
- ⇒ Procesit të deklarimit të pasurisë, prejardhjes së saj, si dhe kontrollit iu janë nënshtruar 36 zyrtarë. Nuk ka informacione lidhur me verifikimin e pasurisë së deklaruar;
- ⇒ MFSK është në proces të hartimit të planit të integritetit, duke u bërë institucioni i parë qeveritar me një nismë të tillë;
- ⇒ Mbikqyrja parlamentare e FSK-së është e mangët

1. HYRJE

Besueshmëria, qeverisja e brendshme, dhe integriteti janë parime kryesore të cilat garantojnë funksionalizim të qëndrueshëm dhe kredibil të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Aspekti ligjor i cili rregullon fushën e integritetit dhe qeverisjes së mirë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) është miratuar, dhe në përgjithësi është në përputhje me parimet dhe standardet evropiane. Përveç, miratimit të legjislacionit, implementimi i tyre, në fushat si: menaxhimi i burimeve njerëzore, prokurimi publik, kontrolli dhe mbikëqyrja e shpenzimit të fondeve publike, ende mbeten sfida për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK).

MFSK ende po përballet me mungesë të kapaciteteve njerëzore në menaxhimin e fushave të rëndësishme sic janë: prokurimi publik, menaxhimi i burimeve njerëzore, mbikëqyrja dhe shpenzimi i fondeve publike, si dhe auditimi. Ky raport hulumtues dhe monitorues vlerëson nivelin e transparencës dhe integritetit në këtë institucion, qeverisjen e brendshme, si dhe bashkëpunimin e FSK-së me institucionet e tjera. Të gjeturat e raportit tregojnë se MFSK ka sfida sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, sidomos në fushat: përshkrimi i detyrave në vendin e punës si dhe gradimit për zyrtarët dhe pjesëtarët e MFSK/FSK. Prokurimi publik poashtu po përballet me sfida të mëdha sidomos ka shumë lëshime në hartimin e specifikacioneve teknike për dosjet e tenderit, dhe mbikëqyrjen e zbatimit e kontratave të lidhura me operatorët ekonomik.

Ky publikim ka listuar një listë rekomandimesh përkatëse në lidhje me qeverisjen e brendshme dhe integritetin në MFSK. Të gjeturat e këtij hulumtimi synohet të përdoren si instrument për avokim në lidhje me përmirësimin e performancës institucionale në sektorin e sigurisë, qeverisjes së brendshme dhe forcimit të integritetit në këtë institucion. Për hartimin e këtij hulumtimi janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Janë intervistuar përfaqësuesit e MFSK-së, përfaqësuesit e Agjencioneve të Pavarura Shtetërore, si dhe akter tjerë relevant për çështjen e integritetit dhe qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë në Kosovë. Poashtu janë analizuar raportet zyrtare të MFSK-së si dhe të agjencioneve të pavarura shtetërore të cilët trajtojnë qeverisjen e brendshme dhe integritetin për MFSK. Për kompletimin e këtij raporti monitories Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka përdorur edhe të dhënat kuantitative të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS). Të dhënat e prezentuara në këtë raport përfshijnë periudhën monitoruese të vitit 2015, deri në Mars, 2016.

2. PROKURIMI PUBLIK

2.1. Korniza ligjore

Ndryshimet e shpeshta të Ligjit për Prokurim Publik (LPP) iu deshën t'iu përshtaten edhe aktet tjera nënligjore të cilat e bëjnë të mundur implementimin e këtij ligji. Këto ndryshime erdhën jo vetëm si kërkesë e brendshme e nevojave për reformim të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, mirëpo edhe si nevojë për përshtatje me direktivat e Bashkimit Evropian (BE) për prokurim publik të cilat ndryshoheshin shpesh. Ndryshimi i shpeshtë i LPP-së sjelli probleme të shumta për stafin e MFSK-në, të cilët punojnë me procedurat e prokurimit publik, sepse iu deshë t'i nënshtrohen trajnimeve të shpeshta për tu përshtatur më ndryshimet e këtij ligji. LPP-së i nënshtrohet edhe MFSK përkundër specifikave të cilat i ka kjo ministri.¹⁶⁸

Neni 3 i këtij ligji, përcakton se autoritetit kontraktues nuk i kërkohet të ndjek ndonjë procedurë të veçantë të prokurimit, ose të mbikëqyrë dispozitat e këtij ligji për shkalën e transparencës në kushtet, kur respektimi i procedurave të tilla do të rrezikonte interesat e sigurisë nacionale gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.

Megjithatë, kompletimi i procedurave përjashtuese për nevoja të organeve të sigurisë, përfshirë edhe MFSK-në, mund të bëhet vetëm atëherë kur të miratohet rregullorja që përcakton procedurat prokurimit publik për MFSK-në dhe e cila duhet të jetë derivat i Nenit 3 të LPP-së. Kjo rregullore, krahas detajimit të procedurave, duhet të jetë në përputhje me Direktivën e Prokurimit të Mbrojtjes të Bashkimit Evropian 2009/81.

2.2. Kapacitetet Administrative

Departamenti i cili funksionon në kuadër të MFSK-së dhe përbëhet nga stafi i uniformuar dhe ai civil, i përgjigjet sekretarit dhe Ministrin të MFSK-së për të gjitha aktivitetet e prokurimit publik. Aktualisht, si pjesë e departamentit të prokurimit publik në kuadër të MFSK-së, janë të punësuar 5 zyrtarë, të cilët janë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kontratave, dhe ofertave për të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të MFSK-së. Ky departament harton planin vjetor të prokurimit, për nevojat e MFSK, dhe i njëjti plan duhet ti dorëzohet Agjencisë Qëndrore të Prokurimit 60 ditë para fillimit të secilit vit financiar i njëjti duhet të miratohet nga kjo e fundit.¹⁶⁹

168 Kuvendi i Kosovës. Ligji i Prokurimit Publik 2016, Neni 3

169 Po aty:

Nëpërmjet procedurave të prokurimit publik në vitin 2015 në MFSK janë shpenzuar mbi 18 milion Euro, dhe të cilat janë mbikëqyrur nga ana e departamentit të prokurimit të MFSK-së. Duke marrë parasysh numrin e madh të kontratave dhe aktiviteteve të prokurimit, të cilat i kryen MFSK-ja, numri prej 5 zyrtarëve nuk i plotëson nevojat adekuate për kontrollin dhe mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë efikase.

Përveç numrit jo të mjaftueshëm të stafit, departamenti i MFSK-së ka treguar ngecje edhe sa i përket kapaciteteve për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik, e veçanarisht të ofertave për kontratat për pajisje të veçanta ushtarake dhe të mbrojtjes për nevojat e FSK-së. Për më tepër, rezultatet e monitorimit tregojnë se nuk bëhen shumë hulumtime rreth çmimeve aktuale të tregut, kjo për shkak të mungesës së njësisë së për hulumtime të tregut brenda MFSK.

Krahas kufizimeve njerëzore dhe profesionale me të cilat përballlet departamenti i prokurimit, publik, edhe njësitet kërkuese brenda MFSK-së përbëjnë sfidë në aktivitetet prokuruese. Njësitet kërkuese janë përgjegjëse për planifikimin dhe hartimin e të gjitha kërkesave për investime kapitale, mallra dhe shërbime, dhe aktivitete tjera të cilat ndërlidhen me fushën prokurimit publik në këtë institucion.

2.3. Implementimi

Të gjitha shpalljet për hapje të procedurave të prokurimit publik, publikohen në ueb-faqen e Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) si dhe të MFSK-së. Krahas hartimit të planit vjetor të prokurimit, MFSK-ja harton edhe planin vjetor të rrjedhjes së parasë i cili duhet të jetë në harmoni me planin vjetor të prokurimit publik, për të garantuar një mbikëqyrje më të mirë të shpenzimit të parasë publike, si dhe cilësi të shërbimeve të cilat operatorët ekonomik kryejnë për MFSK-në.¹⁷⁰ Në tre vitet e fundit, MFSK-ja shumicën (apo mbi 60 përqind) të pagesave i ka ekzekutuar në pjesën e fundit të vitit, kryesisht gjatë muajit dhjetor. Kjo mënyrë e kryerjes së pagesave, nuk është në linjë me planin vjetor të shpenzimit të parasë publike të MFSK-së, dhe e sfidon MFSK-së në mbikëqyrjen financiare të aktiviteteve të prokurimit publik. Ngutia për kryerjen e pagesave të shumta në muajin e fundit, si dhe qëllimit të ikjes së tepricës buxhetore, e bëjnë më të sfidueshëm kontrollin dhe mbikëqyrjen financiare të shpenzimit të fondëve publike në pjesën e fundit të vitit.

Gjatë vitit 2015, departamenti i prokurimit publik në MFSK, ka zhvilluar gjithësej 154 aktivitete të prokurimit publik, më vlera të kontratave të vogla, të mesme, dhe të mëdha. Prej 154 aktiviteteve të prokurimit, MFSK ka lidhur 119 kontrata me operatorët

170 Raporti i Auditorit të Përshprehshëm të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës për vitin 2014 <http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MFSK_2014_Shqip_946941.pdf>

ekonomik për investime kapitale, mallra dhe shërbime. Kurse për 26 aktivitetet pasi fillimit të procedurave të prokurimit publik, MFSK me vetë iniciative i kishte ndërprerë procedurat e prokurimit publik, me qëllim të përmirësimit të dosjeve të tenderëve dhe specifikacioneve teknike.¹⁷¹

Implementimi dhe monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura me operatorët ekonomik përbën problem tjetër për MFSK-në. Një numër shumë i vogël i menaxherëve janë të ngarkuar me mbikëqyrjen dhe zbatimin e 119 kontratave të lidhura ndërmjet MFSK-së dhe operatorëve të ndryshëm ekonomik për vitin 2015. Në shumicën e rasteve, një menaxher është i ngarkuar në mbikëqyrjen e zbatimit të më shumë se 2 e nganjëherë edhe 3 kontratave të ndryshme, në të njëjtën kohë.

Në MFSK ka mungesë të hulumtimeve të tregut, lidhur me çmimet të cilat ofrohen nga ana e operatorëve ekonomik për produkte dhe pajisje ushtarake dhe të mbrojtjes. Kosova nuk ka industri të mbrojtjes, kështu që MFSK importon nga operatorët ekonomik që operojnë jashtë Kosovës, sidomos kur bëhet fjala për pajisjet e veçanta për MFSK-në. Mungesa e njohurive të çmimit të tregut, po shfrytëzohet nga ana e operatorëve të ndryshëm ekonomik, të cilët po ofrojnë çmime të larta për kryerjen e shërbimeve dhe furnizimeve për nevojat e FSK-së dhe MFSK-së.¹⁷²

MFSK zakonisht në procedurat e prokurimit publik, si kriter kryesor e përdorë kriterin e çmimit më të ulët, i cili është i lejueshëm duke u bazuar në ligjin e LPP-së, edhe pse ligji lejon edhe kriterin ekonomik më i favorshëm. Mirëpo, kjo praktikë kishte ndryshuar kur janë zhvilluar procedurat e prokurimit publik për lidhje të kontratës për furnizim me ushqim dhe pije për nevojat e MFSK-së, ku kjo e fundit ka aplikuar kriterin e kontratës ekonomikisht më të favorshme. Në tetor të vitit 2015, MFSK-ja kishte shpallur tenderin për furnizim me ushqim dhe pije për të gjitha kazermat e MFSK-së, dhe fituese ishte shpallur kompania aktuale, "BENI DONA", e cila kishte ofertën 800 mijë euro më të lartë se sa operatori dyte më i lirë. Mirëpo, duke u ndier të dëmtuar nga ana e panelit vlerësues të FSK-së, kompania "Florenti dhe Korabi" kanë bërë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). OSHP ka vlerësuar si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik, dhe ka anuluar procesin e prokurimit për këtë tender, dhe e ka kthyer atë në ri-tenderim. MFSK-ja kishte ndërprerë procedurat e prokurimit publik, duke u bazuar në vendimin e OSHP-së, dhe ndaj vendimit të MFSK-së, kishte reaguuar kompania "BENI DONA".¹⁷³ Ankesën e BENI-DONËS, e kishte pranuar OSHP si të bazuar,

171 Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Prokurimit Publik të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës Afrim Maxhuni 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

172 Intervistë nga me një zyrtar të lartë të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës 17 Mars 2016

173 Për më shumë shih vendimin e OSHP-së: https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2015/511-15_vendim_mfsk_4_1.PDF

dhe përshkak të mungesës së bordit në OSHP ende nuk është marrë ndonjë vendim final.¹⁷⁴

Gjatë vitit 2015 operatorët ekonomikë kishin bërë 6 ankesa në OSHP, pasi ata konsideronin se ishin dëmtuar në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes në procedurat e prokurimit publik në MFSK. Për 2 ankesa të operatorëve ekonomikë, OSHP kishte vendosur në favor të operatorëve ekonomik. Njëra ankesë lidhej me furnizim me benzin dhe naftë për nevojat e MFSK-së, me ç'rast OSHP kishte vlerësuar se autoriteti kontraktues, MFSK në këtë rast, kishte bërë shkelje të ligjit të LPP dhe kishte rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit të shkonte në ri-vlerësim. Kurse ankesa tjetër ndërlidhej me furnizim me ushqim dhe pije për nevojat e MFSK-së, dhe OSHP kishte konstatuar se autoriteti kontraktues kishte bërë shkelje të LPP-së (kriteri çmimi më i ulët) dhe kishte rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit publik të shkonte në ri-tenderim. Të dy ankesat ishin aktivitete të prokurimit publik me vlerë të madhe.¹⁷⁵ Kurse për tre ankesat tjera të operatorëve ekonomik, OSHP kishte vendosur në favor të autoritetit kontraktues, dhe ishin refuzuar ankesat e operatorëve ekonomik si të pa baza. Për një ankesë të operatorëve ekonomik nuk është vendosur ende, për shkak të mungesës së bordit të OSHP-së.


174 Për më shumë shih vendimin e OSHP-së: https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2015/511-15_vendim_mfsk_4_1.PDF

175 Bazuar në ligjin për LPPP janë ndarë në vlerë të vogël, të mesme dhe vlerë të madhe buxhetore. "Kontratë me vlerë të madhe" konsiderohet me sa vijon: 1.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritët që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) Euro; ose 1.2. kontrata për punë ose pronë të paluajtshme, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se pesë qind mijë (500.000) Euro. 2.

"Kontratë me vlerë të mesme" konsiderohet me sa vijon: 2.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se dhjetëmijë (10.000) Euro, por më e vogël se njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) Euro; ose 2.2. kontrata për punë ose pronë të paluajtshme, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se dhjetëmijë (10.000) Euro, por më e vogël se pesë qind mijë (500.000) Euro.

3. Kontratat në vijim konsiderohen "kontrata me vlerë të vogël": Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se njëmijë (1.000) Euro, por më e vogël se dhjetëmijë (10.000) Euro. 4. Kontratat në vijim konsiderohen "kontrata me vlerë minimale": Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritët që të jetë më e vogël se njëmijë (1.000) Euro.

Figura 1. Numri i vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, rreth ankesave të operatorëve ekonomik për MFSK-në.



Përgarantimin e një procesi efikas të prokurimit publik, kërkohet një përmirësim shumë i madh i komunikimit, ndërmjet njësive kërkuese të MFSK-së, departamentit të logjistikës, departamentit të prokurimit, dhe atij të auditimit të brendshëm. Momentalisht nuk ekziston një harmonizim i aktiviteteve të cilat lidhen me procedurat e prokurimit publik, mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave, hartimit të specifikave teknike për procedurat e prokurimit publik. Zbatimi i mirëfilltë i Procedurave Standarde Operative (PSO) e ndihmon rritjen e komunikimit brenda departamenteve të MFSK-së, ndarjen e saktë të punëve të secilit departament në drejtim të forcimit të integritetit dhe qeverisjes së mirë në MFSK, dhe menaxhimin efikas të fondeve publike, duke përfshirë edhe procedurat e prokurimit publik.

3. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

3.1. Korniza ligjore

Korniza ligjore e cila e rregullon menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbyesve civil në Kosovë është në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe për parim kryesor në procesin e rekrutimit, ngritjes, transferimit e vlerësimit e ka meritën. Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për shërbyesit civil 03/L-149 në Kosovë, i cili rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhëniet e tyre në administratën publike në Kosovë. Ky ligj mbulon administratën publike në nivel qendror dhe lokal duke përfshirë: Kuvendin e Kosovës (KK), Qeverinë e Kosovës (ministritë), ndërmarrjet publike, si dhe agjencitë e pavarura shtetërore. Ligjit për shërbyesit civil i nënshtrohen edhe zyrtarët e MFSK-së, jo të uniformuar.¹⁷⁶

¹⁷⁶ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Shërbyesit Civil <https://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Sherbime/Tema/Kodi-i-miresjelljes-per-sherbimin-civil/Ligji-per-sherbyesit-civil.pdf.aspx>

Burimet njerëzore brenda MFSK-së rregullohen edhe me ligjin për Shërbimin në FSK, nr. 03/L-082 si dhe rregulloren nr. 06/2013m për zhvillimin dhe avancimin në karrierë për pjesëtarët e FSK-së. Ligji për shërbim në FSK aplikohet për të gjithë pjesëtarët e FSK-së duke përfshirë por duke mos u kufizuar në përbërjen dhe rekrutët e uniformuar (aktiv dhe rezervë).¹⁷⁷

Për menaxhimin sa më efikas të burimeve njerëzore, vlerësimin e performancës së tyre, si dhe ngritjen në karrierë të pjesëtarëve të FSK-së, ky institucion ka hartuar edhe legjislacionin sekondar i cili rregullon funksionimin e brendshëm të MFSK-së dhe FSK-së.¹⁷⁸ MFSK-ja ka hartuar: a) rregullorën Nr. 102/2015¹⁷⁹ për zgjidhjen e ankesave për pjesëtarët e MFSK-së, e cila bënë trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave për zyrtarët dhe pjesëtarët e FSK-së; b) rregullorën Nr. 02/2014, e cila rregullon procedurat për vlerësimin vjetor të punës dhe performancës së pjesëtarëve civilë dhe të uniformuar të FSK-së; c) rregulloren Nr. 06/2013, për zhvillimin e karrierës për pjesëtarët civil dhe të uniformuar të FSK-së; d) kodin disiplinor të FSK-së, i cili ka për qëllim të forcojë rendin dhe disiplinën brenda MFSK-së, me synim parandalimin dhe luftimin e shkeljeve disiplinore të MFSK-së, si dhe ngritjen e integritetit brenda FSK-së; e) rregullorën Nr. 02/2013¹⁸⁰ për rekrutimin në FSK e cila rregullon procesin e seleksionimit, dhe rekrutimit të pjesëtarëve civil dhe të uniformuar të FSK-së; f) rregullorën Nr. 06/2015 e cila përcakton detyrat, organizimin dhe mandatin e Inspektoratit të FSK-së¹⁸¹; g) rregullorën Nr. 04/2011,¹⁸² për shkarkimin e pjesëtarëve të FSK-së nga shërbimi; si dhe h) rregullorën Nr. 04/2009 për pagat për pjesëtarët civilë dhe të uniformuar të FSK-së dhe MFSK-së.¹⁸³

3.2. Kapacitetet administrative

Departamenti i Personelit në MFSK është i kombinuar me staf civil dhe të uniformuar. Shumica e stafit të cilët punojnë në këtë departament kanë qenë të punësuar edhe në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe kanë një përvojë të gjatë në menaxhimin e burimeve njerëzore. Ky departament përkujdeset për menaxhimin e përgjithshëm

177 Për më shumë shih: <<http://www.mksf-ks.org/?page=1,76>>

178 Për më shumë shih: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/R_regullore_MFSK_Nr_02_2015_per_shqyrtimin_dhe_zgjidhjen_e_ankesave_ne_FSK.pdf

179 Për më shumë shih: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Rregullore_MFSK_Nr_02_2015_per_shqyrtimin_dhe_zgjidhjen_e_ankesave_ne_FSK.pdf

180 Per me shumë shih: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/KODI_DISIPLINOR_I_FSK-Nr_01-2013.pdf

181 Për më shumë shih: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Rregullorja_per_Inpektoratin_e_FSK-se_1.PDF

182 Për më shumë shih: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Rregullorja_per_Inpektoratin_e_FSK-se_1.PDF

183 Për më shumë shih: <http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Rregullorja%2006%202011%20per%20Pagat%20ne%20FSK.pdf>

të burimeve njerëzore në MFSK, përshkrimin dhe ndarjen e detyrave të punës për pjesëtarët dhe stafin civil të MFSK-së, përcjellë promovimin, avancimin dhe gradimin e pjesëtarëve dhe stafit civil në këtë institucion.¹⁸⁴

3.3. Implementimi

Qeveria e Kosovës, ka arritur të krijojë shërbime dhe kushte të mira të punës për pjesëtarët dhe zyrtarët e MFSK/FSK-së. Struktura e MFSK-së është e kombinuar ku çdo departament i MFSK-së përbëhet nga stafi civil dhe i uniformuar. MFSK/FSK ka krijuar kushte të mira të punës për pjesëtarët dhe zyrtarët e saj, siç janë: pagat, ushqimi, transporti, pushimet, shkollimi, si dhe kushtet të tjera, çka e bënë stafin e MFSK-së si më të "privilegjuar" në administratën publike në Kosovë. Pagat e shërbyesve civilë të cilët punojnë në MFSK, dallojnë nga shërbyesit civil të institucioneve tjera publike në Kosovë, madje pagat e zyrtarëve të MFSK-së, janë dukshëm më të larta se sa kolegët e tyre të ministrave tjera, çka e bëjnë këtë institucion më specifik sa i përket shpërblimit të cilin e marrin. Si rrjedhojë, në stafin civil të MFSK-së nuk zbatohet Ligji për Pagat i Shërbyesve Civil nr. 3/L 147 (LSHC). MFSK-ja e aplikon këtë shkallë të pagave bazuar në një vendim të Qeverisë së Kosovës të vitit 2009. Arsyetimet bazohen në faktin e krijimit të një ekuivalence në paga në mes të stafit civil dhe ushtarak, ku dallimi është 5 përqind më i lartë tek stafi ushtarak megjithëse, krahasimisht, homologu i një shefi të sektorit në Ministri tjera të Qeverisë ka të hyrë shumë më të vogël. Megjithatë, MFSK-ja nuk ka shpërndarë bonuse të cilat janë ofruar me vendim të Qeverisë. Në përgjithësi, kushtet e mira për punë, kanë ndikuar që stafi i MFSK-së të jetë mjaft i motivuar për punë, si dhe e shohin këtë institucion si mundësi për ngritje në karrierë, sidomos pjesëtarët e uniformuar të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Motivimin dhe dëshirën për punë në MFSK na e tregojnë edhe numri i madh i aplikantëve që MFSK pranon për tu punësuar në këtë institucion, ku vetëm në konkursin e fundit ky institucion kishte pranuar mbi 5885 aplikime.

Përshkrimi i vendeve të punës për zyrtarët dhe pjesëtarët e FSK/MFSK-së ekziston, mirëpo ato kanë qenë të përpiluara para se ky institucion të ekzistonte. Kjo është bërë me ndihmën e Grupit Këshilldhënës të NATO-s. Përderisa në momentin e dizajnit të tyre, përshkrimi ka qenë i nivelit të kënaqshëm, tashmë me krijimin e një praktike dhe përvoja, një pjesë e përshkrimit të vendeve të punës është i përgjithësuar, dhe nuk korrespondon me disa nga pozitat. Me fjalë të tjera, ka shpërputhje ndërmjet përshkrimit të vendit të punës, dhe detyrave të cilat ata i kryejnë në praktikë, sidomos tek stafi civil. Deri në momentin kur është shkruar raporti, nuk ka pasur përditësim të vendeve të punës, mirëpo, një proces i nisur me asistencë të Qeverisë Norvegjeze ka për synim rishikimin e analizimit të vendeve të punës, sidomos në funksion të krijimit të pozitave

¹⁸⁴ Intervistë me nënkolonel Skënder Zhitia- Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore në MFSK. 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

për mandatin e ri të saj, pas transferimit të këti institucioni, në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK)

Përshkrimi i mangët i vendeve të punës në këtë institucion, ka ndikuar edhe në vlerësimin e dobët të performancës së zyrtarëve të MFSK-së dhe FSK-së. Vlerësimi i performancës i këtyre zyrtarëve dhe pjesëtarëve kryhet në baza të rregullta. Vlerësim më i saktë i performancës bëhet për zyrtarët e MFSK-së, kurse për pjesën e uniformuar të FSK-së, ky vlerësim bëhet më shumë si rutinë, se sa duke u bazuar në punët në të cilat kryhen nga zyrtarët e MFSK, për shkak të përshkrimit jo të saktë të vendeve të punës. Staf civil vlerësohet njëjtë sikurse ai ushtarak, edhe pse që nga viti 2012 ekziston Rregullorja e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) 2012/19. Aktualisht, kjo rregullore ende nuk ka gjetur zbatim për arsye se kërkon familjarizimin e stafit me procedurat e reja.¹⁸⁵

Disa pozita të larta në FSK/MFSK, ende kanë mbetur vetëm me ushtrues detyre. Plotësimi i këtyre pozitave ishte pengë e pritjes së miratimit të ndryshimeve të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) dhe transformimit të kësaj force, në forcë ushtarake, me mision dhe mandat të ri.¹⁸⁶ Momentalisht, në MFSK janë dy drejtorë të departamenteve brenda MFSK-së që funksionojnë si ushtrues detyre. Në pozita si ushtrues detyre në FSK funksionon pozita e shefit të shtabit në FSK, një oficer që punon në zyrën e Ministrit, si dhe dy oficerë të lartë udhëheqës të sektorëve në FSK.¹⁸⁷ Vazhdimi i këtyre pozitave vetëm me ushtrues detyre, mund të ndikojë në performancën e përgjithshme të zyrtarëve të saj, si dhe në pavarësinë e marrjes së vendimeve nga ana e tyre.

Puna si pjesëtar i FSK-së shihet si shumë tërheqëse nga qytetarët e Kosovës, kryesisht të rinjtë, sidomos kur kemi parasysh shkallën shumë të lartë të papunësisë. FSK gjatë konkurseve të shpallura për vend pune, ka pranuar numër shumë të madh të aplikimeve. Në konkursin për pranimin e rekrutëve të rinj, për stafin ushtarak në vitin 2014/2015, MFSK kishte planifikuar rekrutimin e 334 rekrutëve të rinj¹⁸⁸. Për këto 334 pozita të lira, kishin aplikuar 5885 kandidatë. Konkurenca ishte shumë e madhe, afërsisht raporti në mes të aplikimeve dhe vendeve të punës ishte 17-18 aplikime për një pozitë të lirë. Ky është një tregues se vlerësimi i aplikacioneve, dhe procesi i seleksion-

185 Për më shumë shih në rregullorën për vlerësimin e nëpunësve civil: < <https://map.rks-gov.net/getattachment/d5cd6705-10c1-4b02-a6e1-3cd12c76ed67/RREGULLORE-NR-19-2012-PER-VLERESIMIN-E-REZULTATEVE.aspx>>


186 Intervistë me nënkolonel Skender Zhitia- Drejtor i personelit në MFSK. 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

187 Intervistë me nënkolonel Skender Zhitia- Drejtor i personelit në MFSK 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

188 Intervistë me nënkolonel Skender Zhitia- Drejtor i personelit në MFSK 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

imit të kandidatëve në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë transparente ka qenë shumë e vështirë, për shkak të numrit të madh të aplikimeve.¹⁸⁹

Fig 2. Numri i aplikimeve për vende punë në FSK në vitin 2014/2015



Procesi i rekrutimit dhe seleksionimit për pjesëtar të FSK-së ishte kritikuar se nuk ishte garantuar procesi i vlerësimit të kandidatëve për pjesëtarë të FSK-së. Për këtë proces, bazuar në deklaratimet e së paku një deputeti të Kuvendit të Kosovës, ishin bërë ankesa nga ana e aplikuesve, të cilët kishin dyshime se në procesin e rekrutimit, kandidatët nuk ishin pranuar në bazë të meritës dhe rezultateve që ata kishin treguar në testimet dhe intervistë, por se një numër i madh i kandidatëve ishin përzgjedhur në bazë të nepotizmit, dhe rajoneve nga vinin.¹⁹⁰ Kjo pyetje iu kishte bërë komandantit të FSK-ë gjatë raportimit në komision parlamentar për punë të brendshme dhe siguri, dhe mbikëqyrjen e FSK-së në Mars 2016.¹⁹¹ Mirëpo, në krahasim me numrin e aplikacioneve të pranuar, numri i ankesave të bëra nga kandidatët e pa-suksesshëm ishte shumë i vogël. Vetëm 5 kandidatë kishin bërë ankesë rreth procedurave të seleksionimit dhe rekrutimit të kryera nga MFSK-ja, dhe të cilat ishin trajtuar nga ana e zyrës së rekrutimit të MFSK-së. Kjo tregon mungesën e kulturës për ankimim, jo vetëm për shkak të traditës së vogël institucionale, por edhe për shkak të mosbesimit, se ankimi mund të rezultojë në ndryshim në favor të palëve.

¹⁸⁹ Intervistë me nënkolonel Skender Zhitia- Drejtor i personelit në MFSK 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

¹⁹⁰ Anton Cuni antëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të bërë gjatë raportimit të komandantit të FSK-së para anëtarëve të komisionit 09 Mars 2016. Kuvendi i Kosovës. < http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2016_03_09_11_6350_al.pdf>

¹⁹¹ Anton Cuni antëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të bërë gjatë raportimit të komandantit të FSK-së para anëtarëve të komisionit 09 Mars 2016. Kuvendi i Kosovës. < http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2016_03_09_11_6350_al.pdf>

Poashtu, në procesin e rekrutimit është vërejtur nivel i dobët i verifikimit të së kaluarës i kandidatëve të cilët aplikojnë si pjesëtarë të FSK-së. Kjo mangësi ishte rezultat i numrit të vogël të stafit të cilët punojnë në proces të rekrutimit dhe përzgjedhjes. Poashtu edhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë, në shkëmbimin e informacioneve, të nevojshme për të vlerësuar dhe përzgjedhur aplikantët në MFSK kishte afektuar procesin e verifikimit të së kaluarës së aplikantëve.

Për pjesëtarët e FSK-së ekziston një mundësi për zhvillimin e karrierës brenda këtij institucioni. Sidomos vlenë të theksohet se për kadetët të cilët shkollohen në Qendrën për Studime Universitare (QSU) brenda FSK-së, organizohen trajnime profesionale në akademitë e njohura të Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) e Britanisë së Madhe, të cilët tregojnë rezultate shumë të mira.¹⁹²

Vitin e kaluar ish kadeti i QSU-së (MFSK)-së është shpallur kadeti më i mirë ndërkom-bëtar në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst, në Britaninë e Madhe.¹⁹³ Mirëpo, përvojat dhe shkathtësitë të cilat i marrin oficerët e FSK-së jashtë vendit, nuk kanë hapësirë që ti praktikojnë dhe zhvillojnë brenda FSK-së dhe në kontekst të funksionimit të saj, për shkak të statusit dhe mandatit aktual të saj. Vonesat në ndryshimin e misionit aktual të FSK-së, prej një force për ndërhyrje në rast të emergjencave civile, në forcë ushtarake, ka bërë që motivimi i oficerëve dhe të diplomuarëve të QSU-së, së FSK-së, si dhe në përgjithësi i ushtarëve të FSK-së të bie.¹⁹⁴

Niveli i ulët dhe i mesëm i menaxhimit dhe komandues në FSK/MFSK, është i mbuluar mirë me oficerë ushtarak, të cilët janë të shkolluar mirë, të specializuar, dhe të gatshëm të kryejnë detyrat tjera të mbrojtjes, krahas detyrave aktuale të MFSK/FSK-së të përcaktuara me ligj. Këta oficerë kryesisht janë kuadro të dalluara dhe të edukuara nga Qendra për Studime Univerzitare e FSK-së. MFSK ka mungesë të oficerëve të karrierës në nivelin strategjik, të cilët do të ishin të gatshëm të merrnin detyra të reja, të cilat do t'i caktohen MFSK-së në të ardhmen.

Duke u bazuar në planin për avancim dhe gradim, për pjesëtarët e FSK-së, ky institucion kishte ngritur në karrierë një numër të madh të oficerëve dhe të nën-oficerëve të FSK-së. Në vitin 2015, MFSK kishte avancuar dhe graduar 242 pjesëtarë të FSK-së duke përfshirë gradat e larta të oficerëve dhe të nën-oficerëve të FSK-së. Numrin më të lartë të të avancuarve në detyrë në vitin 2015, e përbëjnë nën-oficerët e FSK-së, me 218 avancime dhe gradime, kurse vetëm 24 avancime në gradat e oficerëve ishin

192 Toger i FSK-së Ismail Hoxha, shpallet kadeti më i mirë ndërkombëtar në Akademinë Ushtarake në Londër < <http://gazetablic.com/kadeti-i-fsk-se-ismail-hoxha-shpallet-me-i-miri-ne-akademe-ushtarake-ne-londer/>>

193 Oficeri i FSK-së shpallet më i miri nga ndërkombëtarët në Akademinë Mbretërore Ushtarake Sandhurst në Britani të Madhe. < <http://www.mksf-ks.org/?page=1,24,1529#.VytAdoRcSko>>

194 Intervistë me një oficer të FSK-së, i diplomuar në QSU-në e FSK-së, 16 Dhjetor 2015, Prishtinë

bërë në vitin 2015.¹⁹⁵ Nuk dihen arsyet e avancimeve të pakta mes atyre në nivelin e oficerëve të lartë, dhe se nuk kemi të dhëna rreth ankesave në këtë proces. Avancimet në zinxhir ushtarak, vënë në lëvizje shumë oficerë, dhe kjo ndihmon jo vetëm në fuqizimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, por edhe në ngritjen e një ndër motiveve primare të çdo oficeri të karrierës.




Fig 3. Numri i gradimeve të bëra në MFSK në vitin 2015.

Në anën tjetër, MFSK/FSK-ja ka mungesë të kuadrove profesionalë të shkolluar dhe trajnuar mirë, në nivel të lartë të menaxhimit të pjesës së uniformuar dhe ministrisë së FSK-së, në kryerjen e punëve të karakterit jo-ushtarak, sidomos në përgatitjen e planeve të punës, analizave dhe vlerësimin e nevojave për trajnime të FSK-së, si dhe menaxhimin e përgjithshëm të institucionit. Me edukim universitar janë vetëm 55 përqind e stafit civil të cilët punojnë në MFSK. Kurse pjesëtarët e uniformuar të FSK-së, vetëm 25 përqind e tyre kanë përgatitje universitare.¹⁹⁶ Prej 25 përqind e kuadrove me nivel universitar të pjesëtarëve të FSK-së, 80 përqind e tyre janë oficerë, kurse pjesa tjetër janë nën-oficer të FSK-së.¹⁹⁷ Po ashtu edhe njohuritë e gjuhëve të huaja, sidomos ajo e gjuhës angleze nuk është në nivel të kënaqshëm për pjesëtarët e FSK-së, dhe zyrtarët e MFSK-së.¹⁹⁸ Kjo ndikon negativisht në partneritetet bilaterale dhe ngritjen e inter-operabilitetit, sidomos në kontekst të integritimit në Paktin e Atlantikut të Veriut (NATO). Mungesa e njohurisë së gjuhëve të huaja, si dhe kuadrove profesionale në

¹⁹⁵ Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në MFSK Skender Zhitia 18 Mars 2016. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

¹⁹⁶ Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në MFSK Skender Zhitia 18 Mars 2016. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

¹⁹⁷ Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në MFSK Skender Zhitia 18 Mars 2016. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

¹⁹⁸ Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në MFSK Skender Zhitia 18 Mars 2016. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

nivel të lartë të menaxhmentit në FSK dhe MFSK ndikon në ngadalësimin e integritimit të këtij institucioni në NATO, si dhe e bënë të vështirë zhvillimin dhe ndërtimin e kësaj force në përputhje me standardet dhe kriteret e NATO-s për forcat e armatosura.

Qeveria e Kosovës ende nuk ka arritur të zgjidhë çështjen e sigurimit shëndetësor për pjesëtarë të FSK-së. Përveç, pjesëtarëve të kompanisë për deminim, asnjë pjesëtar i FSK-së apo i MFSK-së nuk kanë sigurim shëndetësor, çka e bënë institucionin e vetëm të mbrojtjes në rajon, i cili nuk ka sigurim shëndetësor për pjesëtarët e saj. Mungesa e spitalit ushtarak e rëndon edhe më shumë këtë situatë.

MFSK megjithatë ka arritur të zgjidhë çështjen e pensionimit të pjesëtarëve të saj. Krahasuar me Policinë e Kosovës, Ligji për Pensionimin e Pjesëtarëve të FSK-së 2011/04-L-084 mundëson pensionimin në bazë të disa kategorive dhe marrjen e pensioneve të pranueshme në bazë të shkallëve dhe në përputhje me gradën e fundit që kanë pasur pjesëtarët tashmë të pensionuar. Zbatimi i këtij ligji është në nivel të kënaqshëm.

FSK dërgon një numër të madh të zyrtarëve të uniformuar dhe civil nëpër trajnimet jashtë vendit. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për trajnim jashtë vendit, nuk bëhet në bazë të meritës, dhe përgatitjes profesionale që kanë pjesëtarët dhe zyrtarët e MFSK/FSK-së. Shpeshëherë ka lëshime në kriteret për përzgjedhjen e stafit për trajnime dhe specializime jashtë vendit, duke i favorizuar zyrtarët e caktuar të cilët kanë afërsi më të madhe me menaxhmentin e lartë aktual të MFSK-së.¹⁹⁹

MFSK po ashtu nuk ka mundur të adresojë çështjen e të punësuarve me kontrata mbi vepër me zyrtarë të ndryshëm, duke mos përfillur konkursin, si dhe në kundërshtim me ligjin për shërbyesit civil. Një numër i zyrtarëve të MFSK-së ende punojnë me kontrata mbi vepër, zyrtarë të angazhuar në disa departamente, varësisht prej nevojave të MFSK-së.²⁰⁰ Në mungesë të planifikimeve të nevojshme të MFSK-së, rreth kuadrove të saj, ky institucion ende angazhon zyrtar me kontrata të përkohshme, duke mos përfillur konkursin e hapur për rekrutim.²⁰¹

MFSK-ja kishte vështirësi me integrimin e pakicës serbe në MFSK, të cilët për arsye politike nuk i janë bashkuar këtij institucioni. Ka pasur një vullnet institucional nga ana e Kosovës, për integrimin e pakicës serbe, mirëpo diskursi mbizotërues anti-FSK në qarqet politike serbe, ka penguar dukshëm procesin e rekrutimit.²⁰² Poashtu edhe udhëheqësit serb të komunave në pjesën veriore të Kosovës, kanë qenë mjaft aktiv, në parandalimin e serbëve për integrim në FSK, të cilët kanë ndikuar direkt në vullnetin

199 Intervistë me një zyrtar të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, 18 Shkurt 2016, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

200 Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në MFSK Skender Zhitia 18 Mars 2016. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

201 ZAP 2014 < http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MFSK_2013_Shqip_965255.pdf>

202 Për më shumë shih: < <http://www.evropaelire.org/a/1491408.html>>

e qytetarëve serb për integrim në FSK.²⁰³ Megjithatë, ka një integrim mjaft të mirë të pjesëtarëve të pakicave tjera që jetojnë në Kosovë.²⁰⁴ Tabela e mëposhtme tregon se, me përjashtim të komunitetit serb, pjesa tjetër e pakicave janë mjaft mirë të përfaqësuar në FSK, madje ka mbipërfaqësim duke e krahasuar këtë numër me numrin total të popullsisë, me çka vërtetohet edhe besueshmëria e tyre ndaj FSK-së. Aspekti financiar dhe punësimi i qëndrueshëm në FSK poashtu kanë qenë faktor motivues për pjesëtarët e komuniteteve pakicë për integrim dhe punësim në MFSK/FSK.

Tabela 1. Numri i pjesëtarëve në MFSK, duke përfshirë komunitetet pakicë.

Përkatësia etnike	Numri i pjesëtarëve	Përqindja e integruar në FSK (përqindje)	Përqindja ne total, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë 2011 (përqindje)
Shqiptar	2,043	91.08	92.9
Serb	42	1.87	1.5 ²⁰⁵
Boshnjak	48	2.14	1.6
Turk	55	2.45	1.1
Ashkali	28	1.25	0.9
Romë	3	0.13	0.5
Goran	2	0.9	0.6
Të tjerë	4	0.18	0.1

4. AUDITIMI I BRENDSHEM NE MFSK

4.1. Korniza ligjore

Dy ligjet e rëndësishme të cilat ndërlidhen me funksionimin e njësive të brendshme të auditimit janë: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike Nr. 03/L-048 dhe Ligji për Njësinë e Brendshme të Auditimit Nr. 02/L-74.

Ligji aktual për Menaxhimin e Financave Publike Nr. 03/L-048 ka krijuar hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e kontrollit efikas mbi financat publike, si dhe definon

203 Për më shumë shih: < <http://www.evropaelire.org/a/1491408.html>>

204 QKSS 2015- Përfaqësimi i minoriteteve në institucionet e sigurisë në Kosovë. < http://www.qkss.org/repository/docs/P%C3%ABrfshirje_apo_p%C3%ABrjashtim_Minoritetet_n%C3%AB_Sektorin_e_Siguris%C3%ABn%C3%AB_Kosov%C3%ABn_e_Pas-pavar%C3%ABsis%C3%AB_805000.pdf>

205 Serbët e pjesës Veriore të Kosovës, nuk i janë përgjigjur thirrjes për regjistrimin e popullsisë të kryer në vitin 2011. Poashtu edhe serbet e pjeës jugore të Kosovës iu kanë përgjigjur pjesërisht thirrjes për regjistrim.

në detaje procedurat e paraqitjes së propozimeve buxhetore dhe të raportimit, si dhe përcakton mandatin e mekanizmave institucionalë të mbikëqyrjes dhe kontrollit të financave publike.²⁰⁶ Kurse ligji për Auditimin e Brendshëm Nr. 02/L-74 ka krijuar një bazë të mjaftueshme ligjore për rregullimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Nëpërmjet ligjit për NjAB përcaktohen përgjegjësitë dhe mandati i NjAB-ve si dhe garantohet pavarësi e plotë gjatë ushtrimit të mandatit nga ana e auditorëve të brendshëm.²⁰⁷ Qëllimi i këtij ligji është vendosja e një kontrolli më të madh, dhe më efikas në mbikëqyrjen e shpenzimit të parasë publike. Ky ligj i obligon institucionet e vendit që të themelojnë komitetet e auditimit me qëllim të mbikëqyrjes dhe monitorimit të shpenzimeve publike nga ana e institucioneve i cili përfshinë edhe MFSK-në²⁰⁸

4.2. Kapacitetet administrative

Njësia e Brendshme e Auditimit (NjAB) funksionon në kuadër të MFSK-së. Me strukturë ekzistuese, NjAB i përgjigjet Sekretarit të MFSK-së që nuk përbën një praktikë të mirë, megjithëse, pavarësisht strukturës, në praktikë NjAB është duke iu përgjigjur drejtpërdrejt Ministrisë. Në kuadër të NjAB të MFSK-së funksionojnë 3 zyrtarë, drejtori i auditimit të brendshëm, zv-drejtori dhe një zyrtar. Këta zyrtarë janë të çerfitikuar nga ana e njësisë qëndrore të auditimit, dhe zakonisht i nënshtrohen trajnimeve të nevojshme në drejtim të rritjes së cilësisë së auditimit të brendshëm brenda ministrisë së FSK-së.²⁰⁹ Duke marrë parasysh buxhetin e madh të MFSK-së, si dhe kompleksitetin e natyrës së punës së saj, numri prej tre zyrtarëve nuk i plotëson as nevojat minimale për NjAB-në e MFSK-së. Për mëse një vit, NjAB ka funksionuar vetëm me dy zyrtarë, për arsye të ndryshme,²¹⁰ duke vështirësuar edhe më shumë punët dhe aktivitete të NjAB-së brenda MFSK-së. Kjo njësi ka nevojë për rritje të stafit brenda NjAB, në mënyrë që të jetë në gjendje të rrisë efikasitetin e saj, për një monitorim dhe mbikëqyrje efektive të aktiviteteve të MFSK.²¹¹

Me numrin aktual të stafit, NjAB e ka të vështirë që të kryejë inspektime tek procedurat e prokurimit publik, vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të marrë nga operatorët ekonomikë, menaxhimin e burimeve njerëzore në MFSK, menaxhimin e pasurisë dhe asetëve të MFSK-së, si dhe kontrollin dhe ligjshëmrinë e shpenzimeve publike të MFSK-së.²¹²

206 Kuvendi i Kosovës- Ligji për Kontrollin dhe Menaxhimin e Financave Publike

207 Kuvendi i Kosovës- Ligji për Njësinë e Brendshme të Auditimit

208 Kuvendi i Kosovës- Ligji për NjAB-të

209 Intervistë Auditorin e Brendshëm në MFSK- Mars 2016

210 Një zyrtar i NjAB i MFSK kishte për një vit probleme shëndetësore

211 Intervistë Auditorinë e Brendshëm në MFSK- 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës


212 Intervistë me një zyrtar të lartë të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës 18 Shkurt 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

4.3. Implementimi

Njësia e Brendshme e Auditimit (NjAB) e MFSK-së në përputhje me vlerësimet dhe planifikimet e bëra, harton planin vjetor dhe tre vjeçarë të auditimit. Këto plane përfshijnë auditimet e rregullta, dhe ato ad-hoc apo të jashtëzakonshme. Plani i rregullt i auditimit vjetor bëhet duke u bazuar në vlerësimin e rreziqeve të cilat mund të ndodhin, në sektorët më të ndjeshëm, ku ka shpenzim më të madh të buxhetit siç janë: procedurat e prokurimit publik, menaxhimi i aseteve, resurset njerëzore, si dhe objektet me karakter strategjik të FSK-së. Duke u bazuar në këtë vlerësim NjAB përcakton edhe objektivat dhe inspektimet të cilat duhet të bëhen në MFSK.²¹³

Në vitin 2015 janë kryer inspektime dhe auditime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, në sektorët më të ndjeshëm të MFSK-së. Prej tyre, 8 auditime kanë qenë të rregullta të parapara me planin vjetor të auditimit, kurse një auditim është bërë ad-hoc me kërkesë të menaxhmentit të MFSK-së. NjAB në vitin 2015 ka hartuar 8 raporte të inspektimit, për të cilat ka dhënë gjithësejt 33 rekomandime, prej të cilave 11 rekomandime janë zbatuar plotësisht, 17 rekomandime janë në proces të zbatimit, kurse 6 rekomandime nuk janë zbatuar fare. Niveli i ulët i adresimit të rekomandimeve të NjAB-së nga ana e MFSK-së, po ndikon në ngadalësimin e reformimit të institucionit të MFSK-së si dhe përmirësimin e qeverisjes së brendshme të saj.

Fig 4. Shkalla e adresimit të rekomandimeve të NjAB-së nga ana e MFSK-së.



Në bazë të të gjeturave të inspektimeve janë vërejtur rastet kur MFSK-ja ka lidhur kontrata mbi vepër me zyrtarë të ndryshëm, për nevoja specifike të departamenteve të MFSK-së, duke mos përfillur fare konkursin e hapur. Një numër i caktuar i zyrtarëve në MFSK janë duke punuar me kontrata të përkohshme, të cilët janë rekrutuar për nevoja specifike të departamenteve të MFSK-së, sidomos për ekspertizë të caktuar të cilat nuk i posedojnë stafi i MFSK-së.

Raportet e auditimit të brendshëm, kanë identifikuar lëshime edhe në departamentin e logjistikës, sidomos mungesën e analizave të çmimeve të tregut për mallra, pajisje

213 Ligji për Shërbim në MFSK

dhe shërbime për nevojat e FSK-së. Kjo vërtetohet edhe me blerjen e autobusave për nevojat e FSK-së, ku ishin blerë dy autobusë me qmime shumë të larta, jashtë çmimeve reale të tregut. Menaxhimi i burimeve njerëzore mbetet ndër sfidat më të mëdha të MFSK-së që është vërejtur nga NjAB-ja. NjAB kishte kryer inspektime, dhe janë vërejtur mangësi sa i përket përshkrimit të vendeve të punës për stafin civil dhe të uniformuar, dhe nuk kishte ndarje dhe profilizim i mirëfilltë të vendeve të punës, e si pasojë e kësaj, edhe vlerësimi i performancës për zyrtarët dhe pjesëtarët e FSK/MFSK-së, ishte bërë vetëm formalisht.

5. INTEGRITETI DHE BESUESHMËRIA NË MFSK

MFSK ka hartuar kodin e disiplinor, i cili ka për qëllim forcimin e integritetit të pjesëtarëve të FSK-së, për të parandaluar shkeljet disiplinore të pjesëtarëve të saj, përcaktimin e shkeljeve të cilat nuk përbëjnë vepër penale, si dhe procedurat për adresimin dhe trajtimin e ankesave për pjesëtarët e FSK-së. Sjellja e pjesëtarëve dhe zyrtarëve të MFSK/FSK-së është e rregulluar me kodin e mirësjelljes së FSK-së. Mirësjellja e zyrtarëve dhe pjesëtarëve të MFSK-së është shumë e rëndësishme në ruajtjen e imazhit, kredibilitetit, besueshmërisë dhe integritetit të përgjithshëm të forcës.²¹⁴

Për parandalimin e keqpërdorimeve potenciale dhe të integritetit institucional brenda FSK/MFSK-së kërkohet edhe përgatitja e planeve institucionale të integritetit. Plani i integritetit do të rregullonte qartë objektivat e insitucionit të FSK-së në parandalimin e keqpërdorimeve potenciale të fondeve të FSK-së, involvimin e zyrtarëve dhe pjesëtarëve të FSK/MFSK-së në afëra korruptive, vlerësimin e kërcënimeve dhe rreziqeve të shpenzimit të fondeve publike, sidomos ato në sistemin e prokurimit publik në FSK.

Aktualisht, MFSK-ja nuk ka ndonjë dokument të detajuar në bazë të të cilit do të punohej në promovimin dhe forcimin e integritetit brenda saj. Nuk ekziston ndonjë vlerësim kualitativ në lidhje me atë se cilat mund të jenë kërcënimet dhe rreziqet që mund ta dëmtojnë integritetin dhe kredibilitetin e FSK-së, si dhe marrjen e masave për luftimin dhe parandalimin e tyre. MFSK me mbështetjen e një projekti norvegjez ka bërë hapat fillestar drejt hartimit të dokumenteve dhe politikave për promovimin dhe ngritjen e integritetit brenda FSK-së. Është duke u punuar në përgatitjen e Planit të Integritetit për FSK-në, në të cilin do të prezentohen objektivat e saj, në drejtim të forcimit të integritetit dhe kredibilitetit të saj. Është themeluar grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit nga zyrtar të FSK/MFSK-së, dhe ekspert nga Qendra për


214 Per me shume: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/KODI_DISIPLINOR_I_FSK-Nr_01-2013.pdf

Integritet nga Ministria e Mbrojtjës e Norvegjisë, i cili pritet të finalizohet nga mesi i këtij viti.²¹⁵ Fokusi i planit të integritetit të FSK-së, duhet të jetë i orientuar në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në MFSK, sidomos në procedurat e prokurimit publik në Kosovë, parandalimin e keq-përdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar në MFSK, menaxhimin e burimeve njerëzore, parandalimin e konfliktit të interesit dhe fuqizimin e kontrollit të brendshëm.

5.1. Besueshmëria publike ndaj FSK-së

FSK-ja gëzon një besueshmëri të lartë nga qytetarët e Kosovës. Për vite me radhë, FSK-ja është renditur si institucioni më i besueshëm i sigurisë në Kosovë. Në anketën e fundit të prezantuar në Dhjetor të vitit 2015, në kuadër të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS 2015), rreth 69 përqind e qytetarëve të intervistuar janë shprehur se i besojnë, dhe janë të kënaqur me punën e FSK-së.²¹⁶ Të dhënat e BKS 2015 po ashtu tregojnë që 65 përqind e qytetarëve të anketuar i besojnë punës së KFOR, ndërsa rreth 56 përqind i besojnë punës së Policisë së Kosovës.²¹⁷

Figura 5. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me besueshmërinë në FSK



FSK-ja gëzon një besueshmëri shumë të madhe edhe tek pakicat në Kosovë, me përjashtim të pakicës serbe. FSK-së më së shumti i beson popullata shqiptare me 75 përqind të qytetarëve të intervistuar. Pastaj komunitetet pakicë jo-serbe (turqë, goranë, boshnjakë, dhe të komunitetit RAE) të ky 62 përqind e tyre i besojnë punës së FSK-së. Ndërsa, pakica serbe ka një rezervë më të madhe sa i përket punës së FSK-së, ku rreth 76 përqind e të anketuarve nga radhët e bashkësisë serbe në Kosovë, nuk i besojnë punës së FSK-së, kurse pjesa tjetër janë disi më neutral ndaj saj. Procesi i integritetit të serbëve në FSK ende mbetet peng i qëndrimit politik serb ndaj shtetësisë së Kosovës


215 Për më shumë: <http://kallxo.com/qeveria-norvegjeze-ndihmon-fsk-ne-tu-afrohet-standardeve-te-nato-s/>

216 Barometri Kosovar i Sigurisë. QKSS 2015

217 Barometri Kosovar i Sigurisë. QKSS 2015


dhe ndaj institucionit të FSK-së, e cila FSK-në e sheh si kërcënim për sigurinë nacionale të Serbisë. Pavarësisht qëndrimit të komunitetit serb ndaj punës dhe aktiviteteve të FSK-së, ky institucion ka arritur që në strukturat e saj të integrojë një numër solid të serbëve, si pjesëtarë të barabartë në FSK.²¹⁸

Fig 6. Besueshmëria sipas komuniteteve ndaj FSK-së



Qytetarët janë pyetur edhe rreth perceptimit të tyre në lidhje me shkallën e përhapjes së korrupsionit brenda për brenda FSK-së. Prej 1,070 qytetarëve të anketuar, 73 përqind e tyre e vlerësojnë FSK-në si institucion të pakorruptuar, përderisa 7 përqind e të anketuarve kanë shprehur mendimin se FSK-ja është e korruptuar, dhe 11 përqind prej tyre janë deklaruar se deri diku ka korrupsion në FSK. Kurse pjesa tjetër prej 9 përqindë nuk kanë dhënë ndonjë opinion sa i përket përhapjes së korrupsionit brenda FSK.²¹⁹

Fig 7. Perceptimi i përhapjes së korrupsionit në FSK.



218 Barometri Kosovar i Sigurisë. QKSS 2015

219 Barometri Kosovar i Sigurisë. QKSS 2015 <http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Sigurise_-_edicioni_i_pestes_621222.pdf>

6. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE DHE DEMOKRATIKE E SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË

6.1. Legjislacioni

Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjet të cilat rregullojnë mandatin dhe funksionin e agjencive të pavarura shtetërore. Është miratuar ligji nr. 03/L-075, Zyrën e Auditorit e Përgjithshëm (ZAP) i cili ka për mandat auditimin e të gjitha aktiviteteve financiare të institucioneve publike të cilat funksionojnë në nivel qendror dhe lokal, duke përfshirë edhe institucione të sigurisë në Kosovë. Përveç ligjit për ZAP, është miratuar ligji për Avokatin e Popullit (AP) nr. 05/L019 i cili shërben si mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik në Kosovë, nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Poashtu është miratuar ligji për Agjencinë Shtetërore kundër Korrupsionit (AKK) 03L-159²²⁰ Kjo agjenci funksionon vetëm në bazë të ligjit për AKK, i cili përcakton statusin dhe përgjegjësitë e AKK-së në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë shtetërore kundër korrupsionit si dhe planin e veprimit.²²¹

6.2. Kapacitetet administrative

Kapacitetet e komisioneve parlamentare janë të kufizuara si në burimet njerëzore ashtu dhe në ato materiale. Shumica e deputetëve nuk kanë përvojë në çështjet buxhetore apo të prokurimit, gjë që dobëson efikasitetin e mbikëqyrjes të shpenzimit të fondeve publike nga ana e MFSK-së.²²² Mbikëqyrja parlamentare dhe demokratike e cila ushtrohet nga ana e komisioneve parlamentare, me fokus të veçantë komisionit për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrjen e FSK-së, është më shumë sipërfaqësore, dhe nuk po mbikëqyret funksionin e përgjithshëm të institucioneve të sigurisë.²²³ Mbikëqyrja Parlamentare dhe ngritja e kapaciteteve profesionale tek stafi administrativ po ashtu edhe tek deputetët, varet kryesisht nga ndihma që ofrohet nga organizatat ndërkombetare. Kjo ndihmë bëhet kryesisht me trajnime dhe konferenca, të cilat për qëllim kryesor kanë ngritjen profesionale të stafit mbikëqyrës, dhe deputetëve të komisioneve parlamentare të sigurisë.

220 Ligji për Avokatin e Popullit

221 Kuvendi i Kosovës ligji për Agjencinë Shtetërore kundër Korrupsionit (AKK) 03L-159.

222 QKSS 2014- "Llogaridhënie apo Jo? Menaxhimi i Financave Publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë"

223 Plani Vjetor i punës së Komisionit për Siguri për vitin 2015

Rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen demokratike të FSK-së kanë edhe Agjencionet e Pavarura Shtetërore. ZAP është njëra ndër institucionet më kredibile dhe profesionale në mesin e agjencive të pavarura shtetërore. Stafit dhe menaxhmenti i ZAP-it posedojnë kapacitetet profesionale dhe kadrovike, për të ushtruar mandatin mbikëqyrës të FSK-së, sidomos mbikëqyrjen financiare të këtij institucioni. Raportet të cilat hartohen nga ZAP-i për MFSK-në janë shumë profesionale dhe identifikojnë të gjitha sfidat, të cilët ndërlidhen me mbikëqyrjen financiare të MFSK-së, si dhe funksionimin e përgjithshëm të FSK-së.

Edhe institucioni i Avokatit të Popullit (AP)-së ka ndërtuar kapacitetet e mjaftueshme në drejtim të mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë, me fokus në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke përfshirë edhe pjesëtarët e FSK-së.

Në krahasim me ZAP-in dhe Avokatin e Popullit, puna e AKK-së ndërlidhet me MFSK-në vetëm tek çështjet e deklaramit dhe prejardhjes së pasurisë të zyrtarëve të FSK-së. AKK ka kapacitetet e mjaftueshme në mbikëqyrjen e deklaramit të pasurisë së zyrtareve publik, si dhe përcaktimin e rasteve të konfliktit të interesit ku janë të involvuar zyrtarët publik. AKK-ja çalon në aktivitetet që ndërlidhen me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në sektorin publik.²²⁴ Shumica e lëndëve të AKK-së të lidhur me rastet e korrupsionit rrëzohen poshtë nga ana e prokurorisë së shtetit si të pa baza në mungesë të provave.²²⁵

6.3. Implementimi

Për sa i përket mbikëqyrjes parlamentare të FSK-së, nga ana e komisionit për siguri, në perjashtim të raportimeve të rregullta gjashtë mujore, dhe vjetore, nuk është vërejtë ndonjë iniciativë konkrete për të mbikëqyrur aktivitetet dhe funksionimin e përgjithshëm të FSK-së.²²⁶ Komisioni për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së gjatë pjesës së dytë të vitit gjatë vitit 2015 dhe në vitin 2016, nuk ka mbikëqyrur asnjë ligj, i cili ndërlidhet me aktivitetet e FSK-së sfidat me të cilat përballet ky institucion, si qeverisjen e mirë dhe integritetin brenda këtij institucioni.²²⁷ Një pjesë e anëtarëve të komisionit për siguri janë ish luftëtar të UÇK-së, dhe pjesëtar të TMK-së, dhe kanë një miqësi shumë të madhe me menaxhmentin e FSK-së dhe MFSK-së, miqësi kjo e cila ka ndikuar që komisioni për siguri të ketë një qasje më të rezervuar ndaj FSK-së në procesin e mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar saj. Kriza politike që e ka përcjellur vendin në vitet 2015 dhe 2016, ka shkaktuar një regres në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë në Kosovë. Kjo krizë kishte ndikim edhe në numrin e takimeve të organizuara nga ana e komisionit për siguri, në funksion të mbikëqyrjes civile të

224 KDI 2016

225 KDI 2016

226 QKSS 2015 < http://www.qkss.org/repository/docs/Llogaridh%C3%ABnie_apo_jo_116106.pdf>

227 QKSS 2014 < http://www.qkss.org/repository/docs/Llogaridh%C3%ABnie_apo_jo_116106.pdf>

institucioneve të sigurisë. Bojkotimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të partive opozitare në takimet e komisionit për siguri, ka shkaktuar probleme në mbikëqyrjen e efkase të institucioneve të sigurisë.

Komandanti i FSK-së, si dhe Ministri i FSK-së, i kanë kryer raportimet e tyre të rregullta në komisionin për siguri lidhur me punën dhe aktivitetet e FSK-së për vitin 2015 dhe 2016. Mirëpo, përveç raportimeve formale, diskutimeve, dhe pyetje-përgjigjeve, mbikëqyrja parlamentare e cila ushtrohet nga ky komision në drejtim të FSK-së nuk është futur më thellë. Në mungesë të kapaciteteve profesionale të anëtarëve të komisionit për siguri, mbikëqyrja parlamentare ka qenë e mangët në fushat më të ndjeshme të FSK-së, siç është prokurimi publik, mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nga ana e FSK-së, si dhe mbikëqyrja e shpenzimit dhe kontrollit i fondeve publike.²²⁸

Në tabelën e mëposhtme vërehet se në krahasim me vitin 2014, në vitin 2015 kishtë rënie të aktiviteteve dhe punës së komisionit për siguri, kryesisht për shkak të vonesave në themelimin e institucioneve shtetërore pas zgjedhjeve qendrore të vitit 2014, si dhe krizës politike në vitin 2015.²²⁹

Tabela 2. Aktivitetet e komisionit për punë të brendshme dhe siguri dhe mbikëqyrjen e FSK-së në vitin 2015.

Krahasimi i statistikave të aktiviteteve të Komisionit për Siguri për vitin 2014/2015	Vitet	
	2014	2015
Numri i takimeve	33	25
Procesverbale	33	25
Inicimi i projektligjeve	1	0
Rishikimi i ligjeve në lexim të parë	10	4
Rishikimi i draftligjeve në lexim të dytë	3	4
Amandamentimi dhe rishikimi i ligjeve nën mandatin e komisionit funksional	4	4
Raporte të shkruara me rekomandime për projektligjet	3	/
Numri i grupeve punuese të krijuara	9	6
Numri total i takimeve të grupeve punuese për rishikimin e projektligjeve	27	25
Numri i amandamenteve të propozuara	83	74
Numri i ligjeve të mbiëqyrura nga Komisioni për Siguri	1	1
Diskutimi i raporteve vjetore të dërguara nga Agjencitë e Pavarura Shtetërore	3	3
Vendime dhe rekomandime të dhëna nga Komisioni për Siguri	32	(7)
Numri i vizitave zyrtare jashtë vendit të anëtarëve të komisionit	4	4
Numri i vizitave zyrtare brenda Kosovës	7	6
Dëgjime publike të organizuara nga ana e Komisionit për Siguri	2	15

228 Raportimi i Komandantit të FSK-së në Komisionin për siguri. Mars 2016

229 Plani Vjetor i punës së Komisionit për Siguri për vitin 2014 dhe 2015

Sa i përket bashkëpunimit të MFSK-së dhe AKK-së, ky institucion kishte një bashkëpunim kryesisht kur bëhet fjala për deklarimin, prejardhjen, dhe kontrollin pasurisë dhe të dhuratave për zyrtarët e lartë publikë. Procesit të deklarimit të pasurisë, prejardhjes së saj, si dhe kontrollit të deklaratave për zyrtarët e lartë publikë i janë nënshtruar 36 zyrtarë të lartë të MFSK-së. Për këtë proces AKK-ja nuk kishte pasur ndonjë vërejtje rreth deklarimit të pasurisë, i cili ishte bërë në përputhje me ligjin Nr. 04/L-050 për deklarimin e pasurisë, dhe për dhuratat për zyrtarët publikë. AKK-ja nuk ka ndonjë rol më të madh të mbikëqyrjes së MFSK-së, pasi që ky institucion nuk është pjesë e strategjisë shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsion, zbatimin e të cilës e mbikëqyrë AKK-ja.

Më 2015 MFSK-ja kishte organizuar takime zyrtare me AP-në, për të zgjeruar bashkëpunimin e tyre në adresimin e të drejtave të njeriut. Në vitin 2015, një zyrtar i MFSK-së i cili nuk e kishte kaluar procesin e verifikimit të sigurisë, nga ana e AKI-së, kishte bërë ankesë tek avokati i popullit.²³⁰ MFSK-ja kishte ofruar të gjitha të dhënat lidhur me këtë rast. MFSK nuk ka ndonjë praktike të theksuar të bashkëpunimit me institucionin e AP-së, qoftë për shkak se natyra e punës së MFSK-së, dhe numrit të vogël të ankesave që AP-ja pranon nga ana e qytetarëve ndaj zyrtarëve të FSK/MFSK-së.²³¹

Për çdo vit, ZAP-i harton raporte rreth menaxhimit dhe shpenzimit të fondeve publike për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në të cilën prezantohen sfidat e MFSK-së në këtë drejtim, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për adresimin e tyre. MFSK-ja, specifikisht NjAB-ja e MFSK-së, kanë një bashkëpunim të ngushtë me ZAP-in gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave për hartimin e raporteve të vlerësimit të ZAP-it rreth shpenzimit të fondeve publike.²³² Në vitin 2014, ZAP-i kishte dhënë 10 rekomandime për përmirësimin dhe kontrollin e shpenzimit të fondeve publike nga ana e MFSK-së. Prej gjithsejtë 10 rekomandimeve të dhëna, 5 janë adresuar plotësisht, kurse pjesa tjetër janë adresuar pjesërisht apo nuk janë adresuar fare. Rekomandimet lidheshin me problemet e MFSK-së me prokurimin publik, menaxhimin e burimeve njerëzore, auditimin e brendshëm, si dhe menaxhimin dhe kontrollin e pasurisë së MFSK-së.²³³


230 Përgjigje nga Departamenti për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës 18 Mars 2016

231 Përgjigje nga Departamenti për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës 18 Mars 2016

232 Përgjigje nga Departamenti për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës 18 Mars 2016

233 Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MFSK-në 2015 < http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_MFSK_2014_Shqip_946941.pdf>

Figura 8. Adresimi i komenteve të ZAP-it, nga ana e menaxhmentit të MFSK-së në vitin 2015.



6.4. Transparenca në FSK

Të qenit i hapur, transparent, në shpjegimin dhe prezantimin e veprimeve dhe aktiviteteve institucionale për aq sa lejon ligji, dhe nuk preket interesi i sigurisë nacionale, të bënë institucion kredibil, të besueshëm dhe llogaridhënës, të cilat janë parimet kryesore demokratike për forcat e armatosura. Transparenca dhe qasja në dokumente publike është e garantuar me ligj. Ligji për qasje në të dhëna publike Nr. 03/L-215 është miratuar në Kuvendin e Kosovës, dhe obligon të gjitha institucionet publike që të garantojnë qasje në të dhëna publike deri në masën që nuk preket interesi nacional i sigurisë. FSK-ja në përgjithësi është treguar institucion transparent karshi qytetarëve të saj, shoqërisë civile, mediave si dhe institucioneve tjera.²³⁴ Në vitin 2015, MFSK-ja kishte pranuar 7 kërkesa për qasje në të dhëna publike dhe të gjitha kërkesat ishin miratuar nga ana e MFSK-së në afatin e paraparë me ligj.²³⁵ Në uebfaqen e MFSK-së është i vendosur linku ku mund të bëhet kërkesa për qasje në dokumente publike.

Në uebfaqen e MFSK-së zakonisht vendosen thirrjet për aplikim për pjesëtarë dhe zyrtarë të FSK-së në të cilën prezantohen dokumentacioni i nevojshëm për aplikim,

²³⁴ QKSS 2012- "Monitorimi dhe Vlerësimi i Sektorit të Sigurisë në Kosovë" Prishtinë < [²³⁵ Përgjigje nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun e FSK-së- 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës](https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0ahUKÉwj859XAq-bMAhUBniwKHx6PD0sQFggdMAA&url=http%3A%2F%2Fqkss.org%2Fnew%2Fimages%2Fcontent%2FPDF%2FMonitorimi%2520dhe%2520vler%25C3%25ABsimi%2520i%2520qeverisjes%2520s%25C3%25AB%2520mir%25C3%25AB%2520n%25C3%25AB%2520SSK.pdf&usq=AFQjCNGUpR1vmwPQZbLcG8ESzm2auAlhtA&sig2=VKIOH9q9TpTDIWSlqHdqIQ></p>
</div>
<div data-bbox=)

kriteret të cilat duhet të plotësohen nga kandidatët për pozita të caktuara. Përveç njoftimit në uebfaqen e MFSK-së, sidomos konkurset për pjesëtarë të FSK-së, janë publikuar edhe në televizionet kryesore nacionale dhe gazetatat zyrtare në Kosovë. Pashtu janë organizuar kampanja në të gjitha komunat e Kosovës për procesin e njoftimit dhe thirrjes për aplikim për pjesëtarë të FSK-së.²³⁶

MFSK-ja ashtu siç është e paraparë me ligjin e LPP-së, të gjitha kërkesat për ofertim, kriteret teknike dhe administrative për procedurat e prokurimit publik, i vendos në uebfaqen e saj, si dhe të Agjencisë Qëndrore të Prokurimit (AQP) Njoftimet lidhur me progresin e vlerësimit të dosjeve dhe aplikimeve të operatorëve ekonomikë, si dhe vendimet e MFSK-së lidhur me procedurat e prokurimit publik vendosen në uebfaqe, dhe operatorët ekonomikë njoftohen mbi arsyet e mos lidhjes së kontratës.

Përkundër faktit që MFSK-ja iu përgjigjet shumicës së kërkesave për qasje në të dhënat publike, dhe intervistim, përgjigjet si dhe të dhënat të cilat i plasohen publikut nga ana e MFSK-së janë shumë të përgjithshme dhe të mangëta. Si rrjedhojë, nuk krijojnë mundësi për analizë dhe vlerësim objektiv të situatës, lidhur me temat dhe çështjet të cilat ndërlidhen me këtë institucion.

Raportet e auditimit të brendshëm të cilat kryehen nga NjAB-ja asnjëherë nuk bëhen publike nga MFSK-ja. Me përjashtim të raporteve të NjAB-së, të cilat mund të klasifikohen si sekrete, në bazë të ligjit për klasifikimin e informacioneve, raportet tjera të NjAB duhet të jenë publike, dhe të vendosen në uebfaqen e MFSK-së, dhe të jenë të qasshme për të interesuarit për hulumtime apo analiza të ndryshme.

Përkundër besimit të madh që FSK-ja gëzon në mesin e qytetarëve të Kosovës, në bazë të sondazheve të kryera nga QKSS, prej institucioneve të sigurisë në Kosovë, FSK-ja është vlerësuar si institucion që më së paku ka kontakt me qytetarët. Qytetarët kanë shumë pak informacione lidhur me punën dhe aktivitet që kryen FSK-ja. Në edicionin e BKS-së të publikuar në Dhjetor të vitit 2015, të anketuarit e kanë rradhitur FSK-në si institucionin më pak të kontaktuar nga ana e qytetarëve. Vetëm 21 përqind e qytetarëve të anketuar kanë treguar se kanë kontaktuar me FSK-në dhe se janë në njohuri me punën të cilën e kryen FSK-ja, kurse 71 përqind e qytetarëve të anketuar treguan se nuk kishin kontakt me FSK-në. Kjo mund të ndërlidhet edhe për shkak të mandatit të FSK-së që e limiton kontaktin ndërmjet këtij institucioni dhe qytetarëve.²³⁷


Pas FSK-së, KFOR-i radhitet si institucioni i dytë që më së paku ka kontakt me qytetarët e Kosovës, ku 23 përqind e të anketuarve kanë deklaruar të kenë pasur kontakte me misionin e KFOR-it, derisa 77 përqind janë shprehur se nuk kanë pasur kontakt me këtë

236 Përgjigje nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. 18 Mars 2016- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

237 Barometri Kosovar i Sigurisë. QKSS 2015 < http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Special_Edition_897293.pdf>

institucion fare. Sipas të dhënave të këtij hulumtimi, me përjashtim të PK-së, kontaktet e qytetarëve me institucionet e tjera të sigurisë (FSK-ja dhe KFOR-i) kanë qenë më tepër të formës së vrojttimeve pasive nga ana e qytetarëve sesa kontakte të drejtpërdrejta.²³⁸

Figura 9. Kontakti i qytetarëve me institucionet e sigurisë në Kosovë



6.5. Pavarësia në vendimmarrje në MFSK

Kushtetuta e Kosovës ka të rregulluar përgjegjësitë, mandatin dhe kompetencat e FSK-së, si dhe ka përcaktuar kontrollin civil dhe demokratik të FSK-së. Neni 88 i Kushtetutës së Kosovës ka përcaktuar qartë kompetencat e Presidentit të shtetit si komandant suprem i FSK-së.²³⁹ FSK i nënshtrohet kontrollit civil dhe demokratik i cili ushtrohet nga ana e Presidentit të Kosovës, Ministrisë të FSK-së, si dhe Kuvendit të Kosovës. Bazuar në ligjin Nr. 03/L-045 për MFSK-në, ka të rregulluara përgjegjësitë dhe kompetencat për funksionin e përgjithshëm dhe llogaridhënien e FSK-së.

Ministri i FSK-së është autoriteti final i cili ka rol ekzekutiv lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe funksionimin e Ministrisë dhe FSK-së. Ministri i FSK-së miraton të gjitha planet dhe vendimet për fillimin e rekrutimit të stafit ushtarak të FSK-së në përputhje me rekomandimet dhe nevojat e institucionit. Procesi i rekrutimit të stafit civil të FSK-së është kompetencë e sekretarit të MFSK-së i cili e harton planin për rekrutim të stafit civil dhe zbatimin e tij bëhet në konsultim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Natyra dhe mandati aktual i FSK-së e bëjnë immune (ligjërish) këtë forcë nga ndikimi politik. Kjo forcë është pothuajse e ndarë nga zhvillimet politike në Kosovë (sipas ligjit). Mirëpo, jo rrallë herë FSK-ja është përdorur nga ana e pushtetit aktual për përfitime

238 Barometri Kosovar i Sigurisë. QKSS 2015 < http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Special_Edition_897293.pdf>

239 Kushtetuta e Kosovës, Neni 85, kompetencat e Presidentit të Kosovës

politike. Procesi i transformimit të FSK-së në FAK është përdorur për përfitime zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Pas përvjetorit të gjashtë të pavarësisë së Kosovës, ish-kryeministri Hashim Thaçi, më 17 shkurt 2014, paralajmëroi themelimin e FAK-ut, lajmërimi i cili i vlerësua si i ngutshëm edhe nga faktori nderkombetar, si dhe u bë kryekëput për përfitime elektorale.

Që nga themelimi i FSK-së, ky institucion ka qenë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e prezencës ndërkombetare ushtarake në Kosovë (KFOR). Me themelimi i FSK-së, një ekip këshillues civil i NATO-s në nivel të Minsitrisë së FSK-së, dhe një ekip këshillues ushtarak i NATO-s filluan punën me FSK-në për të përcjellur zhvillimin e FSK-së. Poashtu deri në miratimin e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO) nga ana e NATO-s, KFOR-i kishte rol udhëheqës në trajnimin dhe zhvillimin e FSK-së. Mbikëqyrja dhe kontrolli i vazhdueshëm i FSK-së nga ana e prezencës ushtarake ndërkombetare, sidomos të KFOR-it, ka bërë që pjesëtarët dhe zyrtarët e FSK/MFSK-së të krijojnë një varësi ndaj prezencës ushtarake ndërkombetare në Kosovë, dhe nuk kanë mundur që të krijojnë një pavarësi në vendimmarrje për çështje të rëndësishme të FSK/MFSK-së. Varësia e vazhdueshme e FSK/MFSK-së ndaj prezencës ndërkombetare ushtarake në Kosovë ka reduktuar zhvillimin e pronësisë vendore të sektorit të sigurisë në Kosovë, si dhe zhvillimin e institucioneve vendore të sigurisë në përgjithësi.²⁴⁰

7. Përfundimi

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës deri në një masë ka ndërtuar mekanizmat e qeverisjes së brendshme. Janë themeluar departamentet e kontrollit të brendshëm, është ndërtuar një bashkëpunim i mirë me Agjencionet e Pavarura Shtetërore, si dhe shoqërinë civile. Fushat më të ndjeshme sic janë: Prokurimi Publik, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Parandalimi i Korrupsionit, si dhe çështja e integritetit janë ndër sfidat më të mëdha për këtë institucion. MFSK i nënshtrohet ligjit të prokurimit publik, njëjtë si të gjitha autoritetet tjera publike në Kosovë, përkundër faktit se MFSK ka specifikat e e vecanta.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore- ky sektor poashtu është mjaftë sfidues për MFSK. Ende nuk është bërë ndarja dhe përkrahimi i vendit të punës, si dhe nuk ka profilizim të vendit të punës për zyrtarët dhe pjesëtarët e FSK/MFSK, dhe si rezultat i saj, ka lëshime edhe në matjen dhe vlerësimin e performancës për pjesëtarët dhe zyrtarët e FSK/MFSK. Pjesëtarët e MFSK dhe FSK ende nuk kanë sigurim shendetësor, cka e bënë këtë si institucionin e vetëm ushtarak në rajon, që nuk ka sigurime shendetësore.

MFSK gëzon një besueshmëri të madhe nga ana e qytetareve. Rreth 70 përqind e qytetarëve i besojnë, dhe janë të kënaqur me punën e FSK-së. Poashtu qytetarët e an-

²⁴⁰ Florian Qehaja- PhD Thesis- 2016

ketuar nëpërmjet BKS-së e kanë vlerësuar FSK-në si institucionin më pak të korrumpuar në Kosovë.

MFSK ende nuk ka mundur të përgadite dokumentet dhe planet të cilat merren me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit brenda MFSK, si dhe nuk është hartuar Plani i Integritetit, i cili forcon dhe promovon integritetin brenda FSK-së. Ky dokument është në përpunim e sipër. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka një bashkëpunim të mirë me MFSK-në. Përveç raporteve të rregullta, ky komision nuk është futur më thellë në mbikëqyrjen e FSK-së. Nuk është bërë mbikëqyrja e funksionimit të brendshëm të MFSK, apo vlerësimin e integritetit brenda këtij institucioni. Fushat e ndjeshme si: Prokurimi Publik, Burimet Njerëzore nuk janë trajtuar pothuajse fare nga ana e komisionit për punë të brendshme, siguri, dhe mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

8. REKOMANDIMET

- Të planifikohet në mënyrë precize dinamika e ekzekutimit të shpenzimeve me qëllim që të shmanget numri i madh i pagesave të koncentruara në një periudhë të shkurtër të fundit të vitit me qëllim të lehtësimit të ushtrimit të mbikëqyrjes së shpenzimit të parasë publike edhe në sektor të sigurisë;
- Të bëhet hulumtimi i tregut me qëllim që kjo ministri të ketë njohuri para-prake rreth çmimeve të tregut për shërbimet dhe pajisjet të cilat ky institucion i siguron nëpërmjet procedurave të prokurimit publik;
- Të forcohet procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave të lidhura me operatorët privat ekonomikë për kryerjen e shërbimeve të ndryshme për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Institucionet e sigurisë duhet të sigurohen që rekomandimet të cilat dalin nga njesitë e auditimit të brendshëm, dhe ato të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të konsiderohen në mënyrë të përpikët me qëllim të parandalimit të përsëritjes së problemeve të njëjta edhe në vitet vijuese;
- Raportet e auditorit të brendshëm duhet të bëhen publike, dhe të vendosen në vebfaqen e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Përveç raporteve të cilat klasifikohen si sekrete me ligj, raportet tjera të vlerësimit të Njësive të Brendshme të Auditimit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës duhet të jenë transparente;

- Përshkrimi i detyrave të punës për zyrtarët dhe pjesëtarët e Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk duhet të jenë gjithëpërfshirëse. Ky institucion duhet të përditëson përshkrimin e vendeve të punës, për pjesëtarët dhe zyrtarët e saj, në mënyrë që përshkrimi i vendeve dhe detyrat e punës të jenë më të detajuara, dhe të jenë në harmoni me punën që kryejnë zyrtarët dhe pjesëtarët e Ministrisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Ka përzierje të kompetencave brenda përbrenda zyrtarëve dhe pjesëtarëve të uniformuar të cilët punojnë në departamentet e njëjta të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo ministri duhet të sigurojë profilizimin dhe ndarjen e saktë të kompetencave për zyrtarët dhe pjesëtarët e saj të cilët punojnë në departamentet e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës duhet të hartojë planin e integritetit të saj. Plani i Integritetit duhet të jetë i bazuar në rrethanat institucionale dhe të fokusohet më shumë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit për zyrtarët dhe pjesëtarët e këtij institucioni;
- Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri duhet të caktojë prioritetet e tij në mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve të sigurisë. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve që ndërlidhen me aktivitetet dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës me fokus menaxhimin e burimeve njerëzore, gradimet dhe avancimet, si dhe prokurimi publik në këtë ministri.
- Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës duhet të gjejë zgjidhje për problemet afatgjate të saj në aspektin e lidhjes së kontratave mbi vepër me zyrtarë të ndryshëm të Ministrisë së Forcës. Kjo ministri duhet të bëjë planet afatgjate të saja për planifikimin e burimeve njerëzore, dhe të plotësohen zbrazëtitrat dhe nevojat për resurse njerëzore;

Ky projekt/program është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

35:32(496.51)(047.3)

Perteshi, Skënder

Monitorimi dhe vlerësimi i qeverisjes së brendshme
dhe integritetit në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës : raport vlerësues dhe
monitorues /

Skënder Perteshi dhe Plator Avdiu. – Prishtinë : QKSS, 2016. – 86 f. : ilustr. ; 22 cm.

1.Avdiu, Plator

ISBN 978-9951-679-41-1

ISBN 978-9951-679-41-1



9 789951 679411

www.qkss.org